



**- SQARIMI REALITETIT TË TEUHIDIT  
ME TË CILIN ERDHËN PEJGAMBERËT  
DHE RRËZIMI DYSHIMEVE QË U PËRHAPËN RRETH TIJ  
SHEJH SALIH EL FEUZAN**

**- METODOLOGJIA E SELEFËVE TË DEVOTSHËM  
DHE NEVOJA E UMETIT PËR TË  
SHEJH SALIH EL FEUZAN**

**- ARGUMENTET NGA UNGJILLI SE ISAI ALEJHIS-SELAM  
ËSHTË ROB ADHURUES DHE NUK KA HISE NË ADHURIM  
SHEJH MUHAMED EL HILALI**

**- HISTORIA E ADEMIT ALEJHIS-SELAM  
SHEJH ABDURRAHMAN ES-SA'DIJ**

**- BAMIRËSIA  
SHEJH RABI' EL MEDKHALI**



**REVISTË ELEKTRONIKE FETARE  
VITI I PARË, NUMRI I PARË.  
XHUMADAL ULA 1441 / JANAR 2020**

## PËRMBAJTJA

### AKIDE DHE TEUHID

- [Sqarim për realitetin e teuhidit me të cilin erdhën të dërguarit dhe ç'rrënjosja e dyshimeve që janë hedhur rreth tij](#) – Shejh Salih el Feuzan

### MENHEXH

- [Rruga e Selefëve të devotshëm dhe nevoja e umetit për të](#) – Shejh Salih el Feuzan

### TEFSIR

- [Baza në Tefsir \(pjesa 1\)](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin

### FIK'H

- [Esenca e pastërtisë](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin
- [Origjina në pastrim](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin
- [Çfarë e zëvendëson origjinën në pastrim](#) – Shejh Muhamed el Uthejmin

### GRUPACIONET

- [Argumentet nga Ungjilli se Isai alejhis-selam është robe adhurues dhe nuk ka hise në adhurim \(pjesa 1\)](#) – Shejh Muhamed el Hilali

### FAMILJA

- [Porosi për gruan muslimane](#) – Shejh Salih el Feuzan

### HISTORI DHE BIOGRAFI

- [Historia e Ademit, babait të njerëzimit](#) – Shejh AbdurRahman es-Sa'dij

### MORAL

- [Ihsani \(bamirësia\)](#) – Shejh Rabi' el Medkhali

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

### **Me emrin e Allahut, të Gjithëmshirshmit, Mëshirëplotit.**

Lavdi Allahut, Krijuesit Fuqiptotë, salavatet dhe selamet e Tij qofshin mbi Pejgamberin tonë dhe Vulën e Pejgamberisë, Muhamedin sal-Allahuhu alejhi ue sel-lem, familjen dhe shokët e tij.

Më pas:

Përpara duarve tuaja është revista elektronike “Medina”, e cila me trajtën e saj bashkëkohore, synon dëlirjen e muslimanëve nga gjërat e huaja dhe keqkuptimet që kanë rreth Islamit, po ashtu edukimin e tyre sipas mësimëve të Kuranit dhe Sunetit, ashtu siç janë kuptuar nga Selefus es-Salih (brezat e parë të devotshëm).

Në këtë revistë do të keni mundësinë të gjeni të përkthyer artikuj nga dijetarë eminentë, në shkenca të ndryshme, si: Akidja, Tefsiri, Hadithi, Fik’hu etj.

Në faqen zyrtare gjithashtu do të keni mundësi të përfitoni edhe nga ligjëratat të dijetarëve të përkthyer në shqip, apo nga ligjëratat e mbajtura në gjuhën shqipe nga hoxhallarët që kujdesen për faqen dhe revistën.

E lusim Allahun e Lartësuar që këtë vepër ta bëjë të sinqertë dhe të pranuar. Lutja jonë e fundit është: lavdi Allahut, Zotit të krijesave.

**SQARIM PËR REALITETIN E TEUHIDIT ME TË CILIN ERDHËN TË  
DËRGUARIT  
DHE Ç'RRËNJOSJA E DYSHIMEVE QË JANË HEDHUR RRETH TIJ  
SHEJH SALIH EL FEUZAN**

**Parathënie**

Nga shkëlqesia e tij Dr. Abdullah ibën AbdulMuhsin Et-Turki, rektori Universitetit Islam "Imam Muhammed ibën Saud".

Rrezikun e metodologjive shkatërruese të përhapura në disa zona muslimane e perceptojnë që të gjithë. Këto kanë hedhur rrënjë në zemrat e disave prej tyre, ose nga padituria e pasimi i verbër, ose nga fanatizmi injorant. Këto grupe, me gjithë numrin e paktë si në nivel e numër- dhe Allahut i takon lavdërimi - t'i lësh ata të përhapin metodat dhe rrugët e tyre të humbura, është çështje që ka rrezikshmëri të madhe dhe ndikon në përparimin e Islamit dhe gjendjen e muslimanëve.

Kundërvënia ndaj këtyre grupacioneve, nxjerrja në pah e humbjes, sqarimi për besimin e prishur dhe kundërshtimin e tyre ndaj udhëzimit të Allahut e të Dërguarit të Tij, është gjë e detyrueshme mbi gjithë umetin Islam.

Shpjegimi i metodologjisë së pasuesve të Sunetit dhe Xhematit, ndriçimi i saj mbi të gjithë çështjet Islame dhe sqarimi i akides së tyre e cila pajtohet me të vërtetën e udhëzimit, është mënyra më e rëndësishme për të ç'rrënjësuar besimet e tjera të kalbura dhe sektet e humbura, të cilat Iblisi i verboi, ia zbukuroi punën e keqe dhe ia justifikoi devijimin nga e vërteta dhe e drejta.

Qëkur u shfaqën grupet e humbura prej duarve të jehudëve, hipokritëve dhe atyre që u futën në Islam për ta shfityruar dhe rrënuar nga brenda, Allahu nxorri përballë tyre dikë që t'i kundërvihet e të qartësojnë kotësinë e mospajtimin e tyre me realitetin Islam në besim dhe dispozitë.

Sot lulëzojnë universitetet Islame me në krye universitetin "Imam Muhamed ibën Saud" me shumë kapacitet dijesh, që bëjnë të mundur sqarimin e metodologjisë së Selefëve tanë të mirë, Ehli Sunetit e Xhematit dhe paraqitjen e tyre për nxënësit dhe për të tjerë, po ashtu përkthimin në gjuhë të ndryshme me qëllim që të jenë në duar të muslimanëve në të gjitha anët e botës, që mbi

bazë të njohjes dhe qëndrueshmërisë në të, t'i largohen mendimeve dhe metodologjive të shtrembërta. Ajo që ka shkruar pena e shejh Salih Ibën Feuzan El Feuzan rreth sqarimit të realitetit të Teuhidit me të cilin erdhën të dërguarit dhe ç'rrënjësja e dyshimeve që janë hedhur rreth tij, nuk është gjë tjetër veçse fillimi i një përpjekje që shpresojmë të ketë sukses nga ky universitet për të shpjeguar menhexhin e pasuesve të Sunetit e Xhematit nga ana e akides dhe sheriatit (dispozitive), që janë baza e Islamit, të cilat universiteti i ka miratuar botimet e tyre në kërkime të thelluara e të lehta nën tematikën "Rruga e drejtë".

Autori, që Allahu i dhëntë sukses, është marrë në kërkimin e tij të çmuar me sqarimin e rëndësisë së akides e cila është themeli i fortë në ngrehinën e umetit. Ai është marrë me komentimin dhe shpjegimin e llojeve të Teuhidit, po ashtu qëndrimin e jobesimtarëve për secilin lloj. Ashtu siç ka qartësuar rënie e popujve në shirkun e Teuhidit të adhurimit dhe duke sjellë fjalë të shtjelluara për dyshimet tek të cilat u mbështetën. Ai sqaron ç'ka është e përbashkëta e popujve të ndryshëm në të shkuarën e të tashmen, duke u zgatur në kritikën ndaj tyre. Ka rrëzuar shpifjet e tyre duke paraqitur argumentet fetare dhe llogjike, për të treguar akiden e tyre të kalbur dhe argumentet e kota.

Gjithashtu, ka shtjelluar fjalën për shefatin (ndërmjetësimin), kushtet e tij dhe cili është i pranueshëm dhe i papranueshëm. Shpjegon çështjen e kërkimit të bereqetit prej evlijave dhe njerëzve të mirë, po ashtu flet gjërësisht për teuesulin se cili është i ligjëruar dhe cili i ndaluar.

Autori e përfundon kërkimin e tij duke kritikuar ata që mbështeten mbi përrallat, mbi ëndërra, apo mbi realizimin e disa gjërave gjatë sorrollatjes tek varret etj.

Allahu ia shpërbleftë me më të mirin shpërblim. Allahu e bëftë të dobishme këtë përpjekje dhe e realizoftë atë për çfarë janë lodhur. Allahu është Udhëzuesi për në rrugën e drejtë, Ai është Mbrojtësi ynë; më i miri Mbrojtës dhe më i miri Ndihmëtar.

Dr. Abdullah ibën AbdulMuhsin Et-Turki

Rektori i Universitetit Islam "Imam Muhamed Ibën Saud".

## SQARIM PËR REALITETIN E TEUHIDIT ME TË CILIN ERDHËN TË DËRGUARIT

### DHE Ç'RRËNJOSJA E DYSHIMEVE QË U HODHËN RRETH TIJ

Të gjithë lavdërimet janë për Allahun, Zotin e botëve, lëvdata e shpëtimi i Allahut qoftë mbi Pejgamberin tonë, Muhamedin vulën e të dërguarve, po ashtu mbi atë që kapet për Sunetin e tij dhe ecën në menhexhin e tij deri Ditën e Llogarisë.

Më pas:

Akidja është themeli mbi të cilën qëndron ngrehina e umeteve. Përmirësimi i çdo populli dhe përparimi e tij është i lidhur ngushtë me pastërtinë e besimit dhe mendimeve të tyre. Nga kjo nevojë erdhën dërgesat e Pejgamberëve - mbi ta qoftë lëvdata dhe shpëtimi - që thirrën për rregullimin e akides. Çdo i dërguar, kur e ftonte popullin e tij, fillimisht i thoshte:

﴿اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ﴾ الأعراف: ٥٩

**"Adhuroni Allahun, nuk keni ndonjë të adhuruar tjetër përveç Tij".<sup>1</sup>**

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنْ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ﴾ النحل: ٣٦

**"Vërtetë Ne kemi dërguar tek çdo popull të dërguar (për t'i thënë): "Adhuroni Allahun dhe largohuni Tagutit (çdo gjëje që adhurohet veç Tij)".<sup>2</sup>**

Kjo, sepse Allahu i Patëmetë i krijoi krijesat që ta adhurojnë të vetëm e të pa shok, ashtu siç I Lartësuari thotë:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾ الذاريات: ٥٦

**"Xhinët edhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë Mua".<sup>3</sup>**

Adhurimi është e drejta e Allahut mbi robërit e tij, ashtu siç i thotë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem Muadh ibën Xhebelit radij Allahu anhu: **"A e di cila është e drejta e Allahut mbi robërit dhe e drejta e robërve tek**

<sup>1</sup> El Earaf: 59.

<sup>2</sup> En-Nahl:36.

<sup>3</sup> Edh-Dhariyat: 56.

**Allahu?" Tha: "E drejta e Allahut mbi robërit është që ta adhurojnë dhe të mos t'i shoqërojnë asgjë në të, kurse e drejta e robërve tek Allahu është që mos të dënojnë atë që nuk i shoqëron asgjë (në adhurim)."**<sup>4</sup>

Kjo e drejtë është e para nga të gjitha në tërësi, nuk i paraprin asgjë dhe nuk i jepet përparësi të drejtës së askujt. I Lartësuari thotë:

﴿ وَقَضَىٰ رَبُّكَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا ﴾ الإسراء: ٢٣

**"Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuroni askënd tjetër veç Tij dhe me prindërit të jeni bamirës".**<sup>5</sup>

I Lartësuari thotë:

﴿ قُلْ تَعَالَوْا أَتْلُ مَا حَرَّمَ رَبُّكُمْ عَلَيْكُمْ أَلَّا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا ﴾ الأنعام:

١٥١

**"Thuaj: "Ejani t'iu lexoj ç'ka ju ka ndaluar Zoti juaj: të mos i bëni ortak askënd (në adhurim) dhe me prindërit të jeni bamirës".**<sup>6</sup>

Për shkak se kjo e drejtë është në krye, është më parësore mbi të gjitha të drejtat dhe pozita e saj është bazë mbi të cilën ngrihen të gjitha rregullat e fesë, shohim Pejgamberin sal-Allahu alejhi ue sel-lem që qëndroi në Meke trembëdhjetë vjet duke ftuar njerëzit që ta zbatojnë dhe të mohojnë ortakërinë në të. Kurani Famëlartë në shumicën e ajeteve të tij ka ardhur që atë ta vërtetojë dhe të mohojë dyshimet për të. Çdo namazli që fal farz apo nafile i jep besën Allahut për ta zbatuar këtë, kur ai thotë:

﴿ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴾ الفاتحة: ٥

**"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë".**<sup>7</sup>

Kjo e drejtë madhështore emërtohet "Teuhidi i adhurimit", "Teuhidi Uluhije" apo "Teuhidi i kërimit e qëllimit"; emra të ndryshëm për të njëjtën gjë. Ky Teuhid është ngulitur në natyrshmëri "**Çdo fëmijë lind në natyrshmëri**". Devijimi shfaqet më pas si pasojë e edukimit të keq: "**Mirëpo prindërit e tij e**

<sup>4</sup> Buhariu 13/300 dhe Muslimi 30.

<sup>5</sup> El Isra': 23.

<sup>6</sup> El En'am: 151.

<sup>7</sup> El Fatiha: 5.

**shndërrojnë në jehud, në të krishterë, apo mexhusi (adhurues të zjarrit)".<sup>8</sup>**  
Ky Teuhid është origjina në botë kurse shirku është ardhacak dhe i futur. I Lartësuar thotë:

﴿كَانَ النَّاسُ أُمَّةً وَاحِدَةً فَبَعَثَ اللَّهُ النَّبِيِّنَ مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ وَأَنْزَلَ مَعَهُمُ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِيَحْكُمَ بَيْنَ  
النَّاسِ فِي مَا اختلفوا فيه﴾ البقرة: ٢١٣

**"Njerëzit kanë qenë një popull i vetëm (në fe), pastaj Allahu dërgoi Pejgamberët lajmgëzues e paralajmërues dhe bashkë me ta zbriti Librin me drejtësi, në mënyrë që të gjykojë mes njerëzve në çka u kundërshtuan".<sup>9</sup>**

I Lartësuar thotë:

﴿وَمَا كَانَ النَّاسُ إِلَّا أُمَّةً وَاحِدَةً فَاخْتَلَفُوا﴾ يونس: ١٩

**"Njerëzit ishin veçse një popull i vetëm (në fe), pastaj u kundërshtuan".<sup>10</sup>**

Ibën Abasi radij Allahu anhumu thotë: "Mes Ademit dhe Nuhut - alejhima es-salatu ue sel-lam- kaluan dhjetë shekuj të gjithë në Islam".<sup>11</sup> Dijetari i madh Ibën Kajimi thotë: "Kjo është fjala e saktë për ajetin", pastaj përmend ajetet mbështetëse nga Kurani.<sup>12</sup> Gjithashtu këtë e ka saktësuar edhe Hafidh Ibën Kethir në tefsirin e tij, se e para herë që u shfaq shirku tek populli i Nuhut ishte kur e tejkalan cakun me njerëzit e mirë, pastaj u bënë mendjemdhenj ndaj ftesës së pejgamberit të tyre:

﴿وَقَالُوا لَا تَذَرُنَّ آلِهَتَكُمْ وَلَا تَذَرُنَّ وَدًّا وَلَا سُوَاعًا وَلَا يَغُوثَ وَيَعُوقَ وَنَسْرًا﴾ نوح: ٢٣

**"Ata thanë: "Kurrresi mos braktisni të adhuruarit tuaj! Mos braktisni Uedin, Suanë, Jeguthin, Jeukin dhe Nesranë!"<sup>13</sup>**

Buhariu, Allahu e mëshiroftë, në sahihun e tij transmeton nga Ibën Abasi, radij Allahu anhumu: "Këto ishin emra burrash të mirë nga populli i Nuhut. Kur ata vdiqën, Shejtani frymëzoi tek populli i tyre që të ngrejne statuja në vendet

<sup>8</sup> Muslimi 2047.

<sup>9</sup> El Bekareh: 213.

<sup>10</sup> Junus: 19.

<sup>11</sup> Tefsir Ibëni Kethir 1/250.

<sup>12</sup> Igathetul-lehfan 2/201.

<sup>13</sup> Nuh: 23.



e tyre ku rrinin, pastaj i emërtoni me emrat e tyre dhe kështu vepruan. Ata nuk u adhuruan fillimisht, deri kur vdiq ai brez dhe u harrua dija, atëherë i morën për të adhuruar”.<sup>14</sup>

Imam Ibën Kajim<sup>15</sup> Allahu e mëshiroftë ka thënë: “Thotë më shumë se një prej selefëve: “Kur vdiqën, qëndruan tek varret e tyre pastaj skalitën statujat e tyre. Pastaj koha u zgjat dhe atëherë i adhuruan”.

Më pas ka thënë:<sup>16</sup> “Shejtani ka luajtur me idhujtarët në adhurimin e statujave; me çdo popull sipas nivelit të llogjikës. Një grup e ftoi për në adhurim nga ana e madhërimit të të vdekurve, të cilët skalitën statuja me pamjen e tyre, ashtu si tek populli Nuhut. Ky është shkaku mbizotërues tek njerëzit e rëndomtë prej idhujtarëve, kurse përse i përket shtresës më të lartë shoqërore, ata i bënë statujat në formën e yjeve me ndikim në tokë, sipas pretendimit të tyre. Ngritën për ta tempuj, shërbyes, rojtarë dhe priftërinj. Kjo situatë vazhdoi në dynja në të shkuarën dhe në të tashmen.

Origjina e kësaj rruge vjen nga Sabiat idhujtarë, që ishin populli i Ibrahimit alejhis-selam, me të cilët polemizoi për kotësinë e shirkut. Argumentimin e tyre e theu me dituri, kurse idhujt me dorën e tij. Prandaj në këtë situatë kërkuan që atë ta djegin.

Një grup tjetër bënë për hënën statujë dhe pretenduan që ajo meriton të adhurohet dhe se ajo rregullon botën e poshtme.

Një grup si mexhusët adhuruan zjarrin. Ndërtuan për të shumë tempuj e për këtë qëllim morën murgj, shërbyes dhe rojtarë të cilët nuk e lejonin që të fiket për asnjë çast.

Një grup adhuruan ujin, pretenduan që uji është origjinë e çdo gjëje dhe me të ndodh çdo lindje, rritje, zhvillim, pastërti dhe ndërtesë.

Një grup adhuruan gjallesat. Një grup kuajt. Një grup lopët. Një grup njerëzit e vdekur qofshin apo të gjallë. Një grup xhinët. Një grup adhuruan pemët dhe një grup melaiket”. Këtu mbaron fjala e Ibën Kajimit, Allahu e mëshiroftë.

---

<sup>14</sup> Buhariu 1/133.

<sup>15</sup> Igathetul-lehfan 2/202.

<sup>16</sup> Igathetul-lehfan 2/218, 219, 229, 230, 231, 233.

Prej etherit që sollëm nga Ibën Abasi me transmetimin e Buhariut, ku sqarohet shfaqja e shirkut në popullin e Nuhut, kuptojmë:

- ❖ **Së pari:** Rrezikun e varjes së pikturave në mure dhe ngritjen e statujave në qendra e sheshe. Kjo i çon njerëzit në shirk, ku madhërimi i këtyre pikturave dhe statujave përshkallëzohet deri në adhurimin e tyre, në besimin se ato sjellin të mirën dhe mbrojnë nga e keqja, ashtu siç ndodhi me popullin e Nuhut.
- ❖ **Së dyti:** Përpykja e Shejtanit në devijimin e bijve të Ademit dhe kurthi e tij ndaj tyre. Ai mund t'u vijë atyre nga shtegu i shfytëzimit të ndjenjave dhe pretendimit të arritjes për tek e mira. Kur Shejtani shikoi tek populli i Nuhut lidhjen e tyre të fortë me njerëzit e mirë dhe dashurinë për ta, i ftoi ta tejkalonin kufirin në këtë dashuri duke i urdhëruar që të ngrinin statujat në vendqëndrime. Pikësynimi i tij ishte t'i largojë me këtë gjë nga rruga e drejtë.
- ❖ **Së treti:** Shejtani nuk e kufizon synimin e tij vetëm tek devijimi i brezave të sotëm, por shtrihet edhe tek brezat e ardhshëm. Kur nuk pati mundësi të hedh shirkun në brezin aktual tek populli i Nuhut, lakmoi për brezin pasardhës dhe i ngriti atij gracka.
- ❖ **Së katërti:** Nuk lejohet shkujdesja ndaj rrugëve të së keqes, por është obligim ndalimi dhe mbyllja e dyerve të tyre.
- ❖ **Së pesti:** Vlera e dijetarëve punëmirë. Prezenca e tyre tek njerëzit është mirësi dhe humbja e tyre është padyshim gjë e keqe. Shejtani nuk pati mundësi të devijojë popullin derisa vdiqën dijetarët.

## LLOJET E TEUHIDIT

Teuhidi është dy lloje: Teuhid në njohje e pohim; ky është Teuhidi Rububije që demostrohet me pohimin e Krijuesit, me veçimin e tij në krijim, drejtim, dhënie të jetës dhe vdekjes, sjellje të së mirës dhe ruajtjen nga e keqja. Këtë lloj nuk e ka kundërshtuar gati askush prej krijesave, madje edhe idhujtarët e pohonin; megjithëse ishin të tillë, nuk e mohonin, ashtu siç ka thënë për ta Allahu i Lartësuar:

﴿ قُلْ مَنْ يَرْزُقُكُمْ مِنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ أَمَّنْ يَمْلِكُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَرَ وَمَنْ يُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ

الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَمَنْ يُدَبِّرُ الْأَمْرَ فَسَيَقُولُونَ اللَّهُ فَقُلْ أَفَلَا تَتَّقُونَ ﴿٣١﴾ يونس: ٣١

**“Thuaj: “Cili ju furnizon nga qielli dhe Toka? Kush e posedon dëgjimin dhe shikimin? Kush e nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe të vdekurin nga i gjalli dhe kush i drejton çështjet?” Do të thonë: “Allahu!” Thuaj atëherë: “A nuk po friksoheni (dhe t’a adhurroni Atë të Vetëm e të Pashok e t’i braktisni ato ç’ka adhuroni veç Tij)?”<sup>17</sup>**

Ka shumë ajete të ngjashme me këtë ajet. Në to ka sqarim të dukshëm që idhujtarët e pohonin këtë lloj Teuhidi. Atë që mohonin idhujtarët ishte lloji e dytë, Teuhidin e adhurimit, të demonstruar në veçimin e Allahut - të Patëmetë e të Lartësuar - në kërkim dhe qëllim në çdo lloj adhurimi që bën njeriu, ashtu siç e argumenton dhe e shpreh fjala La ilahe il-Allah. Kjo fjalë e pohon adhurimin me të gjithë llojet e tij vetëm për Allahun dhe ia mohon të tjerëve. Për këtë shkak, kur Pejgamberi sal-Allahua alejhi ue sel-lem kërkoi prej idhujtarëve që ta thonin këtë fjalë, ata refuzuan duke thënë:

﴿ أَجْعَلُ الْأَلْهَةَ إِلَهًا وَحِدًا إِنَّ هَذَا لَشَيْءٌ عُجَابٌ ﴿٥﴾ ص: ٥

**"A i bëri të adhuruarit një të vetëm, vërtetë që kjo është gjë e çuditshme".<sup>18</sup>**

Për shkak se ata e dinin që kush e thotë këtë fjalë, ka pranuar pavlefshmërinë e adhurimit të çdo gjëje përveç Allahut dhe ka pohuar adhurimin vetëm për Allahun. Fjala "Ilah" do të thotë i adhuruar. Adhurimi është emër përmbledhës i çdo gjëje që Allahu e do dhe me të është i kënaqur, prej veprave dhe fjalëve, të jashtme dhe të brendshme. Kush e shpreh këtë fjalë dhe ai ndërkohë i lutet dikujt tjetër veç Allahut, atëherë është kontradiktor me

<sup>17</sup> Junus:31.

<sup>18</sup> Sad: 5.

vetveten. Lidhja mes Teuhidit Rububije dhe Teuhidit Uluhije është e pandashme, me kuptimin që pohimi i Teuhidit Rububije, kërkon detyrimisht pohimin e Teuhidit Uluhije dhe zbatimin e tij nga ana e jashtme dhe e brendshme. Për këtë shkak, që të gjithë të dërguarit salauatullahi ue selamuhu alejhim, ua këkonin këtë popujve të tyre dhe argumentoheshin me atë çka vetë e pohonin prej Teuhidit Rububije, ashtu siç thotë i Lartësuari:

﴿ ذَٰلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمْ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ خَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ فَأَعْبُدُوهُ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ وَكِيلٌ ﴿١٠٢﴾ الْأَنْعَامُ: ﴿١٠٢﴾

١٠٢

**"Ky pra është Allahu Zoti i juaj, nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij, Krijuesi i çdo gjëje, prandaj adhurojeni dhe Ai është për çdo gjë Kujdestari (Rregulluesi e Drejtuesi i gjithçkaje)".<sup>19</sup>**

﴿ وَلَئِن سَأَلْتَهُم مَّنْ خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ اللَّهُ قُلْ أَفَرَأَيْتُمْ مَا تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ إِنْ أَرَادَنِيَ اللَّهُ بِضُرٍّ هَلْ هُنَّ كَاشِفَاتُ ضُرِّيهِ أَوْ أَرَادَنِي بِرَحْمَةٍ هَلْ هُنَّ مُمْسِكَتُ رَحْمَتِهِ ﴿٣٨﴾ الزمر: ﴿٣٨﴾

٣٨

**"Nëse i pyet se kush i krijoi qiejt edhe Tokën? Do të thonë: "Allahu!" Thuaj: "A po shihni kujt po i luteni përveç Allahut, nëse Allahu dëshiron për mua ndonjë dëm, a mos e largojnë ata dëmin e Tij!? Apo nëse dëshiron për mua të më mëshirojë, a munden ta pengojnë mëshirën e Tij?"<sup>20</sup>**

Pohimi i Teuhidit Rububije është i ngulitur në natyrshmëri. Thuajse nuk gjen kundërshtim tek idhujtarët dhe nuk njihet ndonjë grupacion në botë që ta mohojë këtë lloj, përveç "Dehrijeve" (ateistëve) të cilët mohojnë Krijuesin, duke pretenduar se bota ecën vetë pa dikë që ta drejtojë, ashtu siç thotë Allahu për ta:

﴿ وَقَالُوا مَا هِيَ إِلَّا حَيَاتُنَا الدُّنْيَا نَمُوتُ وَنَحْيَا وَمَا يُهْلِكُنَا إِلَّا الدَّهْرُ ﴿٢٤﴾ الْجاثية: ﴿٢٤﴾

**"Dhe thanë: "Nuk është tjetër veçse jeta jonë e dynjasë, vdesim dhe lindim e nuk na zhduk gjë përveç kohës".<sup>21</sup>**

Allahu sjell përgjigjen kundër tyre dhe thotë:

<sup>19</sup> El En'am:102.

<sup>20</sup> Ez-Zumer: 38.

<sup>21</sup> El Xathijeh: 24.

﴿ وَمَا لَهُمْ بِذَلِكَ مِنْ عِلْمٍ إِنْ هُمْ إِلَّا يَظُنُّونَ ﴾ ﴿٤٤﴾ الجاثية: ٤٤

**"Për këtë nuk kanë kurrfarë dije, mirëpo vetëm hamendësojnë".<sup>22</sup>**

Ata nuk qartësuan këtë mohim të tyrin mbi bazë argumenti, por vetëm mbi supozim të thatë. Hamendësimi nuk ka asnjë vlerë përballë të vërtetës, prandaj nuk i dhanë dot përgjigje fjalës së të Lartësuarit:

﴿ أَمْ خُلِقُوا مِنْ غَيْرِ شَيْءٍ أَمْ هُمْ الْخَالِقُونَ ﴾ ﴿٣٥﴾ أَمْ خَلَقُوا السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بَلْ لَا يُوقِنُونَ ﴿٣٦﴾ الطور:

٣٦ - ٣٥

**"A mos u krijuan nga asgjëja? Apo vetë ata janë krijuar? A mos vallë krijuan qiejtë dhe Tokën? Jo nuk është ashtu, por, ata nuk janë të bindur".<sup>23</sup>**

As nuk iu përgjigjën fjalës së Tij:

﴿ هَذَا خَلْقُ اللَّهِ فَأَرُونِي مَاذَا خَلَقَ الذِّبَابُ مِنْ دُونِهِ ﴾ ﴿١١﴾ لقمان:

**"Ky është krijimi i Allahut, andaj më tregoni çfarë kanë krijuar të tjerët pos Tij".<sup>24</sup>**

﴿ قُلْ أَرَأَيْتُمْ مَا تَدْعُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ أَرُونِي مَاذَا خَلَقُوا مِنَ الْأَرْضِ أَمْ لَهُمْ شِرْكٌ فِي السَّمَوَاتِ ﴾ ﴿٤﴾

الأحقاف:

**"Thuaj: "Më kallëzoni për ato që i luteni veç Allahut! Më tregoni çka krijuan nga Toka? Apo mos kanë pjesëmarrje në krijimin e qiejve?"<sup>25</sup>**

Kush e shfaqti sipërfaqësisht mohimin e këtij lloji Teuhidi, sikurse Faraoni, në të vërtetë e pohonte përbrenda atë, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ قَالَ لَقَدْ عَلِمْتُمْ مَا أَنْزَلَ هَؤُلَاءِ إِلَّا رَبُّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ﴾ ﴿١٠٢﴾ الإسراء:

**"Padyshim e ke ditur, që ato (mrekullitë e Musait) i zbriti vetëm Zoti i qiejve dhe Tokës".<sup>26</sup>**

Ndërsa për të dhe popullin e tij thotë:

<sup>22</sup> El Xhathijeh: 24.

<sup>23</sup> Et-Tur: 35-36.

<sup>24</sup> Lukman: 11.

<sup>25</sup> Ahkaf: 4.

<sup>26</sup> El Isra': 102.

﴿ وَجَحَدُوا بِهَا وَاسْتَيْقَنَتْهَا أَنفُسُهُمْ ظُلْمًا وَعُلُوًّا ﴾ النمل: ١٤

**"Në dukje i mohuan (argumentet), për shkak të padrejtësisë dhe kryelartësisë, por ishin të bindur në vetvete".<sup>27</sup>**

I Lartësuarit thotë për popujt e hershëm:

﴿ وَعَادًا وَثَمُودًا وَقَدْ تَبَيَّنَ لَكُمْ مِّن مَّسْكِنِهِمْ<sup>ط</sup> وَزَيْنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ أَعْمَالَهُمْ

فَصَدَّهُمْ عَنِ السَّبِيلِ وَكَانُوا مُسْتَبْصِرِينَ ﴿ ٣٨ ﴾ العنكبوت: ٣٨

**"E njëjta gjë u ndodhi edhe fiseve Ad dhe Themud, gjë që ju është bërë e qartë prej (gjurmëve të) banimeve të tyre. Atyre Shejtani ua kishte zbukuruar veprat e veta dhe i kishte shmangur nga rruga e drejtë, edhe pse ishin të vetëdijshëm".<sup>28</sup>**

Meqënëse mohimin e këtij lloj Teuhidi nuk e ka deklaruar ndonjë grupacion i njohur nga bijtë e Ademit, në përgjithësi nuk ka ndodhur shirk në të. Të gjithë pohojnë se Allahu është i Vetëm në krijim, në drejtim dhe nuk është vërtetuar nga asnjë prej grupeve në botë që të pohojnë dy krijues të njëjtë në cilësi dhe vepra. Sekti Thanauit prej mexhusëve, të cilët kanë pretenduar se bota ka dy krijues - krijues i së mirës që është drita dhe krijues i së keqes që është errësira - nuk e barazojnë errësirën me dritën. Drita për ta është origjina dhe errësira ka dalë më vonë. Ata janë në një mendje që drita është më e mirë se errësira.

Po ashtu edhe të krishterët që shprehin trinitetin, nuk deklarojnë për botën tre zota të ndarë njëri nga tjetri, madje ata janë në unanimitet që krijuesi i botës është një i vetëm. Gjithashtu thonë se Ati është i adhuruari më i madh.

Praktikisht, pohimi i Teuhidit Rububije është fushë dakortësie dhe shirku është i paktë në të. Por, vetëm ky pohim nuk mjafton për njeriun që të hyjë në Islam. Bashkë me të duhet patjetër që të sjellë edhe të pandashmen e saj; Teuhidin Uluhije. Popujt jobesimtarë e pohonin Teuhidin Rububije dhe në veçanti idhujtarët arab tek të cilët u dërgua i Dërguari i fundit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, e megjithatë, me këtë nuk u bënë muslimanë, pasi nuk erdhën me Teuhidin Uluhije. Ai që hulumton ajetet e Kuranit Famëlartë, do të gjejë në to thirrjen për në Teuhidin Uluhije dhe argumentimin me Teuhidin Rububije për

<sup>27</sup> En-Neml: 14.

<sup>28</sup> El Ankebut: 38.

Teuhidin Uluhije. Këto ajete i kërkojnë idhujtarëve atë që e mohuan sipërfaqsisht, duke u argumentuar për Teuhidin Uluhije me Teuhidin Rububije që e pohuan. Ato urdhërojnë për Teuhidin e adhurimit dhe tregojnë për pohimin e Teuhidit Rububije që bënë idhujtarët. Ajetet e përmendin Teuhidin e adhurimit në kontekstin e urdhërit, ndërsa Teuhidin Rububije në kontekstin kallëzues.

Urdhëri i parë i ardhur në Kuran është Fjala e të Lartësuarit:

﴿يَأْتِيهَا النَّاسُ أَعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٢١﴾ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٢﴾﴾ البقرة: ٢١ - ٢٢

**"O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi juve dhe ata para jush, ashtu që të jeni të devotshëm. Atë, i Cili tokën ua bëri shtrat e qiellin kulm dhe prej qiellit ju lëshoi shi me të cilin ju nxorri lloje frutash si ushqim për ju, andaj mos i bëni Allahut ortakë (në adhurim) duke qënë se jeni të vetëdijshëm (që Ai nuk ka të ngjashëm si në krijim dhe në adhurim)".<sup>29</sup>**

Në Kuranin Famëlartë, ftesën për tek Teuhidi i adhurimit e gjejmë dendur, po ashtu urdhërimin për të dhe përgjigjet e dyshimeve që janë hedhur rreth tij. Çdo sure në Kuran, madje çdo ajet të fton te ky Teuhid, sepse Kurani ose të tregon për Allahun, emrat, cilësitë dhe veprat e Tij; e ky është Teuhidi Rububije, ose është ftesë për tek adhurimi i Tij i Vetëm e i Pashok dhe braktisjen e asaj që adhurohet veç Tij; e ky është Teuhidi Uluhije, ose tregon për nderimin që Allahu i bën njerëzve të Teuhidit e të bindjes ndaj Tij në këtë Botë dhe në Ahiret; e ky është shpërblimi i veçimit të Tij në adhurim, ose tregon për njerëzit e shirkut dhe ndëshkimin e tyre në këtë Botë dhe në Ahiret; e ky është ndëshkimi i atij që largohet nga Teuhidi, ose tregon për ligje dhe dispozita; e kjo bën pjesë tek obligimet e Teuhidit, sepse ligjënia është vetëm e drejtë e Allahut.

Këtë Teuhid, bashkë me të gjithë llojet dhe të drejtat e tij, e përmban një fjalë e vetme dhe ajo është: La ilahe il-Allah. Kjo fjalë përmban mohim dhe pohim. Mohimin e adhurimit me të drejtë nga të tjerët përveç Allahut dhe pohimin e Tij vetëm për Allahun. Kjo fjalë gjithashtu përmban dashurinë dhe

<sup>29</sup> El Bekareh: 21-22.

urrejtjen; dashurinë për Allahun dhe urrejtjen e asaj çka adhurohet veç Tij. Feja e Teuhidit është e ndërtuar mbi këto dy themele, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar për Ibrahimin, mikun e Tij të dashur sal-Allahun alejhi ue sel-lem kur i tha popullit të tij:

﴿وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ إِنَّنِي بَرَاءٌ مِّمَّا تَعْبُدُونَ ﴿٦٦﴾ إِلَّا الَّذِي فَطَرَنِي فَإِنَّهُ سَيَهْدِينِ ﴿٦٧﴾﴾ الزخرف:

٢٧ - ٢٦

**"Unë me urrejtje jam distancuar nga çka adhuroni ju, përveç Atij që më ka krijuar, sigurisht që Ai do më drejtjë".<sup>30</sup>**

Ky është menhexhi i çdo të dërguari që ka sjellë Allahu. I Lartësuari thotë:

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ ﴿٣٦﴾﴾ النحل: ٣٦

**"Vërtetë Ne kemi dërguar tek çdo popull të dërguar (për t'i thënë): "Adhuroni Allahun dhe largohuni Tagutit (çdo gjëje që adhurohet veç Tij)".<sup>31</sup>**

I Lartësuari thotë:

﴿فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنْ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ لَا انفِصَامَ لَهَا ﴿٢٥٦﴾﴾ البقرة: ٢٥٦

**"E kush mohon tagutin dhe beson Allahun, ai është kapur për lidhjen më të sigurtë e cila nuk këputet".<sup>32</sup>**

Kush thotë La ilahe il-Allah, vetëm se i ka shpallur armiçësi adhurimit të çdo gjëje veç Allahut dhe ka marrë mbi supe kryerjen e adhurimit të Allahut, e kjo është besë që njeriu ia përcakton vetes së tij:

﴿فَمَنْ نَكَثَ فَإِنَّمَا يَنْكُثُ عَلَىٰ نَفْسِهِ ﴿١٠﴾ وَمَنْ أَوْفَىٰ بِمَا عَاهَدَ عَلَيْهِ اللَّهُ فَمَسْئُولُهُ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿١١﴾﴾

الفتح: ١٠

**"Kush e thyen besën, ai e thyen kundra vetes së tij dhe kush e përmbush besën që ia ka dhënë Allahut, Ai do t'i japë shpërblim të madh".<sup>33</sup>**

<sup>30</sup> Ez-Zuhruf: 26-27.

<sup>31</sup> En-Nahl:36.

<sup>32</sup> El Bekareh: 256.

<sup>33</sup> El Fet'h: 10.



Pra, fjala La ilahe il-lAllah është deklarim i Teuhidit të adhurimit, sepse fjala *Ilah* do të thotë i adhuruar, andaj kuptimi i saj është se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut. Kush e thotë këtë fjalë duke ia njohur kuptimin, duke punuar me atë që ajo kërkon prej mohimit të shirkut, prej pohimit të veçimit të Allahut, duke e besuar dhe punuar me të, atëherë ai është musliman i vërtetë. Kush e thotë dhe zbaton kërkesat e saj nga ana sipërfaqësore, pa e besuar me zemër, atëherë ai është munafik (hipokrit, dyfyturësh). Kush e thotë me gjuhën e tij dhe punon të kundërtën e saj; bën shirkun që hedh poshtë kuptimin e fjalës La ilahe il-lAllah, atëherë i këtilli është mosbesimtar, edhe nëse e thotë dhe e përsërit shumë herë, siç është gjendja e adhuruesve të varreve sot, të cilët e shprehin këtë fjalë pa ia kuptuar domethënien. Ajo nuk shkakton asnjë ndikim në ndryshimin e sjelljeve dhe përmirësimit e punëve të tyre. E shikon tek thotë La ilahe il-lAllah e më pas thotë: “Ndihmë o AbdulKadir! O Bedeui! O filan dhe o filan!” Kërkon ndihmë nga të vdekurit dhe kërkon shpëtim prej tyre në momentet e vështira. Idhujtarët e hershëm, kuptuan prej domethënies së kësaj fjale atë çka nuk e kuptuan këta të mëvonshmit. Ata arritën të kuptojnë se kur i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tha atyre: “Thoni La ilahe il-lAllah”, njëkohësisht i kërkoi braktisjen e adhurimit të idhujve dhe adhurimin e Allahut të vetëm, për këtë shkak thanë:

﴿ أَجْعَلُ الْآلِهَةَ إِلَهًا وَحِدًا ﴾ ص: ٥

**"A i bëri të adhuruarit një të vetëm".<sup>34</sup>**

Populli i Hudit thanë:

﴿ أَجِئْتَنَا لِنَعْبُدَ اللَّهَ وَحْدَهُ، وَنَذَرَ مَا كَانَ يَعْبُدُ آبَاؤُنَا ﴾ الأعراف: ٧٠

**"A mos vallë erdhe të adhurojmë Allahun një të Vetëm, e të braktisim çka adhuruan baballarët tanë?!"<sup>35</sup>**

Populli i Salihut i thanë atij:

﴿ أَتَهْتِنَا أَنْ نَعْبُدَ مَا يَعْبُدُ آبَاؤُنَا ﴾ هود: ٦٢

**"A po na ndalon që të adhurojmë çka adhuruan baballarët tanë?!"<sup>36</sup>**

<sup>34</sup> Sad: 5.

<sup>35</sup> El Earaf: 70.

<sup>36</sup> Hud: 62.

Më herët populli i Nuhut i thanë atij:

﴿ وَقَالُوا لَا تَذَرُنَّ آلِهَتَكُمْ وَلَا تَذَرُنَّ وَدًّا وَلَا سُوَاعًا وَلَا يَغُوثَ وَيَعُوقَ وَنَسْرًا ﴾ ﴿٢٣﴾ نوح: ٢٣

**“Ata thanë: “Kurrresi mos braktisni të adhuruarit tuaj! Mos braktisni Uedin, Suanë, Jeguthin, Jeukin dhe Nesranë!”<sup>37</sup>**

Kjo është ajo që mosbesimtarët kuptuan prej fjalës La ilahe il-lAllah; heqja dorë nga adhurimi i idhujve dhe drejtimi për tek adhurimi i Allahut të Vetëm. Ky qe shkak që refuzuan ta shprehin fjalën La ilahe il-lAllah, sepse ajo nuk puqet me adhurimin e Latit, Uzait e Menatit. Adhuresit e varreve sot nuk e perceptojnë këtë kontradiktë. Ata e shprehin fjalën La ilahe il-lAllah dhe vazhdojnë në adhurimin e të vdekurve. Disa prej tyre e komentojnë fjalën *Ilah* si i Plotfuqishmi për të shpikur, krijuar dhe për të sjellë në ekzistencë.<sup>38</sup> Sipas tyre, kuptimi i fjalës La ilahe il-lAllah del të jetë: Askush nuk është i plotfuqishëm për të shpikur përveç Allahut. Kjo është prej gabimeve më vulgare, sepse ai që e komenton në këtë mënyrë, nuk ka shtuar asgjë nga pohimi i mosbesimtarëve. Ata pohonin që askush veç Allahut nuk ka fuqi të shpikë, të krijojë, të furnizojë, të japë jetë dhe ta marrë atë; siç e tregon këtë Allahu i Lartësuar për ta. Megjithatë, ata nuk u bënë muslimanë. Po, ky kuptim që e përmendin, është brenda fjalës La ilahe il-lAllah, mirëpo nuk është ky qëllimi me këtë fjalë.

## SHIRKU NË TEUHIDIN E ADHURIMIT

Shirku në adhurim është dedikimi i adhurimit në formë të plotë ose të pjesëshme dikujt tjetër veç Allahut. Më lart kemi cekur fillimin e shfaqjes së shirkut në tokë, i cili vazhdon të jetë prezent ndër krijesa; përveç tek ata që i ka mëshiruar Allahu.

Shirku është dy llojesh: **shirk i madh**, i cili të nxjerr nga feja si psh bërja kurban (flijimi) për dikë tjetër veç Allahut, lutja dikujt tjetër veç Tij apo dedikimi i një prej llojeve të adhurimit dikujt tjetër veç Allahut, po ashtu dhe

<sup>37</sup> Nuh: 23.

<sup>38</sup> Siç përmendet në librat e akides që janë shkruar sipas mënyrës së filozofëve. Shiko për shembull librin “Risaletu et-Teuhid” të Muhamed Abduh.

**shirk i vogël**, i cili nuk të nxjerr nga feja, mirëpo e mangëson Teuhidin. Ky i fundit mund të përshkallëzohet bashkë me personin, derisa ta çojë në shirk të madh. Për shembull: betimi për dikë tjetër veç Allahut, syfaqësia e tepërt, fjala "çfarë dëshiroi Allahu dhe ti", fjala "sikur mos të ishte Allahu dhe ti" e të ngjashme me këto shprehje të cilat qarkullojnë në gjuhët e njerëzve, ku kuptimi i tyre nuk është për qëllim.

Shirku është shtuar në këtë umet dhe çështja e tij është zmadhuar për shkak të largimit të shumicës së njerëzve nga Kurani dhe Suneti, për shkak të pasimit të verbër të baballarëve dhe gjyshërve të devijuar, për shkak të teprimit në madhërimin e të vdekurve dhe ndërtimen mbi varret e tyre, për shkak të injorancës ndaj asaj çka është realisht feja Islame me të cilën Allahu e dërgoi të Dërguarin e Tij sal-Allahu alejhi ue sel-lem, ashtu siç thotë prijësi i besimtarëve Umer ibnul Hattab radijAllahu anhu: "Lidhja Islamit zgjidhet nyje pas nyje, kur rritet në Islam ai që nuk e njeh injorancën". Shirku gjithashtu është shtuar për shkak të përhapjes së dyshimeve dhe përrallave me të cilat kanë humbur shumica e njerëzve, të cilat i kanë llogaritur si argumente ku mbi to mbështeten për justifikimin e gjëndjes së tyre. Ka prej dyshimeve që janë marrë për argumente nga idhujtarët e popujve të mëparshëm dhe ka prej tyre që janë marrë për argumente nga idhujtarët e këtij umeti.

Prej këtyre dyshimeve janë:

**Së pari:** është një dyshim që është gati i përbashkët mes gjithë grupeve idhujtare të popujve të ndryshëm, qofshin të vjetër apo të rinj. Ky është dyshimi i argumentimit me atë çka ishin baballarët e gjyshërit dhe se ata e trashëguan këtë besim prej tyre, siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿وَكَذَلِكَ مَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ فِي قَرْيَةٍ مِّنْ نَّذِيرٍ إِلَّا قَالَ مُتْرَفُوهَا إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ آثِمَةٍ وَإِنَّا عَلَىٰ آثَارِهِمْ مُّقْتَدُونَ ﴿٢٣﴾ الزخرف: ٢٣﴾

"Kështu pra, në çdo vend që Ne kemi dërguar paralajmërues para teje, vetëm se paria e tyre tha: "Kemi gjetur baballarët tanë në një fe dhe pas gjurmëve të tyre do të ecim".<sup>39</sup>

Tek ky dyshim kthehet gjithkush që e ka të pamundur të ngrejë argument. Argumenti i tyre është i paqëndrueshëm dhe pa peshë në fushën e

<sup>39</sup> Ez-Zuhruf: 23.

debatit, sepse ata baballarë të cilët i pasuan verbërisht, nuk kanë qenë të udhëzuar, e kush është i tillë nuk lejohet ta pasosh apo ta marrësh shembull. I Lartësuari thotë:

﴿أُولَٰئِكَ كَانَ ءَابَاؤُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ شَيْئًا وَلَا يَهْتَدُونَ﴾ المائدة: ١٠٤

**"A (mjafton) edhe nëse baballarët e tyre ishin që nuk dinin asgjë dhe nuk ishin të udhëzuar?!"<sup>40</sup>**

Po ashtu ka thënë:

﴿أُولَٰئِكَ كَانَ ءَابَاؤُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ شَيْئًا وَلَا يَهْتَدُونَ﴾ البقرة: ١٧٠

**"A mos baballarët e tyre nuk kanë kuptuar dhe nuk kanë qenë të udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t'i pasonin)?!"<sup>41</sup>**

Pasimi i baballarëve është gjë e lëvdur kur ata kanë qenë në të drejtë. Allahu i Lartësuar thotë për Jusufin alejhis-selam:

﴿وَاتَّبَعْتُ مِلَّةَ ءَابَائِي إِبْرَاهِيمَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ ۚ مَا كَانَ لَنَا أَنْ نَشْرِكَ بِاللَّهِ مِنْ شَيْءٍ ۚ ذَٰلِكَ مِنْ فَضْلِ

اللَّهِ عَلَيْنَا وَعَلَى النَّاسِ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَشْكُرُونَ﴾ يوسف: ٣٨

**"Unë ndoqa fenë e prindërve të mi; Ibrahimit, Is'hakut dhe Jakubit. Neve nuk na takoi t'i bëjmë Allahut shirk ndonjë gjë. Ky (besim i drejtë) është prej dhuratave të mëdha të Allahut ndaj nesh dhe ndaj njerëzve, porse shumica e njerëzve nuk falenderojnë".<sup>42</sup>**

Dhe thotë:

﴿وَالَّذِينَ ءَامَنُوا وَاتَّبَعَتْهُمْ ذُرِّيَّتُهُمْ بِإِيمَانٍ أَلْحَقْنَا بِهِمْ ذُرِّيَّتَهُمْ﴾ الطور: ٢١

**"E ata që vetë besuan e edhe pasardhësit e tyre ishin me besim, Ne atyre do t'ua shoqërojmë pasardhësit".<sup>43</sup>**

Ky lloj dyshimi ka hedhur rrënjë në zemrat e idhujtarëve, në mënyrë të atillë që i kundërvihen thirrjeve të Pejgamberëve alejhimus-salatu ues-selam me të. Ja populli i Nuhut, kur Nuhu i tha atyre:

<sup>40</sup> El Maideh: 104.

<sup>41</sup> El Bekareh: 170.

<sup>42</sup> Jusuf: 38.

<sup>43</sup> Et-Tur: 21.

﴿ يَقَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ ۗ أَفَلَا تَتَّقُونَ ﴿٢٣﴾ فَقَالَ الْمَلَأُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ قَوْمِهِ مَا هَذَا إِلَّا بَشَرٌ مِثْلُكُمْ يُرِيدُ أَنْ يَتَفَضَّلَ عَلَيْكُمْ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَأَنْزَلَ مَلَائِكَةً مَا سَمِعْنَا بِهَذَا فِي آبَائِنَا الْأَوَّلِينَ ﴿٢٤﴾﴾ الْمُؤْمِنُونَ: ٢٣ - ٢٤

**“O populli im! Adhuroni vetëm Allahun, nuk keni të adhuroar tjetër me të drejtë veç Tij! A nuk frikësoheni?!”** Paria që mohuan nga populli i tij tha: **“Ky është vetëm njeri sikur ju dhe dëshiron të jetë më i lartë se ju. Po të donte Allahu, do të zbriste melaïke. Ne nuk e kemi dëgjuar një gjë të tillë tek të parët tanë”**.<sup>44</sup>

Për argument sollën qëndrimin e baballarëve të tyre, me të cilën iu kundërpërgjigjën asaj me të cilën erdhi pejgamberi i tyre Nuhu alejhsi-selam.

Populli i Salihut i thanë atij:

﴿ أَنْتَهِنَّا أَنْ نَعْبُدَ مَا يَعْبُدُ آبَاؤُنَا ﴾ هُود: ٦٢

**"A po na ndalon që të adhurojmë çka adhuruan prindërit tanë?!"**<sup>45</sup>

Populli i Shuajbit i thanë atij:

﴿ أَصَلَوْتُكَ تَأْمُرُكَ أَنْ نَتْرِكَ مَا يَعْبُدُ آبَاؤُنَا ﴾ هُود: ٨٧

**"A mos vallë a namazi yt po të thotë të na urdhërosh që ta braktisim atë çfarë adhuruan prindërit tanë?!"**<sup>46</sup>

Populli i Ibrahimit iu përgjigj kështu pasi ai i mundi me argument kur i tha:

﴿ مَا تَعْبُدُونَ ﴿٧٠﴾ قَالُوا نَعْبُدُ أَصْنَامًا فَنَظَلُّ لَهَا عَافِيَةً ﴿٧١﴾ قَالَ هَلْ يَسْمَعُونَكُمْ إِذْ تَدْعُونَ ﴿٧٢﴾ أَوْ يَنْفَعُونَكُمْ أَوْ يُضُرُّونَ ﴿٧٣﴾ قَالُوا بَلْ وَجَدْنَا آبَاءَنَا كَذَلِكَ يَفْعَلُونَ ﴿٧٤﴾﴾ الشُّعْرَاءُ: ٧٠ - ٧٤

**"Çfarë jeni duke adhuroar?"** Thanë: **"Adhurojmë idhuj dhe vazhdimisht u jemi përkushtuar atyre".** Ai i tha: **"A ju dëgjojnë kur i luteni? Apo mos ju sjellin dobi apo dëm?"** Thanë: **"Kështu i kemi gjetur të bëjnë edhe prindërit tanë"**.<sup>47</sup>

<sup>44</sup> El Mu'minun: 23-24.

<sup>45</sup> Hud: 62.

<sup>46</sup> Hud: 87.

<sup>47</sup> Esh-Shuara': 70-74.

Faraoni i ka thënë Musait:

﴿ قَالَ فَمَا بَالُ الْقُرُونِ الْأُولَىٰ ﴾ طه: ٥١

**“Tha: “Si është gjendja e popujve të mëparshëm (të cilët janë shembulli ynë)?”<sup>48</sup>**

Kështu pra, i gjithë kufri është një fe e vetme. Ithtarët e tij nuk posedojnë argument për të refuzuar të vërtetën, përveç këtij argumenti të rreckosur.

**Së dyti:** dyshimi tek i cili u kapën idhujtarët Kurejshit dhe të tjerë, është argumentimi me kaderin (caktimin) për të justifikuar gjendjen e shirkut që ndodheshin. Allahu i Lartësuar thotë në suren el En’am:

﴿ سَيَقُولُ الَّذِينَ أَشْرَكُوا لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا أَشْرَكْنَا وَلَا آبَاؤُنَا وَلَا حَرَمْنَا مِنْ شَيْءٍ ﴾ الأنعام: ١٤٨

**“Ata që ishin idhujtarë do të thonë: “Sikur të donte Allahu nuk do të bënin shirk as ne, as prindërit tanë dhe as nuk do të ndalonim ndonjë gjë”.<sup>49</sup>**

Në suren en-Nahl thotë:

﴿ وَقَالَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا عَبَدْنَا مِنْ دُونِهِ مِنْ شَيْءٍ نَحْنُ وَلَا آبَاؤُنَا وَلَا حَرَمْنَا مِنْ دُونِهِ ﴾

﴿ مِنْ شَيْءٍ ﴾ النحل: ٣٥

**“Ata që bënë shirk thanë: “Sikur të kishte dashur Allahu, as ne dhe as prindërit tanë nuk do të adhuronim ndonjë gjë pos Tij, gjithashtu nuk do të ndalonim (nuk do ta konsideronim të ndaluar) asgjë veç ndalesave të Tij”.<sup>50</sup>**

Thotë në suren ez-Zuhruf:

﴿ وَقَالُوا لَوْ شَاءَ الرَّحْمَنُ مَا عَبَدْنَاهُمْ ﴾ الزخرف: ٢٠

**“Dhe thanë: “Sikur të kishte dashur i Gjithëmëshirshmi, ne nuk do t'i adhuronim ata”.<sup>51</sup>**

<sup>48</sup> TaHa: 51.

<sup>49</sup> El En’am: 148.

<sup>50</sup> En-Nahl: 35.

<sup>51</sup> Ez-Zuhruf: 20.

Hafidh Ibën Kethiri thotë tek ajeti i sures el En'am:<sup>52</sup> “Kjo është një përballje të cilën e tregon Allahu i Lartësuar. Ky është një dyshim për të cilin u kapën idhujtarët në shirkun e tyre dhe në bërjen haram të asaj që e bënë. Sipas tyre, meqë Allahu e sheh gjendjen e shirkut në të cilin janë dhe bërjen haram të asaj që bënë, ndërkohë që Ai është i fuqishëm ta ndryshojë duke na udhëzuar në besim dhe duke na penguar nga kufri. Meqë Allahu nuk e ndryshoi gjendjen, kjo do të thotë se ajo që bëjmë është në dëshirën, vullnetin dhe pëlqimin e Tij.

Ky është argument i pabazë dhe i kotë, sepse po të ishte i saktë, nuk do t'i kishte zbritur dënim, nuk do t'i shkatërronte, nuk do t'i dërgonte të dërguarit e Tij të ndershëm dhe t'i bënte këta idhujtarë të shijojnë prej hakmarrjes së Tij të dhimbshme:

﴿ قُلْ هَلْ عِنْدَكُمْ مِّنْ عِلْمٍ ﴿١٤٨﴾ ﴾

**“Thuaj: “A keni kurrfarë diturie”** që Allahu është i kënaqur me ju në gjendjen që ndodheni?

﴿ فَتُخْرِجُوهُ لَنَا ﴿١٤٩﴾ ﴾

**“E të na e nxirrnin neve”**, pra, të na e shfaqni, të na e sqaroni e të na e zbuloni neve.

﴿ إِن تَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ ﴿١٥٠﴾ ﴾

**“Ju ndiqni vetëm supozime”**, hamendësi dhe fantazi.

﴿ وَإِن أَنْتُمْ إِلَّا تَخْرُصُونَ ﴿١٥١﴾ ﴾

**“Dhe ju vetëm po trilloni”**, po gënjeni për Allahun në atë që pretendoni”. Këtu përfundon fjala e Tij.

Ibën Kethiri po ashtu ka thënë në komentimin e ajetit të sures en-Nahl:<sup>53</sup> “Përmbajtja e fjalës së tyre është se: sikur Allahu i Lartësuar ta urrente atë që bëmë, do t'i kundëvihej me dënim dhe jo ta lejonte që ta bënim. Allahu i Lartësuar thotë duke ia kundërshtuar dyshimin e tyre:

﴿ فَهَلْ عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ ﴿٣٥﴾ النحل: ٣٥ ﴾

<sup>52</sup> Tefsir Ibni Kethir 2/186.

<sup>53</sup> Tefsir Ibni Kethir 2/586-587.

**“A kanë të dërguarit obligim tjetër veç përcjelljes së qartë?”<sup>54</sup>**

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ فَمِنْهُمْ مَن هَدَى اللَّهُ وَمِنْهُمْ مَن حَقَّتْ عَلَيْهِ الضَّلَالَةُ فسيروا فِي الْأَرْضِ فَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُكذِّبِينَ ﴿٣٦﴾﴾

النحل: ٣٦

**"Vërtetë Ne kemi dërguar tek çdo popull të dërguar (për t'i thënë): "Adhuroni Allahun dhe largohuni Tagutit (çdo gjëje që adhurohet veç Tij). Pati prej tyre që Allahu i udhëzoi e të tjerë që e merituan humbjen, udhëtoni pra nëpër tokë dhe shihni se si ishte fundi i përgënjeshtresve".<sup>55</sup>**

Pra, çështja nuk është si pretendoni se Ai nuk ua ka kundërshtuar, madje ua ka kundërshtuar me forcë, ua ka ndaluar me ndalesë të prerë dhe dërgoi **"tek çdo popull"**, pra, tek çdo popull dhe bashkësi njerëzish të dërguar. Që të gjithë të dërguarit ftonin tek adhurimi i Allahut dhe ndalonin nga adhurimi i të tjerëve: **"Adhuroni Allahun dhe largohuni Tagutit"**. Allahu i Lartësuar ka vazhduar të dërgojë tek njerëzit të dërguar me këtë mesazh, prej kohës kur u shfaq shirku tek bijtë e Ademit, te populli i Nuhut, te të cilët u dërgua Nuhu që ishte i dërguar i parë të cilin Allahu e solli te banorët e tokës, deri sa i përmbylli me Muhamedin sal-Allahu alejhi ue sel-lem, thirrja e të cilit u shtri tek njerëzit dhe xhinët, nga lindja në perëndim. Të gjithë janë siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رَسُولٍ إِلَّا نُوحِيَ إِلَيْهِ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدُونِ ﴿٢٥﴾﴾ الأنبياء: ٢٥

**"Ne nuk kemi sjellë asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: "S'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!"<sup>56</sup>**

Po ashtu ka thënë:

﴿وَسَأَلَ مَنْ أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رُسُلِنَا أَجَعَلْنَا مِنْ دُونِ الرَّحْمَنِ إِلَهًا يُعْبَدُونَ ﴿٤٥﴾﴾ الزخرف: ٤٥

**"Pyet ata që dërguam para teje prej të dërguarve, a lejuam të adhuruar të tjerë përveç të Gjithëmëshirshmit?"<sup>57</sup>**

<sup>54</sup> En-Nahl: 35.

<sup>55</sup> En-Nahl:36.

<sup>56</sup> El Enbija': 25.

<sup>57</sup> Ez-Zuhruf: 45.



I Lartësuar i thotë në këtë ajet madhështor:

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ﴾ النحل: ٣٦

**"Vërtetë Ne kemi dërguar tek çdo popull të dërguar (për t'i thënë): "Adhuroni Allahun dhe largohuni Tagutit (çdo gjëje që adhurohet veç Tij)." <sup>58</sup>**

Pas kësaj, si guxon ndonjë idhujtar të thotë: "Po të mos donte Allahu, nuk do të adhuronim veç Tij asgjë". Dëshira ligjore e Allahut të Lartësuar nuk është prezente tek ta, sepse Ai i ka ndaluar nga kjo gjë përmes gjuhës së të dërguarve të Tij. Kurse përsa i përket dëshirës së Tij të Gjithësishtme, që është dhënia atyre mundësi veprimi pasi është caktuar, ata nuk kanë asnjë argument për të. Tha: Allahu i Lartësuar ka njoftuar se i ka kundërshtuar me ndëshkim në Dynja pas paralajmërimit të të dërguarve". Këtu mbaroi fjala e tij.

Me këtë fjalë, ata nuk kërkojnë justifikim për këtë poshtërsi, sepse nuk besojnë në poshtërsinë e veprave të tyre, madje ata "pandehin se po veprojnë bukur", ndërkohë që po adhurojnë idhujt ﴿إِلَّا لِيُقْرَبُنَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَى﴾ **"vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut"**.<sup>59</sup> Me këtë gjë, ata duan vetëm të argumentojnë se ajo që bëjnë është e drejtë, e ligjëruar dhe e dashur tek Allahu. I Lartësuar i ka kthyer përgjigje, se po të ishte çështja ashtu, nuk do të dërgonte të dërguar për t'i paralajmëruar dhe as do t'i dënonte për të.

**Së treti:** prej dyshimeve të tyre është edhe hamendësimi se e shprehura formale e fjalës La ilahe il-lAllah, mjafton për të hyrë në Xhenet edhe nëse njeriu vepron ç'ka vepron prej punëve të kufrit dhe shirkut. Kjo duke u mbështetur në anën sipërfaqësore të haditheve në të cilat citohet se ai që thotë dy dëshmitë,<sup>60</sup> Zjarri i bëhet haram.

Përgjigjja për këtë dyshim është se hadithet e përmendura lidhen me atë që kush thotë La ilahe il-lAllah dhe nuk e rrëzon me shirk, por e thotë me pastërti nga zemra e tij duke mohuar çka adhurohet veç Tij dhe vdes në këtë gjendje, ashtu siç citohet në hadithin e Utbanit:

<sup>58</sup> En-Nahl: 36.

<sup>59</sup> Ez-Zumer: 3.

<sup>60</sup> Pra, La ilahe il-lAllah, Muhammedun Resulullah. (shp)

**“Allahu ia ka bërë haram Zjarrin atij që thotë La ilahe il-lAllah, e me këtë kërkon Fytyrën e Allahut”.<sup>61</sup>**

Gjithashtu në sahihun e Muslimit:

**“Kush thotë La ilahe il-lAllah dhe mohon çka adhurohet veç Allahut, pasuria dhe gjaku i tij bëhen haram, kurse llogaria e tij është tek Allahu”.<sup>62</sup>**

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ka lidhur pacënueshmërinë e pasurisë dhe gjakut me dy gjëra: **e para:** thënia La ilahe il-lAllah dhe **e dyta:** mohimi i asaj çka adhurohet veç Allahut. Nuk është mjaftuar vetëm me shprehjen pa përmbajtjen, por patjetër duhet ta thotë e të punojë me të. Fjala La ilahe il-lAllah është shkak për të hyrë në Xhenet, për të shpëtuar nga Zjarri dhe është rrjedhim i saj, mirëpo shkak dhe rrjedhoja e bëjnë punën e tyre vetëm nëse realizohen kushtet dhe hiqen pengesat.

I është thënë Hasanit el Basriut, Allahu e mëshiroftë: “Disa njerëz thonë: “Kush thotë La ilahe il-lAllah do të hyjë në Xhenet”. Ai tha: “Kush thotë La ilahe il-lAllah, i kryen detyrimet dhe obligimet e saja, do të hyjë në Xhenet”.

Uehb ibën Munebih i thotë atij që e pyet: “A nuk është La ilahe il-lAllah çelësi i Xhenetit?” Ai tha: “Sigurisht, por çdo çelës ka dhëmbë. Nëse vjen me çelës me dhëmbë do të hapet, e nëse jo, nuk hapet”. Atëherë si është e mundur që të thuhet se mjafton vetëm shprehja La ilahe il-lAllah për të hyrë në Xhenet?! Edhe nëse ai që e thotë i lutet të vdekurve, i përgjërohet atyre në vështirësi dhe nuk e mohon atë çka adhurohet përveç Allahut?! A nuk vjen kjo vetëm se për shkak të turbullimit me të kotën?!

**Së katërti:** prej dyshimeve të tyre është pretendimi se në këtë umet Islam nuk ndodh shirku, ndërkohë që ata thonë La ilahe il-lAllah Muhammedun Resulullah dhe, se kjo që ndodh prej tyre në lidhje me evlijatë dhe njerëzit e mirë tek varret e tyre nuk është shirk.

Përgjigjja për këtë dyshim është se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka lajmëruar se në këtë umet do të ketë ngjashmëri me çifutët dhe të krishterët në atë çka ndodhen. Pjesë e kësaj është edhe marrja e dijetarëve dhe murgjërve si zota veç Allahut. Thotë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **“Do të ndiqni**

<sup>61</sup> Transmeton Muslimi 1/456.

<sup>62</sup> Transmeton Muslimi 1/53.

**rrugët e atyre që kanë qenë para jush njëlloj si pupla (me puplën)<sup>63</sup>, deri në (pikën që) sikur të hyjnë në strofkën e Dabit<sup>64</sup>, edhe ju do të hyni aty**". Thanë: "Çifutët dhe të krishterët o i Dërguari i Allahut?!" Tha: **"Po kush tjetër?"<sup>65</sup>**

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem na ka lajmëruar se ky umet do të veprojë atë çka vepruan umetet para tij, ku përfshihen çështjet fetare, zakonore dhe organizative. Në popujt para nesh ka ndodhur shirku, e po ashtu ndodh edhe në këtë umet. Ajo që ka lajmëruar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka ndodhur; ja ku janë varret që adhurohen veç Allahut me lloje të ndryshme adhurimesh, ku i dedikohen shumë vepra me qëllim afrimi. I Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka lajmëruar se Kiameti nuk bëhet pa u bashkangjitur një pjesë nga umeti i tij me idhujtarët dhe deri kur një grup prej umetit të tij të adhurojnë statujat. E transmetojnë Ebu Daudi dhe Ibën Maxheh.<sup>66</sup> Sigurisht që në këtë umet janë shfaqur shirku, besimet shkatërruese dhe sektet e humbura çka shumë njerëz i kanë nxjerrë prej fesë Islame.

**Së pesti:** prej dyshimeve të tyre është edhe argumentimi me hadithin: **"Shejtani i ka humbur shpresat që ta adhurojnë namazlitë në Gadishullin Arabik"**. Ky hadith është i saktë, i transmetuar në shumë rrugë në sahihun e Muslimit dhe tek të tjerë.

Ata u argumentuan me hadithin për të treguar pamundësinë e ekzistencës së shirkut në Gadishullin Arabik.

Përgjigjja për këtë vjen në fjalën që ka thënë Ibën Rexhebi, Allahu e mëshiroftë: "Domethënia është se ai i humbi shpresat për bashkimin e gjithë umetit në shirkun e madh. Gjithashtu Ibën Kethiri e ka aluduar këtë kuptim gjatë komentimit të fjalës së të Lartësuarit:

﴿الْيَوْمَ يَبْسُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ دِينِكُمْ﴾ المائدة: ٣

<sup>63</sup> Si puplat në fund të shigjetës, që të katërta ato janë të ngjashme. (shp)

<sup>64</sup> Një lloj zvarraniku që grykën e strofkës së tij e bën shumë të ngushtë në lidhje me përmasat e tij. (shp)

<sup>65</sup> Transmeton Buhariu 13/300 Fet'hul Barij.

<sup>66</sup> Shiko Sunen Ebi Daud 4252.

**“Sot, dëshpërohen ata që nuk besojnë dhe kanë humbur çdo shpresë, që t’ju largojnë prej fesë suaj”.<sup>67</sup>**

Gjithashtu në hadithin e lartpërmendur, humbja e shpresës i përkatësohet Shejtanit, duke e përcaktuar vepruesin, e nuk thotë “u humb shpresa” duke mos e përcaktuar. Humbja e shpresës nga ana e Shejtanit është veç një mendim dhe supozim i tij, nuk është diçka që vjen nga dituria, sepse ai sigurisht nuk e di të fshehtë. Kjo është një e fshehtë që vetëm Allahu e di. Këtë supozim nga ana e tij, e përgënjeshtrojnë hadithet e vërtetuara nga Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, në të cilat ka lajmëruar për shfaqjen e shirkut në këtë umet pas tij. Gjithashtu e përgënjeshton realiteti, ku shumë arabë dolën nga Islami pas vdekjes së Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, me lloje të ndryshme dezertimi. Allahu e di më së miri.

**Së gjashti:** prej dyshimeve të tyre është lidhja e tyre për çështjen e ndërmjetësimi (shefatit), duke thënë se: nuk kërkojmë prej evlijave dhe njerëzve të mirë të na plotësojnë kërkesat në vend të Allahut, mirëpo duam prej tyre të na ndërmjetësojnë tek Allahu, sepse janë njerëz të mirë e me pozitë tek Allahu subhanehu ue teala dhe, shefati është vërtetuar me Kuran dhe Sunet. Kjo është çfarë kërkojmë prej tyre.

Përgjigjja: kjo është pikërisht çfarë thanë idhujtarët më parë gjatë justifikimit të lidhjes së tyre me krijesat (në adhurimin) veç Allahut, ashtu siç thotë i Lartësuar i për ta:

﴿ وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا مِنْ دُونِهِ أَوْلِيَاءَ مَا نَعْبُدُهُمْ إِلَّا لِيُقَرِّبُونَا إِلَى اللَّهِ زُلْفَىٰ ﴾ الزمر: ٣

**“Ata që në vend të Tij adhurojnë evlija (thonë për vetet e tyre): “Vërtet ne i adhurojmë ata vetëm që të na afrojnë sa më afër tek Allahu”.<sup>68</sup>**

I Lartësuar i thotë:

﴿ وَيَعْبُدُونَ مِنْ دُونِ اللَّهِ مَا لَا يَضُرُّهُمْ وَلَا يَنْفَعُهُمْ وَيَقُولُونَ هَؤُلَاءِ شُفَعَاؤُنَا عِنْدَ اللَّهِ ﴾ يونس: ١٨

**“Adhurojnë përpos Allahut çfarë nuk u sjell as dëm dhe as dobi e më pas thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu”.<sup>69</sup>**

<sup>67</sup> El Maideh: 3.

<sup>68</sup> Ez-Zumer: 3.

<sup>69</sup> Junus: 18.

Ndërmjetësimi është i vërtetë, por ai është vetëm në pushtetin e Allahut:

﴿ قُلْ لِلَّهِ الشَّفَعَةُ جَمِيعًا لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ﴾ الزمر: ٤٤

**"Thuaju: "I tërë ndërmjetësimi i takon vetëm Allahut; i Tij është pushteti i qiejve dhe i Tokës".<sup>70</sup>**

Ndërmjetësimi kërkohet prej Allahut dhe jo prej të vdekurve. Allahu na ka bërë me dije se ai nuk arrihet vetëm se me dy kushte:

Kushti i parë: leja nga Allahu për ndërmjetësuesin që të ndërmjetësojë, siç thotë i Lartësuari:

﴿ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ﴾ البقرة: ٢٥٥

**"E kush është ai që mund të ndërmjetësojë tek Allahu pa lejen e Tij?!"<sup>71</sup>**

Kushti i dytë: që i ndërmjetësuarit të jetë prej atyre që Allahu është i kënaqur me fjalën dhe punën e tij, e ky është besimtari që e veçon Atë në adhurim, siç thotë i Lartësuari:

﴿ وَلَا يَشْفَعُونَ إِلَّا لِمَنِ ارْتَضَى ﴾ الأنبياء: ٢٨

**"Ndërsa ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilin Ai është i kënaqur".<sup>72</sup>**

I Lartësuari thotë:

﴿ وَكَمْ مِنْ مَلَكٍ فِي السَّمَوَاتِ لَا تُغْنِي شَفَعَتُهُمْ شَيْئًا إِلَّا مِنْ بَعْدِ أَنْ يَأْذَنَ اللَّهُ لِمَنْ يَشَاءُ وَيَرْضَى ﴾

النجم: ٢٦

**"E sa melekë janë në qiej, e që ndërmjetësimi i tyre nuk bën dobi asgjë, vetëm pasi që Allahu të japë leje për atë që dëshiron dhe që është i kënaqur për të".<sup>73</sup>**

I Lartësuari thotë:

<sup>70</sup> Ez-Zumer: 44.

<sup>71</sup> El Bekareh: 255.

<sup>72</sup> El Enbija': 28.

<sup>73</sup> En-Nexhm: 26.

﴿يَوْمَئِذٍ لَا تَنْفَعُ الشَّفَعَةُ إِلَّا مَنْ أِذِنَ لَهُ الرَّحْمَنُ وَرَضِيَ لَهُ قَوْلًا﴾ طه: ١٠٩

**“Atë ditë ndërmjetësimi nuk bën dobi, përveç atij të cilin e ka lejuar i Gjithëmëshirëshmi të ndërmjetësojë dhe për të cilin e pëlqeu ndërmjetësimin”.<sup>74</sup>**

Allahu nuk ka lejuar që ndërmjetësimi që kërkohet prej melekëve, as prej pejgamberëve dhe as prej statujave, sepse ai është zotërim vetëm i Tij dhe vetëm prej Tij kërkohet:

﴿قُلْ لِلَّهِ الشَّفَعَةُ جَمِيعًا﴾ الزمر: ٤٤

**“Thuaju: “I tërë ndërmjetësimi i takon vetëm Allahut”.<sup>75</sup>**

Allahu është që lejon ndërmjetësuesin të ndërmjetësojë, e nëse Ai nuk e lejon, nuk del me ndërmjetësim përpara Tij. Çështja nuk është si tek krijesat, që ndërmjetësuesit paraqiten edhe nëse nuk u është dhënë leje dhe e pranojnë ndërmjetësimin e tyre edhe nëse nuk janë të kënaqur me ta. I ndërmjetësuarit prej krijesave, ia ka nevojën ndërmjetësuesit dhe ndihmës së tij, kështu që detyrohet ta pranojë ndërmjetësimin e tij, edhe nëse nuk e ka lejuar. Kurse Allahu i Patëmetë është i Pasuri – nuk ka nevojë për të tjerët – dhe nuk ka nevojë për askënd, ndërsa çdo njeri është nevojtar për Allahun. Gjithashtu krijesa nuk i di të gjitha çështjet e nënshtetasve të tij, derisa ndërmjetësuesit t’ia komunikojnë, kurse Allahu subhanehu ue teala është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë, nuk i fshihet asgjë prej gjendjeve ku ndodhen krijesat e Tij dhe nuk ka nevojë që t’ia komunikojnë. Realiteti i ndërmjetësimit tek Allahu i Patëmetë, është se Allahu subhanehu i dhuron mirësi njerëzve të Ihlasit,<sup>76</sup> kështu që ua fshin gabimet dhe ua fal me ndërmjetësimin e lutjes së atij që Ai e lejon të ndërmjetësojë, në mënyrë që ta nderojë me këtë gjë.

**Së shtati:** prej dyshimeve të tyre është edhe fjala se evlijatë dhe njerëzit e mirë kanë pozitë tek Allahu, ashtu siç thotë i Lartësuarit:

﴿أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ﴾ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ﴿٦٣﴾ لَهُمْ

الْبَشَرِ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ ﴿يونس: ٦٢ - ٦٤﴾

<sup>74</sup> TaHa: 109.

<sup>75</sup> Ez-Zumer: 44.

<sup>76</sup> Njerëzit që ia kanë përkushtuar adhurimin vetëm Allahut. (shp)

**“Ta dini se për miqtë e Allahut (evlijatë) ska kurrfarë frike dhe as do të brengosen. (Këta janë ata) të cilët besuan dhe ishin të devotshëm. Për ta ka përgëzim në jetën e dynjasë dhe në ahiret”.<sup>77</sup>**

Prej madhërimit dhe dashurisë së tyre është lidhja e zemrës me ta dhe kërkimi i bereqetit nga gjurmët e tyre. Po kështu është edhe lutja e Allahut me pozitën dhe me të drejtën e tyre, apo të ngjashme me këto.

Përgjigjja është se të gjithë besimtarët janë evlija të Allahut. Ata në këtë dallohen sipas besimit dhe punëve të tyre të mira, mirëpo ta thuash në mënyrë të sigurtë se një person i caktuar është prej evlijave të Allahut, kjo ka nevojë për argument nga Kurani dhe Suneti. Nëse Kurani dhe Suneti dëshmojnë për dikë që është prej evlijave, atëherë edhe ne e dëshmojmë. Nëse Kurani dhe Suneti nuk e dëshmojnë një gjë të tillë, atëherë edhe ne nuk jemi kategorik në të, mirëpo shpresojmë për besimtarin të mirën. Po edhe në qoftë se është vërtetuar në Kuran dhe Sunet që dikush është prej evlijave të Allahut, për ne nuk lejohet teprimi me të, as kërkimi i bereqetit prej tij, as t’i lutemi Allahut me pozitën dhe me të drejtën e tij, sepse këto janë prej rrugëve të shirkut dhe bidateve të ndaluara.

Ne i duam njerëzit e mirë dhe i marrim si shembull në punët e mira dhe në cilësitë e bukura, mirëpo nuk e teprojmë me ta dhe t’i ngrejmë më tepër se pozita e tyre. Ska dyshim, se teprimi me njerëzit e mirë është fillesa e shirkut, siç ka ndodhur në popullin e Nuhut kur ata i kaluan kufijtë me njerëzit e mirë, gjersa përfunduan duke i adhuruar ata veç Allahut. Kështu ka ndodhur shirku në adhurim edhe në këtë umet; për shkak të teprimit me njerëzit e mirë. Allahu dhe i Dërguari i Tij na kanë paralajmëruar prej teprimit. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ ۖ الْمَائِدَةُ: ٧٧ ﴾

**“Thuaj: “O ithtarë të Librit, mos e teproni në fenë tuaj!”<sup>78</sup>**

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë:

<sup>77</sup> Junus: 62-64.

<sup>78</sup> El Maideh: 77.

**“Mos më mbilavdëroni ashtu si të krishterët mbilavdëruan të birin e Merjemes; unë jam vetëm një rob, andaj thoni: rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij!”<sup>79</sup>**

Fjala *el Itra* (mbilavdërim) do të thotë tejkalimi i kufijve në lavdërim. Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që t'i lutemi vetëm Atij, pa ndërmjetësimin e ndonjërit prej evlijave, apo ndonjë tjetri dhe na ka premtuar që do të na përgjigjet. Ai kurrë nuk e thyen premtimin e Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ ﴾ غافر: ٦٠

**“Zoti juaj ka thënë: “Më lutni Mua, Unë ju përgjigjem!”<sup>80</sup>**

Po ashtu ka thënë:

﴿ وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ ﴾ البقرة: ١٨٦

**“Kur robërit e Mi të të pyesin për Mua, (thuaji se) Unë jam afër dhe i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet”.<sup>81</sup>**

Gjithashtu thotë:

﴿ ادْعُوا رَبَّكُمْ تَضَرُّعًا وَخُفْيَةً ﴾ الأعراف: ٥٥

**“Luteni Zotin tuaj të përrulur dhe në heshtje”.<sup>82</sup>**

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ فَادْعُوهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ ﴾ غافر: ٦٥

**“Lutjuni Atij duke ia përkushtuar adhurimin!”<sup>83</sup>**

E kështu me rradhë, në të gjitha ajetet do të gjesh urdhërin për t'iu lutur Allahut drejtpërdrejt, pa asnjë ndërmjetës. Evlijatë dhe njerzit e mirë janë robër dhe nevojtarë për Allahun. I Lartësuari thotë:

﴿ أُولَئِكَ الَّذِينَ يَدْعُونَ يَبْتَغُونَ إِلَىٰ رَبِّهِمُ الْوَسِيلَةَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ وَيَرْجُونَ رَحْمَتَهُ وَيَخَافُونَ عَذَابَهُ ﴾

الإسراء: ٥٧

<sup>79</sup> Transmeton Buhariu 6/478, Fet'hul Barij.

<sup>80</sup> Gafir: 60.

<sup>81</sup> El Bekareh: 186.

<sup>82</sup> El Earaf: 55

<sup>83</sup> Gafir: 65.



**“Vetë ata që idhujtarët u luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre dhe garojnë se cili prej tyre është më i afërt (tek Allahu), duke shpresuar mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij”.<sup>84</sup>**

El Afi transmeton nga Ibën Abasi lidhur me ajetin: “Njerëzit e shirkut thonin: “Adhurojmë melekët, Mesihun dhe Uzejrin”, kështu që Allahu i Lartësuar tha:

﴿أُولَئِكَ الَّذِينَ يَدْعُونَ﴾ الإسراء: ٥٧

**“Vetë ata që idhujtarët u luten...”<sup>85</sup>**

Pra, vetë melekët që adhurohen nga ana e tyre, ata vetë shpejtojnë në kërkimin e afrimit tek Allahu, shpresojnë mëshirën dhe i frikësohen dënimit të Tij. Kush është i tillë, nuk është për t’u lutur bashkë me Allahun”.<sup>86</sup>

Shehu i Islamit Ibën Tejmije, thotë: “Ajeti është i përgjithshëm dhe përfshin çdo të adhuruar që ka qenë adhurues i Allahut, qoftë ky prej melekëve, xhinëve apo njerëzve. Ajeti i drejtohet çdo personi që lut dikë veç Allahut dhe ky i lutur kërkon afrim tek Allahu, shpreson mëshirën dhe frikësohet nga dënimi i Tij. Çdo njeri që i lutet një të vdekuri apo dikujt që nuk është prezent, prej pejgamberëve apo njerëzve të mirë, me shprehjen e të kërkuarit ndihmë apo me shprehje të tjera, ky ajet e ka përfshirë ashtu siç ka përfshirë atë që i lutet melekëve dhe xhinëve”.<sup>87</sup>

**Së teti:** prej dyshimeve të tyre është argumentimi me fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَابْتَغُوا إِلَيْهِ الْوَسِيلَةَ﴾ المائدة: ٣٥

**“O ju që besuat! Kini frikë Allahun dhe kërkonit afrim te Ai!”<sup>88</sup>**

Dhe me fjalën e të Lartësuarit:

﴿أُولَئِكَ الَّذِينَ يَدْعُونَ يَبْتَغُونَ إِلَىٰ رَبِّهِمُ الْوَسِيلَةَ أَيُّهُمْ أَقْرَبُ﴾ الإسراء: ٥٧

<sup>84</sup> El Isra’: 57.

<sup>85</sup> El Isra’: 57.

<sup>86</sup> Tefsir Ibni Kethir 3/46.

<sup>87</sup> Mexhmu’ fetaua shejkhil Islam 11/529.

<sup>88</sup> El Maideh: 35.

**“Vetë ata që idhujtarët u luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre dhe garojnë se cili prej tyre është më i afërt (tek Allahu)”<sup>89</sup>**

Duke kuptuar prej këtyre dy ajeteve ligjërimit e marrjes së ndërmjetësve mes tyre dhe Allahut, si peygamberët dhe njerëzit të mirë, ku kërkonin afrim me ata vetë, me të drejtën dhe me pozitën e tyre.

Përgjigjja është se afrimi në këto dy ajete nuk është ashtu siç e kuptuan ata, por qëllimi me to është t’i afroresh Allahut me punë të mira. Teuesuli (afrimi) është dy llojesh: i ligjëruar dhe i ndaluar. I lejuari është disa lloje: ku prej tyre janë:

1. Teuesul tek Allahu me emrat dhe cilësitë e Tij, ashtu siç ka thënë i Lartësuari:

﴿وَلِلَّهِ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَىٰ فَادْعُوهُ بِهَا﴾ الأعراف: ١٨٠

**“Allahu ka emrat më të bukur, pra luteni me to!”<sup>90</sup>**

Apo siç mund të thotë muslimani: “O Allah, o më Mëshiruesi i mëshiruesve, o Hannan<sup>91</sup>, o Dhuruesi i Madh, o Zotëruesi i Madhështisë dhe Nderimit, Ty të lutem këtë dhe këtë”.

2. Teuesul tek Allahu duke shfaqur varfërinë dhe nevojën tek Ai subhanehu, ashtu siç tha Ejubi alejhis-selam:

﴿أَنِّي مَسَّنِيَ الضُّرُّ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّحِيمِينَ﴾ الأنبياء: ٨٣

**“Mua më ka prekur vuajtja dhe Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve”<sup>92</sup>**  
Siç tha edhe Zekerija alejhis-selam:

﴿قَالَ رَبِّ إِنِّي وَهَنَ الْعَظْمُ مِنِّي وَأَشْتَعَلَ الرَّأْسُ شَيْبًا وَلَمْ أَكُنْ بِدُعَائِكَ رَبِّ شَقِيقًا﴾ مريم: ٤

**“Tha: “Zoti im, mua më janë dobësuar eshtrat, në kokë më janë përhapur thinjat dhe me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë s’kam qenë i humbur!”<sup>93</sup>** Ashtu siç tha edhe Dhennuni (Junusi) alejhis-selam:

<sup>89</sup> El Isra’: 57.

<sup>90</sup> El Earaf: 180.

<sup>91</sup> Thotë El Hatabi: “El Hannan do të thotë Zotëruesi i mëshirës dhe dhemshurisë”. (shp)

<sup>92</sup> El Enbija’ 83.

<sup>93</sup> Merjem: 4.

﴿ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ ﴾ ﴿ الأنبياء: ٨٧

**“Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Teje, Ti je i Patëmetë, unë i bëra vetes të padrejtë!”<sup>94</sup>**

3. Teuesul tek Allahu me punët e mira, ashtu siç është tek fjala e të Lartësuarit:

﴿ رَبَّنَا إِنَّا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ أَنْ ءَامِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا

سَيِّئَاتِنَا ﴾ آل عمران: ١٩٣

**“Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e thoshte): “Besoni Zotin tuaj!” E ne besuam! Zoti ynë na i fal gjynahet dhe na i mbulo të metat tona!”<sup>95</sup>**

Edhe në ngjarjen e atyre të treve të cilëve shkëmbi ua zuri hyrjen. Ata iu lutën Allahut me punët e tyre të mira dhe Ai i dha rrugëdalje. Pikërisht ky është edhe teuesuli i përmendur në këto dy ajetet e nderuara me të cilat kundërshtari është argumentuar me to; është teuesuli (afrimi) tek Allahu i Lartësuar me veprat e mira.

4. Teuesul tek Allahu i Lartësuar me lutjen e njerëzve të mirë. Kjo kur shkon tek një njeri i mirë dhe i gjallë për t’i thënë: “Lute Allahun për mua”, ashtu siç i tha Pejgamberi sal-Allahun alejhi ue sel-lem disa prej shokëve të tij: **“Mos na harro o vëllai im në lutjen tënde!”<sup>96</sup>** Ashtu siç kërkonin sahabët radijAllahu anhum nga Pejgamberi sal-Allahun alejhi ue sel-lem që ta luste Allahun për ta dhe, e kërkonin gjithashtu lutjen edhe nga njëri tjetri.

**Përsa i përket teuesulit të ndaluar:** ai është teuesuli me vetë krijesat, me të drejtën dhe me pozitën e tyre, si të thotë dikush: “Të lutem me filanin, apo me të drejtën e filanit, apo me pozitën e tij”, i gjallë apo i vdekur qoftë ai. Ky është bidat i ndaluar dhe shteg nga shtigjet e shirkut, e nëse njeriu afrohet tek krijesa – me të cilin po bën teuesul – me ndonjë gjë prej llojeve të adhurimit, atëherë ai është shirk i madh – Allahu na mbroftë nga kjo – si për shembull të

<sup>94</sup> El Enbija’: 87.

<sup>95</sup> Aal Imran: 193.

<sup>96</sup> Transmetojnë Ebu Daudi 1498 dhe Tirmidhiu 3557.

bëjë kurban për evlijatë, të zotohet për varrin e tyre, apo t'i thërrasë dhe të kërkojë prej tyre ndihmë, e të tjera si këto.

I lutemi Allahut që t'i bëjë muslimanët të qartësuar në fenë e tyre, t'i ndihmojë kundër armiqve dhe t'i udhëzojë të humburit e tyre.

**Së nënti:** prej dyshimeve është edhe kapja mbas disa haditheve për të cilat hamendësojnë se janë argument pro tyre, si për shembull hadithi të cilin e transmeton Tirmidhiu në librin e tij “El Xhamij” me zinxhir transmetimi nga Uthman ibn Hanif, se një burrë i verbër erdhi tek Pejgamberi sal-Allahue alejhi ue sel-lem dhe tha: “Lutju Allahut të më shërojë!” I tha: **“Nëse do, i lutem dhe nëse do, duron e kjo është më e mirë për ty?”** Ai tha: “Lutju!” Pas kësaj e urdhëroi të marrë abdes në mënyrë të mirë dhe të lutet me këtë lutje: **“O Allah! Unë të lutem Ty dhe të drejtohem me (lutjen e) Pejgamberit Tënd Muhamed, Pejgamberin e mëshirës. Unë u drejtova bashkë me të tek Zoti im në nevojën time që të kryhet. O Allah! Pranoje ndërmjetësimin e tij për mua!”** Tirmidhiu thotë: “Ky hadith është hasen-sahih garib, e njohim vetëm nga transmetimi i Ebu Xhaferit dhe nuk është el Hatmi”.

Thanë: “Në këtë hadith ka argument për drejtimin tek Allahu dhe për lutjen e Tij me Pejgamberin Muhamed sal-Allahue alejhi ue sel-lem”.

Përgjigjja: ky hadith, nëse është i saktë është jashtë fushës së mospajtimit. Ky i verbër kërkoi nga Pejgamberi sal-Allahue alejhi ue sel-lem që të lutet për të dhe iu drejtua Allahut me lutjen e tij, bashkë me prezencën e tij dhe kjo gjë është e lejuar; që të shkosh tek një njeri i mirë dhe i gjallë e të kërkosh prej tij që t'i lutet Allahut për ty. Nuk ka argument në të për teuesulin dhe drejtimin nga të vdekurit dhe nga ata që mungojnë.

Pejgamberi sal-Allahue alejhi ue sel-lem e urdhëroi këtë të verbër që t'i lutet Allahut e t'ia pranojë ndërmjetësimin e Pejgamberit të Tij për të. Këtu kemi kërkimin e shefatit prej Allahut të Lartësuar dhe kërkimin e shërimit vetëm nga Allahu. Në hadith nuk ka më shumë se kaq. Ai nuk argumenton lejimin e teuesulit me vetë krijesat, thirrjen e të vdekurve dhe të atyre që mungojnë.

Ata gjithashtu morën për argument një hadith të trilluar, ku trasmetojnë se gjoja Pejgamberi sal-Allahue alejhi ue sel-lem ka thënë: “Bëni teuesul me pozitën time, sepse pozita ime tek Allahu është e madhe”. Ky hadith është i trilluar, i

shpikur ndaj Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ashtu siç e ka përmendur Shejhu i Islamit Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë.

**Së dhjeti:** prej dyshimeve të tyre është edhe mbështetja tek përrallat dhe ëndërrat. Si për shembull, filan burrë vjen te varri i filanit dhe i ndodh kështu e ashtu. Filani ka parë në ëndërr kështu e ashtu.

Si për shembull një përrallë që e tregojnë disa prej tyre: El-Atbi tha: “Isha ulur tek varri i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, kur vjen një beduin që tha: “Es-Selamu alejke o i Dërguari i Allahut, unë kam dëgjuar Allahun të thotë:

﴿وَلَوْ أَنَّهُمْ إِذْ ظَلَمُوا أَنفُسَهُمْ جَاءُوكَ فَاسْتَغْفَرُوا اللَّهَ وَأَسْتَغْفَرَ لَهُمُ الرَّسُولُ لَوَجَدُوا اللَّهَ تَوَّابًا رَحِيمًا﴾ النساء: ٦٤

**“Dhe në qoftë se ata, kurdo që ta ngarkonin veten (me gjynahe), të vinin te ti për t’i kërkuar falje Allahut dhe i Dërguari t’i lutej Allahut për shfajësimin e tyre, do ta vërenin, se Allahu, me të vërtetë, është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë”.<sup>97</sup>**

Të erdha duke kërkuar falje për gjynahun tim dhe duke kërkuar ndërmjetësim me ty tek Zoti im”, pastaj filloi të thotë vargjet:

“O më i miri i varrosur në Tokë dhe më i madhi i saj

të pastër u bënë dheu dhe toka

kurban bëhem për varrin që ti e banon

ndershmëria, bujaria e fisnikëria në të qëndron”.

Pastaj beduini u largua, mua m’u mbyllën sytë dhe pashë Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në gjumë që tha: “O Atbi! E vërteta është me beduinin, andaj përgëzoje se Allahu e ka falur”.

Përgjigjja për këtë është se përrallat dhe ëndërrat nuk merren për argument ku mbi të cilat të ngresh ligje dhe besime. Fjala e të Lartësuarit:

﴿جَاءُوكَ﴾ النساء: ٦٤

**“Të vinin te ti”,** qëllimi me këtë është shkuarja tek ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem gjatë jetës, e jo tek varri i tij. Argumenti është se askush prej sahabëve

<sup>97</sup> En-Nisa’: 64.

dhe pasuesve të tyre me mirësi, nuk shkonin tek varri i tij sal-Allah u alejhi ue sel-lem e t'i luteshin që të kërkojë falje për ta, megjithëse ata kishin zell të madh për të mirën dhe zbatimin e urdhërave. Nëse kjo do të ishte e lejuar, do ta bënin ata së pari.

**Së njëmbëdhjeti:** prej dyshimeve të tyre është argumentimi se tek varret janë realizuar disa prej kërkesave të tyre dhe gjëra të tilla, si për shembull fjala e tyre: “Filani u lut tek varri i filanit” apo “thirri emrin e sheh filanit” apo “filan njeriu të mirë dhe iu plotësua dëshira”.

Përgjigjja është se plotësimi i disa kërkesave të idhujtarit nuk argumenton lejimin e shirkut në të cilin ndodhet, sepse kjo ka ndodhur kur ka ardhur caktimi dhe kaderi, ndërsa ai mendoi se është për shkak të lutjes së këtij shehu apo njeriu të mirë. Ka mundësi gjithashtu që kjo të ndodhë si përshkallëzim dhe sprovim për të, andaj kjo nuk tregon lejimin e lutjes së dikujt veç Allahut.

Kështu pra, idhujtarët i gjetëm që nuk posedojnë asnjë argumet të saktë që justifikon shirkun, andaj ata janë ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ ﴾ المؤمنون: ١١٧

**“E kush lut me Allahun edhe ndonjë të adhuruar tjetër, për të nuk ka kurrfarë fakti”.<sup>98</sup>**

Nëse shirku nuk bazohet mbi fakte dhe argumente, padyshim që Teuhidi është ngritur mbi fakte të padiskutueshme dhe argumente të qarta:

﴿ أَفَى اللَّهِ شُكُّ فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ﴾ إبراهيم: ١٠

**“A ka ndonjë dyshim për Allahun (që është i Adhuruari i Vetëm ashtu siç është Krijuesi i Vetëm), Krijuesin e qiejve dhe të Tokës?!”<sup>99</sup>**

﴿ يَتَأَيُّهَا النَّاسُ أَعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٢١﴾ الَّذِي جَعَلَ لَكُمْ الْأَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَكُمْ فَلَا تَجْعَلُوا لِلَّهِ أَنْدَادًا وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٢﴾﴾ البقرة: ٢١ - ٢٢

<sup>98</sup> El Mu'minun: 117.

<sup>99</sup> Ibrahim: 10.

**"O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi juve dhe ata para jush, ashtu që të jeni të devotshëm. Atë, i Cili tokën ua bëri shtrat e qiellin kulm dhe prej qiellit ju lëshoi shi me të cilin ju nxorri lloje frutash si ushqim për ju, andaj mos i bëni Allahut ortakë (në adhurim) duke qënë se jeni të vetëdijshëm (që Ai nuk ka të ngjashëm si në krijim dhe në adhurim)".<sup>100</sup>**

**Së dymbëdhjeti:** krerët e Sufive bashkë me ata që i ndjekin qorrazi, pretenduan se shirku na qënka animi tek dynjaja dhe angazhimi me kërkimin e saj.

Përgjigjja është se me këtë duan të mbulojnë gjendjen në të cilën ndodhen prej shirkut të madh, i cili pasqyrohet tek ta në adhurimin e varreve dhe teprimin që bëjnë në lidhje me shehlerët.

Kurse sa i përket kërkimit të dynjasë në formën e lejuar, kjo bën pjesë në atë që Allahu na ka urdhëruar dhe nëse qëllimi është ndihmesa me të në bindje të Allahut, atëherë ajo është adhurim dhe Teuhid.

## MBYLLJE

Në vijim: sigurisht që shirku është lloji më i madh i padrejtësisë, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ ﴾ لقمان: ١٣

**"Padyshim që shirku është padrejtësi e madhe".<sup>101</sup>**

<sup>100</sup> El Bekareh: 21-22.

<sup>101</sup> Lukman: 13.

Shirkun nuk e përfshin falja e Allahut nëse njeriu vdes në këtë gjendje, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿ إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ﴾ النساء: ٤٨

**“Vërtet Allahu nuk fal që t’i bëhet Atij shirk dhe fal çdo gjë tjetër atij që dëshiron.”<sup>102</sup>**

Idhujtarit i bëhet haram Xheneti përjetësisht:

﴿ إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَهُ النَّارُ ﴾ المائدة: ٧٢

**“Kush i bën shirk Allahut, Allahu ia ka bërë të ndaluar Xhenetin dhe vendbanimi i tij është Zjarri”.<sup>103</sup>**

Idhujtari është i papastër dhe nuk i lejohet të hyjë në tokën Haram të Allahut.

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّمَا الْمُشْرِكُونَ نَجَسٌ فَلَا يَقْرَبُوا الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ بَعْدَ عَامِهِمْ هَذَا ﴾ التوبة:

٢٨

**“O ju që keni besuar, vërtet idhujtarët janë të papastër, andaj pas këtij viti të mos i afrohen më Xhamisë Haram”.<sup>104</sup>**

Idhujtari e ka gjakun dhe pasurinë hallall:

﴿ فَإِذَا أَسْلَخَ الْأَشْهُرَ الْحُرُمَ فَاقْتُلُوا الْمُشْرِكِينَ حَيْثُ وَجَدْتُمُوهُمْ وَخُذُوهُمْ وَأَحْصُرُوهُمْ وَأَقْعُدُوا لَهُمْ كُلَّ مَرْصِدٍ فَإِنْ تَابُوا وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَءَاتُوا الزَّكَاةَ فَخَلُّوا سَبِيلَهُمْ ﴾ التوبة: ٥

**“Kur të kalojnë muajt e ndaluar, luftojini idhujtarët kudo që t’i gjeni, robërojini, ngujojini dhe zijini pritë në çdo shteg! Në qoftë se pendohen, e kryejnë namazin dhe japin zekatin, atëherë lëshojani rrugën”.<sup>105</sup>**

Idhujtari ka humbur dukshëm dhe ka trilluar një mëkat të madh. Ai ka rënë në nivel të ulët, larg nga Teuhidi i lartë:

<sup>102</sup> En-Nisa’: 48.

<sup>103</sup> El Maideh: 72.

<sup>104</sup> Et-Teubeh: 28.

<sup>105</sup> Et-Teubeh: 5.



﴿ وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَكَأَنَّمَا خَرَّ مِنَ السَّمَاءِ فَتَخْطَفُهُ الطَّيْرُ أَوْ تَهْوَى بِهِ الرِّيحُ فِي مَكَانٍ سَحِيقٍ ﴾ ﴿٣١﴾ الحج:

٣١

**“Kush i bën shirk Allahut është sikur të bie nga qielli e ta rrëmbejë shpendi, ose si ai të cilin e gjuan era e stuhishme në ndonjë vend të humbur”.**<sup>106</sup>

Me idhujtarin nuk lejohet martesë:

﴿ وَلَا تَنْكِحُوا الْمُشْرِكَةَ حَتَّىٰ تُؤْمِنَ ۚ وَلَا مُمِئَةً وَلَا مَمْلُوكَةً وَلَا مُشْرِكَةً ۚ وَلَا تَنْكِحُوا الْمُشْرِكِينَ حَتَّىٰ يُؤْمِنُوا وَلَعَبْدٌ مُّؤْمِنٌ خَيْرٌ مِّنْ مُّشْرِكٍ وَلَا أُعْجَبَ كُمْ ﴾ ﴿البقرة: ٢٢١﴾

**“Mos u martoni me idhujtare derisa të besojnë! Një robëreshë besimtare është më e mirë se idhujtarja, edhe nëse ju mahnit. Mos u martoni me idhujtarë derisa të besojnë! Një rob besimtar është më i mirë se një idhujtar, edhe nëse ju mahnit”.**<sup>107</sup>

Idhujtarit nuk i pranohet puna dhe as i nuk i quhet adhurimi:

﴿ وَلَقَدْ أَوْحَىٰ إِلَيْكَ وَإِلَىٰ الَّذِينَ مِن قَبْلِكَ لَئِن أَشْرَكْتَ لَيَحْبَطَنَّ عَمَلُكَ وَلَتَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴾ ﴿الزمر: ٦٥﴾

**“Vërtet, ty dhe atyre para teje ju është shpallur: “Nëse bën shirk, do të asgjësohet puna dhe do të jesh prej të humburve”.**<sup>108</sup>

﴿ وَلَا تُشْرِكُوا لِحَيْطِ عَنَّهُمْ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴾ ﴿الأنعام: ٨٨﴾

**“Sikur të bën shirk, do t’u shkatërrohej ajo që punuan”.**<sup>109</sup>

Kërkojmë strehim tek Allahu prej dyshimit, shirkut, kufrit, dyfytërsisë, moraleve të ulëta dhe ndryshimit për keq në pasuri, familje dhe fëmijë.

O Allah, na e mundëso ta shohim të vërtetën si të vërtetë dhe na e mundëso pasimin e saj, po ashtu na e mundëso ta shohim të kotën si të kotë dhe na e mundëso largimin prej saj!

<sup>106</sup> El Haxh: 31.

<sup>107</sup> El Bekareh: 221.

<sup>108</sup> Ez-Zumer: 65.

<sup>109</sup> El En’am: 88.

﴿سُبْحَانَ رَبِّكَ رَبِّ الْعِزَّةِ عَمَّا يَصِفُونَ ﴿١٨٠﴾ وَسَلَامٌ عَلَى الْمُرْسَلِينَ ﴿١٨١﴾ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٨٢﴾﴾

الصفات: ١٨٠ - ١٨٢

**“I Patëmetë është Zoti yt, Zoti i Gjithëfuqishëm nga ajo që i përshkruajnë. Shpëtimi është për të Dërguarit dhe lavdia i takon Allahut, Zotit të Gjithësisë”.<sup>110</sup>**

﴿سُبْحَانَهُ وَتَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿١﴾ النحل: ١﴾

**“I Patëmetë dhe i Lartësuar është Ai, nga çka i shoqërojnë (idhujtarët)”.<sup>111</sup>**

﴿سُبْحَانَهُ وَتَعَالَى عَمَّا يَقُولُونَ عُلُوًّا كَبِيرًا ﴿٤٣﴾ الإسراء: ٤٣﴾

**“I Patëmetë është Ai dhe i Lartësuar shumë lart nga ajo çka thonë (prej shirkut dhe devijimit)”.<sup>112</sup>**

Lëvdata e Allahut qoftë mbi pejgamberin tonë Muhamed, familjen dhe gjithë shokët e tij.

Ues-selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!

**Përktheu: Jusuf Kapidani**

## **RRUGA E SELEFËVE TË DEVOTSHËM DHE NEVOJA E UMETIT PËR TË SHEJH SALIH EL FEUZAN**

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

<sup>110</sup> Es-Saffat: 180-182.

<sup>111</sup> En-Nahl: 1.

<sup>112</sup> El Isra': 43.

Lavditë janë për Zotin e Botërave, salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin tonë Muhamedin, mbi familjen dhe gjithë shokët e tij.

Më pas:

Përsa i përket temës, tema është shumë e rëndësishme dhe sikurse e dëgjuat dhe është e lajmëruar, ajo titullohet **“Rruga e Selefëve të devotshëm dhe nevoja e umetit për të”**.

Qëllimi me fjalën "es-Selefu es-Salih" është: brezi i parë i këtij umeti. Ata janë shokët e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, prej muhaxhirëve dhe ensarëve. Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَالسَّابِقُونَ الْأُولُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ  
وَأَعَدَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي تَحْتَهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ

**“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!”<sup>113</sup>**

Dhe ka thënë:

لِلْفُقَرَاءِ الْمُهَاجِرِينَ الَّذِينَ أُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ وَأَمْوَالِهِمْ يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِنَ اللَّهِ وَرِضْوَانًا وَيَنْصُرُونَ  
اللَّهَ وَرَسُولَهُ أُولَئِكَ هُمُ الصَّادِقُونَ

**“Një pjesë e plaçkës i takon edhe mërgimtarëve të varfër<sup>114</sup>, të cilët u përzonë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut dhe duke ndihmuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e singertë.”<sup>115</sup>**

Këto ajete ishin për muhaxhirët. Allahu ka thënë në Kuran për ensarët:

<sup>113</sup> Et-Teubeh: 100.

<sup>114</sup> Muhaxhirëve, ata që u shpërngulën nga Meka në Medinë për hir të Allahut. (shp)

<sup>115</sup> El Hashr: 8.

وَالَّذِينَ تَبَوَّءُوا الدَّارَ وَالْإِيمَانَ مِنْ قَبْلِهِمْ يُحِبُّونَ مَنْ هَاجَرَ إِلَيْهِمْ وَلَا يَجِدُونَ فِي صُدُورِهِمْ حَاجَةً مِمَّا أُوتُوا وَيُؤْثِرُونَ عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ وَلَوْ كَانَ بِهِمْ خَصَاصَةٌ وَمَنْ يُوقِ شُحَّ نَفْسِهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ

**“Ndërsa ata që banojnë në Medine dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë (para mbërritjes së mërgimtarëve, muhaxhirëve në Medine), i duan mërgimtarët që vijnë në Medine dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë (plaçkën e luftës që iu nda mërgimtarëve të varfër), që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.”<sup>116</sup>**

Pastaj, Allahu ka thënë për ata të cilët erdhën pas tyre:

وَالَّذِينَ جَاءُوا مِنْ بَعْدِهِمْ يَقُولُونَ رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ فِي قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ آمَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ

**“Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!”<sup>117</sup>**

Pastaj, këtu hyjnë ata të cilët mësuuan prej tyre, si tabi’inët dhe pasuesit e tabi’inëve, po ashtu ata të cilët i ndoqën më pas dhe që bëjnë pjesë tek brezat e lëvduar, për të cilët Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Brezi më i mirë është brezi im, pastaj ai që vjen pas tyre, pastaj ai që vjen pas tyre.”<sup>118</sup>** Transmetuesi thotë: “Nuk e mbaj mend sa përmendi mbas brezit të tij, dy apo tre.”

Periudha e tyre dallohet dhe quhet **“periudha e brezave të lëvduar”**. Këta janë Selefët e këtij umeti, të cilët i lëvdoi Pejgamberi i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem me thënien e tij: **“Brezi më i mirë është brezi im, pastaj ai që vjen pas tyre, pastaj ai që vjen pas tyre.”**

<sup>116</sup> El Hashr: 9.

<sup>117</sup> El Hashr: 10.

<sup>118</sup> Transmeton Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu, Ibën Maxheh, Ahmedi dhe Nesaiu në “el Kubra” nga Imran ibën Husajn.

Ata janë shembulli për këtë umet, menhexhi<sup>119</sup> i tyre është rruga në të cilën ecin në Akide, në marrëdhënie, në moral dhe në të gjitha çështjet. Menhexhi i tyre është i bazuar në Kuran dhe Sunet, sepse kanë qenë afër me të Dërguarin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, afër me kohën e zbritjes së Kuranit dhe me marrjen [e Fèsë] nga i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Për këtë, ata janë brezi më i mirë dhe menhexhi i tyre është më i miri. Për këtë gjë, muslimanët duhet të përpiqen që ta njohin këtë menhexh, në mënyrë që të marrin prej tij, sepse vetëm duke e njohur, mësuar dhe punuar me këtë menhexh, mund të ecësh sipas tij. Allahu i Lartësuar ka thënë:

وَالسَّابِقُونَ الْأَوَّلُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ

**“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim.”<sup>120</sup>**

Kjo arrihet vetëm duke mësuar rrugën e tyre dhe menhexhin në të cilin ecën ata, kurse thjeshtë të pretendosh se ecën në rrugën e Selefëve dhe nuk e njeh rrugën Selefije dhe nuk di asgjë, ky njeri dëmton. Patjetër duhet ta njohësh menhexhin e Selefëve të devotshëm.

Për këtë, ky umet e ka studiuar menhexhin e Selefëve të devotshëm dhe e kanë përcjellë atë brez pas brezi; e kanë mësuar nëpër xhamia, shkolla, institute, fakultete dhe universitete. Ky është menhexhi i Selefëve të devotshëm dhe kjo është rruga për t'i njohur ata; duke e mësuar menhexhin e Selefëve të devotshëm, të kulluar, i cili është i bazuar në librin e Allahut dhe në Sunetin e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ka lajmëruar se do të shtohen kontradiktat në këtë umet, e kjo gjendet në fjalën e tij, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **“Çifutët u përçanë në shtatëdhjetë e një grupe, të krishterët u përçanë në shtatëdhjetë e dy grupe dhe do të përçahet ky umet në shtatëdhjetë e tre grupe; të gjitha do të jenë në Zjarr, përveç njërit.”** Thanë: “E cili është ai grup o i Dërguari i Allahut?” Tha: **“Janë ata të cilët ecin pas rrugës time dhe rrugës së shokëve të mi.”<sup>121</sup>** Ky është menhexhi i Selefëve të

<sup>119</sup> Metodologjia. (shp)

<sup>120</sup> Et-Teubeh: 100.

<sup>121</sup> Transmeton Tirmidhiu, Ebu Daudi dhe Ibën Maxheh

devotshëm, të cilët ecën në atë rrugë që eci i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe ecën shokët e tij. [Për këtë dëshmon fjala e Allahut]:

وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ

**“Me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim.”<sup>122</sup>**

Nevoja për të njohur menhexhin Selefi dhe të kapurit për të është e madhe, sepse ajo është rruga e shpëtimit. Të gjithë të tjerët janë në Zjarr, përveç njërit; ai është grupi i shpëtuar, Ehlu Suneh uel Xhema’ah. Përveç njërit dhe ai grup është që kur njerëzit të përçahen, të shtohen ideologjitë, ndasitë, grupacionet dhe hizbijatet (partitë), ai është grupi që vazhdon në rrugën e Selefëve të devotshëm, që është i kapur për rrugën e tyre dhe që duron në të derisa ta takojë Zotin e tij subhanehu ue teala.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, i këshilloi sahabët e tij nga fundi i jetës me një këshillë prekëse, ku sytë lotuan prej saj, andaj thanë: “O i Dërguari i Allahut! Kjo sikur është këshillë lamtumire, prandaj na këshillo!” Ai tha: **“Ju këshilloj për devotshmëri ndaj Allahut, për dëgjueshmëri dhe bindje”,** dëgjueshmëri dhe bindje për kë? Për prijësit e muslimanëve, **“edhe sikur t’iu prijë një rob, se me të vertetë kush do të jetojë prej jush, ka për të parë përçarje të shumta, prandaj kapuni me Sunetin tim dhe për Sunetin e halifëve të drejtë dhe të udhëzuar pas meje! Kapuni për to me dhëmballë dhe kujdes nga shpikja e gjërave, sepse çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është humbje dhe çdo humbje të çon në Zjarr!”<sup>123</sup>**

Kjo është porosia e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem për umetin e tij, që të ecin në rrugën e Selefëve të devotshëm, sepse ajo është rruga e shpëtimit dhe kjo siç na lajmeron fjala e Allahut azze ue xhel-le:

وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ ذَلِكُمْ وَصَّاكُمْ بِهِ  
لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

<sup>122</sup> Et-Teubeh: 100.

<sup>123</sup> Transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu, Ibën Maxheh, Ahmedi dhe Ibën Hibbani.

**“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’iu shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai për t’u ruajtur nga të këqijat.”<sup>124</sup>**

Ruheni prej zjarrit dhe prej humbjes, i kundërshtoni grupet e devijuara, ecni në menhexhin e saktë që të bashkoheni me Pejgamberin tuaj sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, me shokët dhe me ndjekësit e tij. Kush kapet pas këtyre, veçanërisht në kohën e fundit, ka për të hasur vështirësi prej njerëzve dhe prej kundërshtarëve. Ka për të hasur kërcënime dhe presione, prandaj ka nevojë për durim. Ai do të hasë mashtrime për ta lenë këtë rrugë, po ashtu kërcënime, nxitje dhe frikësim prej grupeve të humbura dhe të devijuara, andaj ka nevojë për durim. Për këtë, i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Islami ka filluar si i huaj dhe do të kthehet i huaj ashtu sikurse ka filluar, andaj përgezoi të huajt (gurabatë)!”<sup>125</sup>** Thanë: “E kush janë ata o i Dërguari i Allahut?” Tha: **“Janë ata të cilët përmirsojnë atë që e prishin njerëzit”<sup>126</sup>** dhe në një transmetim: **“Ata të cilët përmirësojnë njerëzit kur prishen.”<sup>127</sup>** Nuk shpëtojnë nga humbja në Dynja, ashtu siç nuk shpëtojnë nga Zjarri në Ahiret vetëm se ata të cilët ndjekin këtë rrugë; menhexhin e Selefëve, për të cilët Allahu ka thënë:

وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصَّادِقِينَ وَالشُّهَدَاءِ  
وَالصَّالِحِينَ وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا\* ذَٰلِكَ الْفَضْلُ مِنَ اللَّهِ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ عَٰلِمًا

**“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta! Kjo dhunti është nga Allahu, e mjafton që Allahu e di çdo gjë”<sup>128</sup>**

E për këtë, na e ka bërë Allahu obligim që të lexojmë suren el-Fatiha në çdo rekat të namazeve tona; farze apo nafile, dhe në fundin e saj ndodhet kjo dua madhështore:

<sup>124</sup> El En’am: 153.

<sup>125</sup> Transmeton Muslimi, Ibën Maxheh, Ebu Auani dhe Axhurri në “el Guraba”.

<sup>126</sup> Transmeton Ahmed.

<sup>127</sup> Transmeton Tirmidhiu.

<sup>128</sup> En-Nisa’: 69-70.

## اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

**“Na drejto në rrugën e drejtë!”**<sup>129</sup> Në rrugën e drejtë, sepse ka edhe rrugë të devijuara që të mashtrojnë, andaj ti i kërkon Allahut që të të ruaj nga këto rrugë dhe të drejtojë tek rruga e drejtë, pra: të të orientojë tek rruga e drejtë dhe të forcojë në të. Këtë e bën në çdo rekat, për shkak të rëndësisë që ka kjo dua. Medito kuptimin e saj: **“rrugën e drejtë!”** E kush janë ata të cilët ecin në këtë rrugë të drejtë? Janë ata të cilët i ka begatuar Allahu:

## صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

**“Në rrugën e të cilëve Ti i begatove.”**<sup>130</sup> Kush janë ata të cilët i ka begatuar Allahu?

## مِنَ النَّبِيِّينَ وَالصَّادِقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ وَحَسُنَ أُولَئِكَ رَفِيقًا

**“Të Dërguarit, të sinqertët, dëshmorët dhe njerëzit e devotshëm; e sa shoqëri e mirë është ajo.”**<sup>131</sup> Kur i kërkon Allahut që të udhezojë në këtë rrugë, gjithashtu i kërkon Allahut që të të ruajë nga rrugët e humbura dhe të devijuara:

## صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ

**“Në rrugën e të cilëve i begatove dhe jo në rrugën atyre që Ti u zemërove ndaj tyre.”**<sup>132</sup>

## غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ

**“Dhe jo në rrugën atyre që Ti u zemërove ndaj tyre.”**<sup>133</sup> Ata janë çifutët të cilët e mësuan të vërtetën, porse nuk punuan me të. Të gjithë ata që ecin sipas rrugës së çifutëve nga ky umet, çdo kush që e njeh të vërtetën dhe nuk vepron me të, ai është në rrugën e çifutëve, në rrugën e atyre që Allahu është zemëruar ndaj tyre, sepse e ka njohur të vërtetën dhe nuk ka punuar me

<sup>129</sup> El Fatiha: 6.

<sup>130</sup> El Fatiha: 7.

<sup>131</sup> En-Nisa': 69.

<sup>132</sup> El Fatiha: 7.

<sup>133</sup> El Fatiha: 7.



të, e ka marrë diturinë dhe nuk punoi me të, andaj çdo dijetar i cili nuk punon me diturinë e tij, ai është prej atyre që Allahu është zemëruar ndaj tyre.

### وَالضَّالِّينَ

**“Dhe as të humburve”**,<sup>134</sup> që janë ata të cilët e adhurojnë Allahun me injorancë dhe me humbje, e adhurojnë Allahun dhe afrohen tek Ai, mirëpo jo sipas rrugës së saktë, jo në një menhexh të shëndoshë, mirëpo e bëjnë pa argument nga Kurani dhe Suneti, e bëjnë me bidate: **“Çdo bidat është humbje”**, si të krishterët dhe çdo kush që ecën sipas rrugës së tyre, prej çdo kujt që adhuron Allahun sipas një rruge jo të saktë dhe menhexhi jo të shëndoshë, ai konsiderohet i humbur dhe puna e tij është e kotë.

Kjo është një dua gjithpërfshirëse që ne e përsërisim në çdo rekat të namazeve tona, prandaj le të meditojmë pak në kuptimin e saj dhe të lutemi me të me zemër të përqendruar, duke ia ditur kuptimin, që Allahu t'i përgjigjet duasë tonë. Mbas el-Fatijasë thuhet Amin dhe kuptimi i saj është: O Zoti ynë përgjigju! Kjo tregon se është një dua madhështore për atë që e mediton atë.

Siç përmendëm me sipër, ai i cili ecën në rrugën e atyre që janë begatuar me mirësi, do të hasë vështirësi, ngushtime, poshtërime, do ta akuzojnë me devijim, do ta kërcënojnë, mirëpo duhet durim, prandaj kanë ardhur hadithet, se i kapuri për fe në kohët e fundit është sikur ai që mban prush në dorë, sepse do të hasë vështirësi. Ai do të hasë vështirësi prej njerëzve, mirëpo duhet durim, si ai që mban prush në dorë. Nuk do ta kesh rrugën të shtruar me lule, nuk është kështu, mirëpo do të hasësh vështirësi, do të hasësh vështirësi prej njerëzve, mirëpo duhet të durosh dhe duhet të jesh i vendosur në këtë (rrugë) derisa të takosh Zotin tënd azze ue xhel-le dhe ti je i kapur për këtë rrugë; në mënyrë që të shpëtosh nga Zjarri, nga humbja në Dynja, që të shpëtosh nga Zjarri i Ditës së Gjykimit. Nuk ka rrugë tjetër veç kësaj rruge dhe nuk ka shpëtim përveçse me ndjekjen e kesaj rruge.

Tani i dekurajojnë njerëzit nga menhexhi i Selefëve, nepër revista, gazeta dhe libra; i zhvlerësojnë njerëzit e Ehli Sunetit dhe Selefite e vertetë. I zhvlerësojnë duke i akuzuar se janë te ashpër, se janë tekfirsia dhe janë dhe janë;

---

<sup>134</sup> El Fatiha: 7.

kjo nuk na dëmton, mirëpo e dimë që kjo mund të dëmtojë atë që nuk ka durim dhe vendosmëri, ky mund të dëmtohet.

Ka prej tyre që thonë: “Kush janë Selefët? Selefët janë grup si grupet e tjera, ndasi si ndasitë e tjera, një hizb si hizbet e tjera, ata nuk kanë ndonjë dallim!” Kështu thonë disa, thonë që rruga Selefije nuk ka dallim, mirëpo është si të gjitha ndasitë, grupet apo hizbet. Ata duan që ne të heqim dorë nga menhexhi Selefi.

Dikush thotë se ne nuk jemi të obliguar që të marrim kuptimin dhe diturinë e Selefit, pasi jemi vetë të zotë dhe mund t'i nxjerrim dispozitat vetë nga fillimi, nxjerrim kuptim (fikh) të ri sepse ky është i vjetër. Thonë se kuptimi i Selefit është i vjetër, po ashtu thonë se nuk është i përshtatshëm për këtë kohë, porse ishte i përshtatshëm për kohën e tyre. Ata thonë se koha që jemi është tjetër dhe i largojnë njerëzit nga kuptimi i Selefëve. Ata thërrasin tek një kuptim i ri. Kjo është shumë e përhapur në revista dhe gazeta, nga njerëzit e të kotës dhe të devijuar. Ata duan që ne të heqim dorë nga menhexhi i Selefit, sepse nëse ne nuk e njohim rrugën e Selefit, nëse e lejmë dhe nuk e mësojmë, atëherë nuk do të mjaftojë përkatësimi tek Selefët pa dituri dhe patur qartësi të rrugës së tyre.

Kjo është ajo që duan ata; duan që ne ta lejmë rrugën e Selefëve, kuptimin dhe diturinë e tyre dhe të nxjerrim një kuptim (fikh) të ri të përshtatshëm për këtë kohë. Kjo është genjështër! Feja Islame është e vlefshme për çdo kohë dhe vend derisa të bëhet Dita e Gjykimit.

Menhexhi i Selefëve është i përshtatshëm për çdo kohë dhe vend, ai është dritë prej Allahut azze ue xhel-le. Mos të largojnë [nga rruga e Selefit] fjalët e dekurajuesve, apo të humburve!

Imam Maliku, Allahu e mëshirfotë, ka thënë: “Fundi i këtij umeti rregullohet veçse me atë që u rregulluan të parët e tij.” Çfarë i rregulloi ata që ishin përpara nesh? Ata i rregulloi Kurani, Suneti dhe pasimi i të Dërguarit të Allahut, sal-IAllahu alejhi ue sel-lem. Puna me Kuran dhe me Sunet ishte ajo që e rregulloi fillimin e umetit dhe, nuk mund të rregullohet fundi i këtij umeti vetëm se me atë që u rregulluan të parët.

Kush dëshiron të shpëtojë, atëherë duhet të njohë rrugën e Selefëve, duhet të kapet për të, të thërrasë për tek ajo, pasi ajo është rruga e shpëtimit

dhe është anija e Nuhut alejhis-selam; kush hipën në të shpeton dhe kush e lë shkatërrohet dhe mbytet në humbje, prandaj vetëm tek rruga e Selefëve ka shpëtim për ne. Rrugën e Selefëve mund ta njohim vetëm duke marrë dituri; duke e mësuar për vete, duke ia mësuar të tjerëve dhe duke e lutur Allahun:

اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ (6) صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

**“Na drejto në rrugën e drejtë! Në rrugën e të cilëve Ti i begatove.”<sup>135</sup>**

Lusim Allahun të na japë sukses për tek kjo rrugë dhe të na forcojë në të, kjo duhet patjetër.

Nuk është çështja të pretendosh, pasi pretendimet nëse nuk kanë baza mbeten thjeshtë pretendime. Nuk është çështja të përkatësohesh, sepse Allahu thotë:

وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ

**“Me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim.”<sup>136</sup>** D.m.th. me saktësi, dhe kjo realizohet vetëm duke e njohur dhe mësuar; nuk mund të kapesh pas saj vetëm se duke duruar, duke mos dëgjuar thirrjet devijuese që mundohen të të largojnë dhe dekurajojnë nga kjo rrugë.

Kjo është rruga e vërtetë, rruga e shpëtimit, **“të gjitha do të jenë në Zjarr, përveç njërit.”** Thanë: “E cili është ai grup o i Dërguari i Allahut?” Tha: **“Janë ata të cilët ecin pas rrugës time dhe rrugës së shokëve të mi.”<sup>137</sup>** Ky është menhexhi i Selefëve, që është rruga e të shpëtuarve që të çon në Xhenet dhe nuk ka rrugë tjetër përveç saj, të gjitha rrugët e tjera janë të devijuara. Allahu thotë:

وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ

**“Dhe mos ndiqni rrugët të cilat ju devijojnë nga rruga Ime”<sup>138</sup>,** ajo është rruga e Allahut dhe të gjitha të tjerat janë rrugë të humbura, rrugë të devijuara ku në çdo rrugë qëndron një shejtan dhe i thërret njerëzit për tek ajo.

<sup>135</sup> El Fatiha: 6-7.

<sup>136</sup> Et-Teubeh: 100.

<sup>137</sup> Transmeton Tirmidhiu, Ebu Daudi dhe Ibën Maxheh.

<sup>138</sup> El En’am: 153.

I Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, na ka paralajmeruar nga këta thirrësa për tek e kota, të cilët duan që t'i largojnë njerëzit nga menhexhi Selefi dhe i ka përshkruar se janë: **“Thirrësa për tek dyert e Xhehenemit, kush i bindet atyre e hedhin në të”**,<sup>139</sup> prandaj ruhu shumë prej tyre. Sa më shumë kalon koha, po aq shtohet edhe ndjenja e të qenit i huaj (gurbetit), shtohen fitnet dhe muslimanët kanë nevojë më të theksuar për menhexhin Selefi.

Ka prej të devijuarve që thonë se të gjithë njerëzit janë musliman, mirëpo në çfarë rruge na janë muslimanët?! A janë muslimanë që ecin në rrugën e të Dërguarit dhe shokëve të Tij? Nëse është kështu, atëherë mirë, mirëpo nëse kihet për qëllim musliman me emër, ndërsa ai ndjek rrugët e devijuara apo menhexhin e filanit apo filanit, atëherë ata janë të devijuar dhe janë në rrugë që të çon në Xhehenem. Nuk është çështja thjeshtë t'i përkatësohesh Islamit, mirëpo duhet përkatësimi bashkë me esencën, e kjo është e mundur vetëm me dituri të dobishme dhe kujdesjen për të mësuar.

Për këtë arsye, dijetarët i japin rëndësi Akides, temave të saja, kapitujve dhe çështjeve të saja. Ata kanë shkruar për këtë gjë libra të mëdhenj dhe të vegjël, që të studiohet rruga e Selefëve, për t'i dhënë rëndësi asaj, për t'u kapur me të dhe për të ecur sipas saj.

Kësaj çështje duhet dhënë rëndësi, sidomos kur situatën e ka kapluar errësira dhe e kota. Muslimanet kanë nevojë për dritë, që të ecin me të në errësirat e të kotës dhe injorancës.

Sot, shumë pretendojnë se kanë dituri dhe hiqen si dijetarë dhe të ditur, ndërkohë që nuk e kanë marrë diturinë tek burimi i saj, as tek baza e saj, porse e kanë marrë nga ata që janë si ai, ose prej librave, ose prej kulturës siç i thonë.

Kjo nuk të çon tek e mira, as tek rruga e saktë. Duhet patjetër që ta mësosh në mënyrë të saktë menhexhin e Selefëve, që ta pasosh dhe të ecësh sipas tij.

Duhet patjetër që të jesh i duruar në këtë rrugë, të durosh sharjet, nënçmimet etj. Tani e dëgjoni nënçmimin dhe ofendimin për ata të cilët janë të kapur pas menhexhit Selefi; thonë se ky është me të vjetrën. Mos të demoralizojnë në të vërtetën këto fjalë të ulëta dhe të kota, mirëpo kapu pas këtij menhexhi të saktë, sepse ai është rruga e shpëtimit dhe për këtë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Kapuni me Sunetin tim dhe**

---

<sup>139</sup> Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

**për Sunetin e halifëve të drejtë dhe të udhëzuar pas meje! Kapuni për to me dhëmballë, se me të vertetë kush do të jetojë prej jush, ka për të parë përçarje të shumta, kështu që kapuni për Sunetin tim.”<sup>140</sup>**

Kur ka përçarje, vetëm kapja pas Sunetit të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të shpëton, po ashtu Suneti i halifëve të drejtë dhe të udhëzuar; kjo është rruga e shpëtimit, rruga e sigurisë dhe e Xhenetit.

Prandaj, le të kujdesemi për menhexhin e Selefëve dhe mos të na largojnë prej tij ata që e zhvlerësojnë atë, apo që e cilësojnë me cilësi të ulëta. Kjo nuk duhet të na fusë plogështi në vetet tona, përkundrazi kjo duhet të na nxisë, sepse ata e sulmojnë këtë rrugë vetëm sepse e dinë që është rruga e vërtetë.

Ruhuni prej tyre o robër të Allahut! Mos u mjaftoni vetëm me përkatësime, as me pretendimin se keni dituri pa mësuar. Merreni diturinë tek dijetarët e njohur dhe tek ata të cilët janë në rrugën e saktë!

Largohuni nga këto rrugë të devijuara, prej të cilave na ka paralajmëruar Allahu:

وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ

**“Dhe mos ndiqni rrugët të cilat ju devijojnë nga rruga Ime”<sup>141</sup>,**

Ne kemi shumë nevojë për këtë gjë, veçanërisht me shtimin e fitneve sot, me thirrësit e shumtë për në devijim, me mjetet të cilat e përhapin të keqen midis njerëzve. Ato janë mjetete të keqija, që për një minutë arrijnë tek njerëzit në shpitë e tyre, madje tek krevatet e tyre duke i thirrur për tek devijimi, degjenerimi, epshet e ndaluara dhe mendimet e prishura.

Këto i quajnë si “horizont i gjerë”, “kulturë e gjerë”, të thonë “mos u bëj i ngurtë dhe mos u bej i ashpër”!

Këto fjalë nuk duhet ta largojnë muslimanin nga menhexhi i Selefëve, nga rruga e Selefëve dhe dituria e tyre.

Menhexhi Selefi është më i sigurti, më i dituri dhe më gjykimpreri se rruga e të mëvonshëmve.

<sup>140</sup> Transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu, Ibën Maxheh, Ahmedi dhe Ibën Hibbani.

<sup>141</sup> El En’am: 153.

Ditura e Selefëve është e pastër dhe është marrë prej Kuranit dhe Sunetit, kurse dituria e atyre pas Selefëve ka shtesa, ka përzierje të shumta të papastra, ndërsa dituria e Selefëve është e kulluar, prandaj librat e Selefëve, sa më të hershëm të jenë, aq më të kthjellët dhe të lehtë janë.

Dijetari Ibën Rexheb, Allahu e mëshiroftë, thotë në fletushkën e tij “Fadlu ilmis-Selef ala ilmil halef”<sup>142</sup>: “Selefët kishin fjalë pak dhe dituri shumë, ndërsa ata pas tyre (halefi) kanë fjalë shumë dhe dituri pak”.

Prandaj duhet të kemi kujdes në këtë çështje. Kjo është rruga e Selefëve, që vetëm duke ecur sipas saj ka shpëtim për ne, duke duruar në të pasi ta kemi njohur dhe mësuar në formë të saktë, pa e tjetërsuar dhe pa futur dyshime. Ka gjëra të cilat i mvishen Selefëve, porse ato janë të kota, nuk janë prej rrugës së Selefëve, prandaj le të ruhem prej tyre.

Këto janë disa fjalë të shkurta rreth kësaj teme dhe nuk mund ta përfshij të gjithën, mirëpo Allahu azze ue xhel-le thotë:

وَذَكِّرْ فَإِنَّ الذِّكْرَى تَنْفَعُ الْمُؤْمِنِينَ

**“Dhe përkujto, sepse përkujtimi i bën dobi besimtarëve.”<sup>143</sup>**

Gjithashtu thotë:

فَذَكِّرْ إِنْ نَفَعَتِ الذِّكْرَى (9) سَيَذَكِّرْ مَنْ يَخْشَى

**“Dhe përkujto nëse u bën dobi përkujtimi, sepse do të përkujtohet ai që ka frikë (Allahun).”<sup>144</sup>**

E lusim Allahun azze ue xhel-le që të na japë sukses ne dhe ju për vepra dhe fjalë të mira, po ashtu të na forcojë ne dhe ju në të vërtetë, në ecjen në të dhe të na bëjë të durueshëm në vështirësitë që hasim në të.

Salavatet dhe selamet qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, familjen dhe gjithë shokët e tij.

<sup>142</sup> Vlera e dijes së Selefëve ndaj dijes së halefëve të mëvonshëm. (shp)

<sup>143</sup> Edh-Dharijat: 55.

<sup>144</sup> El Eala’: 9-10.

**Përktheu: Idris Manushi**

**BAZA NË TEFSIR  
SHEJH MUHAMED EL UTHEJMIN**

**Kurani fisnik**

**Kuptimi i fjalës Kuran nga ana gjuhësore:** rrënja e saj vjen nga *karae* që do të thotë lexoi ose bashkoi. Thuhet: *karae, kar'en, kuranen, siç thua gafera, gafran, gufranen*. Sipas kuptimit të parë (lexoi) rrënja ka domethënien e mbiemrit, pra, lexuar. Sipas kuptimit të dytë (bashkoi) rrënja ka domethënien e foljes së pashtjelluar të formuar nga pjesorja, pra, është bashkuar, sepse ka bashkuar lajmet dhe normat.<sup>145</sup>

**Kuptimi i Kuranit nga ana e terminologjike:** është Fjala e Allahut e zbritur të Dërguarit të Tij, Vulës së të Dërguarve, Muhamedit sal-Allahu alejhi ue sel-lem, që fillon me suren el-Fatiha dhe mbyllet me suren en-Nas. Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْقُرْآنَ تَنْزِيلًا

**“Në të vërtetë, Ne ta kemi shpallur Kuranin ty hap pas hapi.”<sup>146</sup>**  
Allahu ka thënë:

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ

**“Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju.”<sup>147</sup>**

Allahu e ka ruajtur këtë Kuran madhështor nga ndryshimet dhe shtesat, nga mangësitë dhe zëvendësimet, ku vetë Allahu ka garantuar për ruajtjen e tij. Allahu thotë:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ

**“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.”<sup>148</sup>**

Për këtë, kanë kaluar shumë shekuj dhe kushdo prej armiqëve të Allahut që tentoi të bënte ndryshime në të, të shtojë, apo të pakësojë apo të zëvendësojë, vetëm se e ka zbuluar Allahu dhe e ka poshtëruar.

<sup>145</sup> Ai mund të ketë edhe domethënien e mbiemrit, pra i bashkuar, sepse është bashkuar në mus'hafe dhe gjokse.

<sup>146</sup> El Insan: 23.

<sup>147</sup> Jusuf: 2.

<sup>148</sup> El Hixhr: 9.



Allahu e ka përshkruar Kuranin me shumë cilësi që tregojnë madhështinë e tij, begatinë, ndikimin, gjithëpërfshirjen e tij dhe se është gjykues për të gjithë librat që kanë qenë para e tij.

Allahu i Lartësuar thotë:

وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ سَبْعًا مِّنَ الْمَثَانِي وَالْقُرْآنَ الْعَظِيمَ

**“Ne të kemi shpallur shtatë vargje që përsëriten dhe Kuranin e madhërishtëm.”<sup>149</sup>**

ق وَالْقُرْآنِ الْمَجِيدِ

**“Kaf. Beto hem në Kuranin e lavdishëm.”<sup>150</sup>**

Allahu i Lartësuar thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِّيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ

**“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (o Muhamed), për të medituar mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të njerëzit e mençur.”<sup>151</sup>**

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

**“Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe druajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni.”<sup>152</sup>**

إِنَّهُ لَقُرْآنٌ كَرِيمٌ

**“Vërtet ky është një Kuran i nderuar.”<sup>153</sup>**

إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ

<sup>149</sup> El Hixhr: 87.

<sup>150</sup> Kaf: 1.

<sup>151</sup> Sad: 29.

<sup>152</sup> El En’am: 155.

<sup>153</sup> El Uakia’: 77.

**“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira.”<sup>154</sup>**

Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

لَوْ أَنْزَلْنَا هَذَا الْقُرْآنَ عَلَىٰ جَبَلٍ لَّرَأَيْتَهُ خَاشِعًا مُّتَصَدِّعًا مِّنْ خَشْيَةِ اللَّهِ وَتِلْكَ الْأَمْثَالُ نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

**“Sikur këtë Kuran t’ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (mal) të përrulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve, që ata të meditojnë.”<sup>155</sup>**

وَإِذَا مَا أَنْزَلْنَا سُورَةً فَمِنْهُمْ مَّنْ يَقُولُ أَيُّكُمْ زَادَتْهُ هَذِهِ إِيمَانًا فَأَمَّا الَّذِينَ آمَنُوا فزَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَهُمْ يَسْتَبْشِرُونَ (124) وَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ فَزَادَتْهُمْ رِجْسًا إِلَىٰ رِجْسِهِمْ وَمَاتُوا وَهُمْ كَافِرُونَ

**“Kur shpallet ndonjë sure, disa prej atyre (që kanë dyshim dhe hipokrizi) thonë: “Kujt prej jush do t’ia shtojë besimin kjo sure?” Përsa u përket besimtarëve, atyre (kjo sure) ua shton besimin dhe ata gëzohen. E sa u përket atyre që kanë sëmundje në zemrat e veta, ajo ua shton edhe më dyshimin që kanë dhe ata vdesin si mohues.”<sup>156</sup>**

وَأَوْحِي إِلَيَّ هَذَا الْقُرْآنُ لِأُنذِرْكُمْ بِهِ وَمَنْ بَلَغَ

**“Ky Kuran më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t’ju tërheq vërejtjen juve dhe kujt do që i përcillet.”<sup>157</sup>**

فَلَا تُطِيعِ الْكَافِرِينَ وَجَاهِدْهُمْ بِهِ جِهَادًا كَبِيرًا

**“Mos i dëgjo mohuesit, por luftoju ata me forcë nëpërmjet këtij (Kurani).”<sup>158</sup>**

Allahu i Lartësuar thotë:

<sup>154</sup> El Isra’: 9.

<sup>155</sup> El Hashr: 21.

<sup>156</sup> Et-Teubeh: 124-125.

<sup>157</sup> El En’am: 19.

<sup>158</sup> El Furkan: 52.

وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ تَبْيَانًا لِّكُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً وَبُشْرَىٰ لِلْمُسْلِمِينَ

**“Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për muslimanët.”<sup>159</sup>**

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ وَمُهَيْمِنًا عَلَيْهِ فَاحْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنزَلَ  
اللَّهُ

**“Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu.”<sup>160</sup>**

Kurani fisnik është burimi legjislaconit Islam me të cilin është dërguar Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tek të gjithë njerëzit. Allahu i Lartësuar thotë:

تَبَارَكَ الَّذِي نَزَّلَ الْفُرْقَانَ عَلَىٰ عَبْدِهِ لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا

**“I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin (Kuranin) robit të Vet (Muhamedit) që të jetë paralajmërues për botët.”<sup>161</sup>**

الرَّكِتَابُ أَنزَلْنَاهُ إِلَيْكَ لِتُخْرِجَ النَّاسَ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِ رَبِّهِمْ إِلَى صِرَاطِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ  
(1) اللَّهُ الَّذِي لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَوَيْلٌ لِّلْكَافِرِينَ مِنْ عَذَابٍ شَدِيدٍ

**“Elif Lam Ra. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, Meritorit për çdo lavd, Allahut, të Cilit i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Mjerë mohuesit për dënimin e tmerrshëm (që i pret)!”<sup>162</sup>**

<sup>159</sup> En-Nahl: 89.

<sup>160</sup> El Maideh: 48.

<sup>161</sup> El Furkan: 1.

<sup>162</sup> Ibrahim: 1-2.

Po ashtu Sunneti i të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është burim i legjislacionit Islam, siç e ka pohuar këtë Kurani. Allahu i Lartësuar thotë:

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ وَمَنْ تَوَلَّىٰ فَمَا أَرْسَلْنَاكَ عَلَيْهِمْ حَفِيظًا

**“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre.”<sup>163</sup>**

وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ وَلَا لِمُؤْمِنَةٍ إِذَا قَضَى اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَمْرًا أَنْ يَكُونَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ مِنْ أَمْرِهِمْ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا مُّبِينًا

**“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”<sup>164</sup>**

وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا

**“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.”<sup>165</sup>**

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

**“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”<sup>166</sup>**

## 1- Zbritja e Kuranit

Si fillim, Kurani i ka zbritur të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në Natën e Kadrit, në muajin e Ramazanit. Allahu i Lartësuar thotë:

<sup>163</sup> En-Nisa’: 80.

<sup>164</sup> El Ahzab: 36.

<sup>165</sup> El Hashr: 7.

<sup>166</sup> Aal Imran: 31.

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ

**“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit.”<sup>167</sup>**

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ مُبَارَكَةٍ إِنَّا كُنَّا مُنذِرِينَ (3) فِيهَا يُفْرَقُ كُلُّ أَمْرٍ حَكِيمٍ

**“Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar (Natën e Kadrit). Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues. Në atë (natë të zbritjes së Kuranit) vendoset çdo punë e urtë.”<sup>168</sup>**

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَىٰ وَالْفُرْقَانِ

**“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja).”<sup>169</sup>**

Kur filloi zbritja, mosha e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem – siç është e njohur te dijetarët – ishte dyzet vjeç, siç është transmetuar nga Ibën Abasi, Ata' ibën Ebi Rabah, Seid ibnul Musejjib etj. Kjo është edhe mosha në të cilën njëriu arrin pjekurinë, është më i plotë nga ana mendore dhe në të kuptuar.

Ai që e zbriti shpalljen nga Allahu i Lartësuar për tek i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ishte Xhibrili; njëri prej melekëve më të afërt tek Allahu i Lartësuar. Allahu i Lartësuar ka thënë për Kuranin:

وَإِنَّهُ لَتَنْزِيلُ رَبِّ الْعَالَمِينَ (192) نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ (193) عَلَىٰ قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنذِرِينَ

(194) بِلِسَانٍ عَرَبِيٍّ مُّبِينٍ (195)

**“Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja e Zotit të krijesave. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhibrili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.”<sup>170</sup>**

<sup>167</sup> El Kadr: 1.

<sup>168</sup> Ed-Dukhan: 3-4.

<sup>169</sup> El Bekareh: 185.

<sup>170</sup> Esh-Shuara: 192-195.

Xhibrili alejhi salam, ka cilësi të lëvdëruara dhe madhështore, si: fisnikëria, fuqia, afërsia tek Allahu, pozita dhe nderimi që ka në mesin e melekëve, besnikëria, bukuria dhe pastërtia. Të gjitha këto që thamë, e bëjnë Xhibrilin meritore që të jetë i dërguar nga Allahu për tek Pejgamberët e Tij. Allahu i Lartësuar ka thënë:

إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ (19) ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ (20) مُطَاعٍ ثَمَّ أَمِينٍ

**“Vërtet ky (Kuran) është Fjalë e (kumtuar prej) një të Dërguari fisnik (Xhibrili) që zotëron fuqi dhe pozitë të lartë te Zoti i Arshit e që është i respektuar atje dhe besnik.”<sup>171</sup>**

Allahu i Lartësuar ka thënë:

عَلَّمَهُ شَدِيدُ الْقُوَى (5) ذُو مِرَّةٍ فَاسْتَوَى (6) وَهُوَ بِالْأُفُقِ الْأَعْلَى

**“Atë ia ka mësuar atij një (melek) shumë i fuqishëm (Xhibrili), mendjelartë, që iu paraqit qartë, në horizontin më të lartë.”<sup>172</sup>**

Po ashtu Allahu i Lartësuar ka thënë:

قُلْ نَزَّلَهُ رُوحُ الْقُدُسِ مِنْ رَبِّكَ بِالْحَقِّ لِيُثَبِّتَ الَّذِينَ آمَنُوا وَهُدًى وَبُشْرَى لِلْمُسْلِمِينَ

**“Thuaj: “Atë (Kuranin) e ka zbritur Xhibrili nga Zoti yt me të vërtetën, për t’i forcuar ata që besojnë dhe për të qenë udhërrëfyes dhe lajm i mirë për ata që i dorëzohen Allahut (e janë muslimanë).”<sup>173</sup>**

Allahu na i ka treguar cilësitë e Xhibrilit, i cili e zbriti Kuranin nga Allahu (tek Pejgamberi). Kjo tregon për madhësinë e Kuranit dhe kujdesin e Allahut me të; sepse ai që është madhështor dërgohet vetëm me gjëra madhështore.

## 2- Cilat janë ajetet e para që janë zbritur nga Kurani

Ajetet e para që janë zbritur nga Kuranit janë padiskutim pesë ajetet e para të sures el Alak, që janë:

<sup>171</sup> Et-Tekuir: 19-21.

<sup>172</sup> En-Nexhm: 5-7.

<sup>173</sup> En-Nahl:102.

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ (1) خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ (2) اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ (3) الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ (4) عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ

**“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”<sup>174</sup>**

Shpallja u ndërpre një kohë, pastaj zbritën pesë ajetet e para të sures el Muddeththir, ku Allahu thotë:

يَا أَيُّهَا الْمُدَّثِّرُ (1) قُمْ فَأَنْذِرْ (2) وَرَبَّكَ فَكَبِّرْ (3) وَثِيَابَكَ فَطَهِّرْ (4) وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ

**“O ti, i mbështjellë (o Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, petkat e tua pastroji dhe largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)!”<sup>175</sup>**

Në dy sahihët e Buhariut dhe Muslimit<sup>176</sup>, transmetohet nga Aishja, radijAllahu anha, se ka thënë: “Deri kur i erdhi e vërteta duke qenë në shpellën Hira. I erdhi meleku dhe i tha: “Lexo!” I Derguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i tha: “Unë nuk jam lexues” pra nuk di të lexoj.. dhe permendi hadithin. Në të transmetohet se i ka thënë: **“Lexo me emrin e Zotit tënd”,** deri tek thënia e Tij: **“Ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”<sup>177</sup>**

Po ashtu tek dy sahihët<sup>178</sup>, nga Xhabiri radijeAllahu anhu, se Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ka thënë duke folur për kohën e ndaljes së shpalljes: **“Ndërsa isha duke ecur, kur më erdhi një zë prej qielli...”**, dhe permendi hadithin, ku permendet se Allahu i Lartësuar zbriti: **“O ti, i**

<sup>174</sup> El Alak: 1-5.

<sup>175</sup> El Muddeththir: 1-5.

<sup>176</sup> Buhariu në kapitullin “Fillimi i Shpalljes”, tema 1: “Si ishte fillimi i Shpalljes për tek Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem” numër 3. Muslimi në kapitullin “Imani”, tema 73: “Fillimi i Shpalljes për tek Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem” numër 403 [252] 160.

<sup>177</sup> El Alak: 1-5.

<sup>178</sup> Buhariu në kapitullin “Fillimi i Shpalljes”, tema 1: “Si ishte fillimi i Shpalljes për tek Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem” numër 4. Muslimi në kapitullin “Imani”, tema 73: “Fillimi i Shpalljes për tek Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem” numër 406 [255] 161.

**mbështjellë (o Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro!"** Deri tek thënia e Tij: **"Dhe largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)!"**<sup>179</sup>

Ka ajete që për to thuhet "këto janë ajetet e para" dhe, kihet për qëllim ajetet e para që kanë zbritur për diçka specifike, që do të thotë se janë të parat, mirëpo sipas një kufizimi.

Shembull: Hadithi i Xhabirit radijAllahu anhu në dy sahihët, se Ebu Seleme ibën AbdurRahman e pyeti (Xhabirin): "Cilat janë ato ajete që kanë zbritur të parat?" Xhabiri tha: **"O ti, i mbështjellë (o Muhamed)!"**<sup>180</sup> Ebu Seleme tha: "Më kanë thënë se janë: **"Lexo me emrin e Zotit tënd."**<sup>181</sup> Xhabiri iu përgjigj: "Po të tregoj atë që më ka treguar i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **"Qëndrova në Hira dhe pasi përfundova qëndrimin, zbrita që atje..."** dhe permendi hadithin, ku ndër të tjera thuhet: "Shkova tek Hatixhja dhe i thashë: "Më mbuloni! Më hidhni ujë të ftohtë! E në atë çast më zbriti fjala e Allahut: **"O ti, i mbështjellë (o Muhamed)!"**<sup>182</sup>

Kjo përparësi që ka përmendur Xhabiri radijAllahu anhu, është nga aspekti se çfarë ka zbritur nga Kurani pas kohës së ndaljes së Shpalljes, ose e para që ka zbritur për kumtimin e mesazhit; sepse me ajetet që kanë zbritur nga surja el Alak, është pohuar se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është "Nebij", kurse me ajetet që kanë zbritur nga surja el Muddeththir, është pohuar se është "Resul" tek thënia e Tij: **"Çohu dhe paralajmëro!"**<sup>183</sup>

Për këtë, dijetarët kanë thënë: "Vërtet Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është bërë "Nebij" me **"Lexo!"**<sup>184</sup> dhe është bërë "Resul" me **"O ti, i mbështjellë (o Muhamed)!"**<sup>185</sup>

**...vijon në numrin e ardhshëm inshaAllah...**

**Përktheu: Idris Manushi**

<sup>179</sup> El Muddeththir: 1-5.

<sup>180</sup> El Muddeththir: 1.

<sup>181</sup> El Alak: 1.

<sup>182</sup> El Muddeththir: 1.

<sup>183</sup> El Muddeththir: 1.

<sup>184</sup> El Alak: 1.

<sup>185</sup> El Muddeththir: 1.



## NORMAT E PASTRIMIT SHEJH MUHAMED EL UTHEJMIN

### ESENCA E PASTËRTISË

**Pyetja 64:** shejh i nderuar, çfarë është tahareti?

**Përgjigja:** taharet do të thotë: pastërti dhe dëlirësi. Në fë, ai është dy llojesh: pastërti abstrakte dhe konkrete. **Sa i përket atij abstrakt**, është pastërtia e zemrave nga shirku dhe bidatet në adhurimin e Allahut, po ashtu pastërtia nga mëria, mllefi, smira, urrejtja dhe të tjera të ngjashme kur kemi marrëdhënie me njerëzit që nuk i meritojnë ato.

Ndërsa pastërtia konkrete është ajo e trupit, e cila është dy llojesh gjithashtu: largimi i cilësisë që të pengon nga falja e namazit dhe të tjera të ngjashme me të që kërkojnë pastërti, po ashtu dhe largimi i ndyrësirës.

Fillimisht po flasim për pastërtinë abstrakte, që është pastërtia e zemrave nga shirku dhe bidatet në lidhje me obligimet ndaj Allahut azze ue xhel-le. Kjo është pastërtia më e madhe, andaj të gjitha adhurimet bazohen mbi të. Asnjë adhurim nuk konsiderohet i saktë nga asnjë person që e ka zemrën e ndotur me shirk. Asnjë bidat me të cilin njeriu kërkon të afrohet tek Allahu azze ue xhel-le nuk konsiderohet i saktë; ajo është prej gjërave që Allahu azze ue xhel-le nuk i ka ligjëruar. Allahu i Lartësuar ka thënë:

﴿وَمَا مَنَعَهُمْ أَنْ تُقْبَلَ مِنْهُمْ نَفَقَتُهُمْ إِلَّا أَنَّهُمْ كَفَرُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ﴾ التوبة: ٥٤

**“Ndhimesat e tyre nuk do të pranohen, ngase ata janë njerëz që nuk besojnë në Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”** Et-Teubeh: 54.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Kush vepron një vepër e cila nuk përputhet me fenë tonë, atëherë ajo është e refuzuar.”**<sup>186</sup>

Bazuar mbi këtë, mushriku (idhujtari) që i bën shirk të madh Allahut, adhurimi i tij nuk i pranohet, edhe sikur të falet, të agjërojë, të japë zekat dhe të bëjë haxhin. Kush lut dikë tjetër veç Allahut azze ue xhel-le, apo adhuron dikë tjetër veç Allahut, atëherë adhurimi i tij që ia bën Allahut është i papranuar,

<sup>186</sup> Transmeton Muslimi, kitabul ekdijeh, babu nakdil ahkam el batileh ue radd muhdethatil umur nr.1718.

edhe nëse bën ndonjë adhurim të përkushtuar vetëm për Allahun e Lartësuar, përderisa në anën tjetër ai i ka bërë shirk të madh Allahut.

Për këtë, Allahu azze ue xhel-le i ka cilësuar idhujtarët se janë të papastër dhe ka thënë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّمَا الْمُشْرِكُونَ نَجَسٌ فَلَا يَقْرَبُوا الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ بَعْدَ عَامِهِمْ هَذَا﴾ التوبة:

۲۸

**“O ju që keni besuar, vërtet idhujtarët janë të papastër, andaj pas këtij viti të mos i afrohen më Xhamisë së Shenjtë.”**<sup>187</sup>

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka mohuar që besimtari të jetë i papastër dhe ka thënë: **“Vërtet besimtari nuk bëhet i papastër.”**<sup>188</sup> Besimtari duhet përkujdeset shumë për këtë gjë, në mënyrë që zemra e tij të pastrohet prej tij.

Ai gjithashtu duhet ta pastrojë zemrën prej mërisë, mllefrit, smirës dhe urrejtjes së besimtarëve, sepse të gjitha këto janë cilësi të qortuara dhe nuk janë prej cilësive të besimtarit. Besimtari është vëlla i besimtarit, nuk e urren, nuk e cënon, nuk e ka smirë, përkundrazi, shpreson të mirën për vëllaun e tij siç e shpreson për veten. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka mohuar që të ketë besim ai që nuk e do për vëllaun e tij atë çfarë e do për vete. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Nuk beson ndonjëri prej jush, derisa të dojë për vëllaun e tij atë çfarë e do për vete.”**<sup>189</sup>

Ne shikojmë që shumë njerëz janë të mirë, bëjnë adhurime, kanë devotshmëri, asketizëm, shkojnë shumë në xhami ku edhe lexojnë, bëjnë dhikër dhe falen, mirëpo kanë mllef ndaj disa vëllezërve të tyre muslimanë, apo e kanë smirë personin që Allahu i ka dhënë një të mirë. Kjo gjë i mangëson shumë adhurimet që i bëjnë për Allahun subhanehu ue teala, andaj secili prej nesh duhet ta pastrojë zemrën e tij nga këto fëlliqësi që i ka në lidhje me vëllezërit e tij muslimanë.

<sup>187</sup> Et-Teubeh: 28.

<sup>188</sup> Transmeton Buhariu, kitabul gusl, babu arakul xhunub ue ennel mu'mine la jenxhus nr. 283, Muslimi, kitabul hajd, babud-delil ala ennel muslima la jenxhus nr. 371.

<sup>189</sup> Transmeton Buhariu, iman, babun minel imani en juhhibbe li ehijhi ma juhhibbu linefsihi nr. 13, Muslimi, kitabul iman, babun nefjul iman ammen le juhhibbu li ehijhi ue xharihi ma juhhibbu linefsihi nr. 45.

Sa i përket pastërtisë konkrete, atëherë siç thashë është dy llojesh: largimi i cilësisë që të pengon nga falja e namazit dhe të tjera të ngjashme me të që kërkojnë pastërti, po ashtu dhe largimi i ndyrësirës.

Lidhur me “largimin e cilësisë”, ajo është largimi i hadethit të vogël dhe të madh duke larë ‘katër gjymtyrët’ në rast hadethi të vogël, apo duke larë të gjithë trupin në rast hadethi të madh; ose me ujë, për atë që ka mundësi, ose me dhë për atë që nuk ka mundësi të përdorë ujin.

Për këtë, Allahu i Lartësuar ka zbritur thënien e Tij:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِنَ الْغَائِطِ أَوْ لَمَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ مِّنْهُ مَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيَجْعَلَ عَلَيْكُمْ مِّنْ حَرَجٍ وَلَا كِنٌ يُرِيدُ لِيُطَهِّرَكُمْ وَلِيُتِمَّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكُمْ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٦﴾

المائدة: ٦

**“O besimtarë! Kur doni të falni namaz, lani fytyrën dhe duart deri në bërryla, kurse kokën fshijeni me dorë të lagët; lani edhe këmbët deri në nyje. Nëse jeni të papastër (si pasojë e marrëdhënieve bashkëshortore apo e derdhjes së farës), pastrohuni (duke u larë krejtësisht)! Por, në qoftë se jeni të sëmurë (që mund t’ju dëmtojë uji) ose gjendeni në udhëtim, ose ndonjëri nga ju vjen pas kryerjes së nevojës natyrore, ose nëse keni pasur marrëdhënie me bashkëshortet e nuk gjeni ujë, atëherë gjeni dhë të pastër dhe fshini fytyrat e duart me të. Allahu nuk dëshiron t’ju krijojë ndonjë vështirësi, por dëshiron t’ju pastrojë dhe t’i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, që të jeni falënderues.”<sup>190</sup>**

Lloji i dytë është pastrimi nga ndyrësitë, që është çdo gjë për të cilët feja e ka bërë obligim për njerëzit që të pastrohen prej saj, si nevoja e vogël, nevoja e madhe dhe të tjera që feja i ka cilësuar të ndyta. Për këtë, dijetarët e fik’hut, Allahu i mëshiroftë, kanë thënë: “Pastrimi ose bëhet nga hadethi, ose nga ndyrësitë.”

Argument për këtë lloj – pra për pastrimin nga ndyrësitë – është hadithi i transmetuar në Sunene, se Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ue sel-lem u fal me

<sup>190</sup> El Maideh: 6.

shokët e tij një ditë, i hoqi këpucët dhe njerëzit gjithashtu i hoqën. Kur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem përfundoi, i pyeti sahabët: **“Pse i hoqën këpucët?”** Ata thanë: “Pamë që i hoqe këpucët, andaj edhe ne i hoqëm tonat.” Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: **“Më erdhi Xhibrili dhe më lajmëroi se këpucët kishin ndyrësi.”**<sup>191</sup>

Kjo pra sa i përket termit taharet (pastërti).

## ORIGJINA NË PASTRIM

**Pyetja 65:** shejh i nderuar, cila është origjina në pastrim?

**Përgjigja:** sa i përket pastrimit nga hadethi, atëherë origjina është pastrimi me ujë dhe s’ka pastrim tjetër veç ujit, qoftë ujë i pastër apo ujë që ka ndryshuar vetitë me diçka të pastër; sepse mendimi më i saktë lidhur me ujin që i ndryshon vetitë me gjëra të pastra dhe vazhdon të emërtohet “ujë”, është se ai vazhdon të ketë vetinë e pastërtisë, madje ai është i pastër në vetvete dhe pastrues për të tjerët.

Nëse nuk gjen ujë, apo kihet frikë nga ndonjë dëmtim nëse ai përdoret, atëherë kalon për tek Tejemumi duke e goditur tokën me duar, më pas fshin fytyrën me to e më pas fshin duart me njëra-tjetrën. Kjo sa i përket pastrimit nga hadethi.

Sa i përket pastrimit nga ndyrësit, atëherë pastrimi kryhet me çdo gjë që e largon ndyrësinë, qoftë ujë apo diçka tjetër.

Kjo, sepse me pastrim të ndyrësisë është për qëllim largimi i objektit të ndyrë me çfarë do gjë që e heq.

Nëse objekti i ndyrë hiqet me ujë, apo benzinë, apo me një lëng tjetër, apo hiqet plotësisht me një objekt të ngurtë, atëherë kjo e fundit konsiderohet pastrim për të. Në këtë mënyrë arrijmë të njohim dallimin sesi bëhet pastrimi nga ndyrësit dhe pastrimi nga hadethi.

---

<sup>191</sup> Transmeton Ebu Daudi, kitabus-salah, babus-salati fin-na’l nr. 650, po ashtu Ahmedi në Musned 3/411.

## ÇFARË E ZËVENDËSON ORIGJINËN NË PASTRIM

**Pyetja 66:** shejh i nderuar, çfarë e zëvendëson këtë origjinë i cili është uji?

**Përgjigja:** zëvendësuesi i kësaj origjine është dheu. Nëse është e pamundur që të përdoret uji për shkak se nuk ka, apo për shkak se mund të dëmtohesh nëse e përdor atë, atëherë kalon në përdorimin e dheut, d.m.th. kalon tek Tejemumi duke goditur tokën me duar, pastaj fshin fytyrën me to dhe pastaj i fshin duart me njëra-tjetrën. Mirëpo, kjo është e veçantë për pastrimin nga hadethi. Ndërsa për pastrimin nga ndyrësitë nuk ka Tejemum, qoftë (për ndyrësitë) mbi trup, mbi rrobë, apo mbi një vend, sepse qëllimi i pastrimit të ndyrësirës është largimi i objektit të ndyrë, nuk është kusht kryerja e një adhurimi. Andaj, nëse objekti i ndyrë largohet nga njeriu pa qëllim, atëherë ai vend bëhet i pastër. Nëse largohet ndyrësira prej shiut që ka rënë, atëherë vendi është pastruar, edhe pse njeriu nuk ka njohuri për këtë gjë. E kundërta ndodh me pastrimin nga hadethi, pasi ai është adhurim me të cilin njeriu afrohet për tek Allahu azze ue xhel-le, andaj patjetër duhet të kihet qëllim.

**Pyetja 67:** shejh i nderuar, pra nëse njeriu ka ndonjë papastërti dhe nuk mund ta largojë, a mos të marrë Tejemum për të?

**Përgjigja:** po, nëse njeriu ka ndonjë papastërti dhe nuk mund ta heqë, atëherë falet ashtu siç është, mirëpo mundohet sa të ketë mundësi që ta pakësojë atë duke e kruar apo diçka të ngjashme. Nëse për shembull papastërtia është mbi një rrobë që mund ta heqë dhe të veshë një tjetër, atëherë ai duhet ta heqë dhe që veshë tjetrën.

**...vijon në numrin e ardhshëm inshaAllah...**

**Përktheu: Besmir Cacani**

## **ARGUMENTET NGA UNGJILLI SE ISAI<sup>192</sup> ALEJHIS-SELAM ËSHTË ROB ADHURUES DHE NUK KA HISE NË ADHURIM**

**SHEJH MUHAMED EL HILALI**

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdi Allahut Fuqiplotë dhe Madhështor, i veçuari me cilësitë e plota, i Cili nuk është i lindur dhe nuk ka lindur kënd, i Cili nuk ka të barabartë dhe as të ngjashëm, Ai është i Madhi dhe i Larti. Ai dërgoi peygamberët e Tij që t'i tregojnë njerëzve se është i vetmi (që meriton) adhurimin, po ashtu t'i paralajmërojnë nga shirku i cili do t'i dërgonte në shkatërrim. Salavatet dhe selamet e Allahut qofshin mbi të gjithë peygamberët dhe të dërguarit, veçanërisht mbi Muhamedin, Vulën e Peygamberisë, e mbi të gjithë ata që i pasuan me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Më pas: më ka shkruar nxënësi im, z. Mundhir Ismail ed-Derubi el Bagdadi, i cili ka studiuar arkitetkturë në një prej fakulteteve në Shtetet e Bashkuara prej katër vitesh afërsisht. Ai më tregoi se të krishterët i janë mbledhur dhe kanë nisur ta debatonin në fe e të bëhen edhe arrogantë madje. Ai nuk ka ditur se çfarë t'i përgjigjej, andaj i shkrova këtë pjesë që e titullova "Argumentet nga Ungjilli se Isai alejhis-selam është rob adhurues dhe nuk ka hise në adhurim". I dhashë atij edhe numrat e verseteve nga katër Ungjillet, që t'i nxirrte në gjuhën angleze dhe të mbrohej prej tyre, e kjo pasi të kuptonte atë çfarë i kisha shpjeguar në gjuhën arabe. Ai nuk iu nda letrës, derisa e kuptoi mirë, më pas i thirri për debat. Kur debatoi me ta, i kishte heshtur dhe i kishte mundur keqazi, siç më ka treguar.

Këtij shkrimi do ta pasoj me një histori tjetër të ngjashme që ka ndodhur në Bagdad, ku përfundimi i saj ka qenë sikur i historisë së lartpërmendur. Muslimanit nuk i mungojnë argumentet për vërtetësinë e fesë së tij dhe kotësinë e fesë së armiqve që ka, mirëpo atij i mungojnë vëllezërit besnikë, të cilët e ndihmojnë Allahun dhe Peygamberin e Tij. Drejtë ka patur ai që ka thënë se: "Islami në këtë kohë është fe pa burra, ndërsa krishtërimi ka burra pa fe" ku me përpjekjet, pasuritë, guximin dhe durimin e tyre, të vërtetën e bëjnë të kotë,

---

<sup>192</sup> Jezusi. (shp)

ndërsa të kotën e bëjnë të vërtetë. Shumica e njerëzve në këtë kohë janë robër të floririt, argjendit, rrobave të shtrenjta dhe pallateve të larta.

Kjo është koha e fillimit të asaj që kemi për qëllim, me lejen e Sunduesit të adhuruar me të drejtë, nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij, tek Ai mbeshtetem dhe tek Ai kthehem i penduar.

### **DEKLARATA E DREJTPËRDREJTË E UNGJILLIT SE ISAI ALEJHIS-SELAM ËSHTË ROB ADHURUES**

Lexo në fillim të kapitullit të katërt në Ungjillin e Mateut, në numrat gjashtë dhe shtatë. Aty gjen të deklaruar në formë të drejtpërdrejtë se Isai është rob, ndërsa Allahu është Zot. Në versetin e shtatë shkruhet: **"Mos e tundo Zotin, Perëndinë tënd"**. Në po këtë kapitull, Shejtani e ka çuar Mesihun dhe e mori ta shëtiste sa një vend në tjetrin. Si mundet që Shejtani ta çojë të Gjithëmëshirshmin?! I lartësuar është Allahu nga kjo gjë.

Më pas, Shejtani e urdhëroi që t'i bënte sexhde, ta adhuronte dhe e ushqeu nga pasuria e dynjasë. Si mund të guxojë Shejtani ndaj Allahut me tillë guxim?! Kur e donte këtë gjë Shejtani, Mesihu iu përgjigj: **"Sepse është shkruar (në librat e mëparshëm): "Adhuro Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm atij"**.

Shiko versetin e dhjetë! Mesihu nuk e ka quajtur veten e tij se është bir i Allahut – me aq sa di – mirëpo ai e quante veten si "bir i njeriut", vetëm se e ka dëgjuar ta quanin ashtu dhe nuk e ka kundërshtuar – sipas pretendimit të Ungjillit – dhe kjo nuk përbën ndonjë veçori për Mesihun.

### **DOMETHËNIA E SHPREHJES "BIR I ALLAHUT" E CILA PËRDORËT NË UNGJILL**

Sipas gjuhës së Torës<sup>193</sup> dhe Ungjilli: çdo i devotshëm dhe bamirës quhet bir i Allahut. Në versetin e nëntë të kapitullit të pestë sipas Mateut: **"Lum ata që përpiqen për paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë"**.

---

<sup>193</sup> Teuratit. (shp)

Në po të njëjtin kapitull në versetin e dyzet e pestë: **“Për të qenë bij të Atit tuaj, që është në qiej”**. Tek verseti i dyzet e tetë: **“Jini, pra, të përkryer, ashtu siç është i përsosur Ati juaj, që është në qiej”**. Ndërsa në kapitullin e gjashtë, verseti i parë: **“Përndryshe nuk do të shpërbleheni te Ati juaj, që është në qiej”**.

### **SHEMBUJ TË NDRYSHIMIT QË TË KRISHTERËT I KANË BËRË LIBRIT TË TYRE**

Në kapitullin e shtatë, verseti numër njëzet e një, fjala “lord” është përkthyer si “Zot” për t’i lënë njerëzve të kuptojnë se Mesihu është Allahu, mirëpo kush mediton rreth pjesës tjetër të versetit, do të shikojë se ai dëshmon që Mesihu është rob adhurues, andaj përkthimi i saktë është kështu: **“Jo çdo njeri që më thotë: “Zoti im, Zoti im” do të hyjë në mbretërinë e qiejve; por do të hyjë ai që kryen vullnetin e Atit tim që është në qiej”**, përfundoi përkthimi i versetit. E thamë se emërtimi i Allahut me fjalën “At” është përmendur në vende të shumta në Ungjill, dhe nuk është specifike për Mesihun.

### **DEKLARATA E QARTË NË UNGJILL SE ISAI ALEJHIS-SELAM ËSHTË ROB ADHURUES**

Në Ungjillin e Mateut, kapitulli 11, verseti 25 thuhet: **“Unë të lavdëroj, o Atë, Zot i qiellit dhe i dheut, sepse ua fshehe këto gjëra të urtit dhe të mençurit, dhe ua zbulove fëmijëve të vegjël.”**

Në kapitullin 14, verseti 23 thuhet: **“Mbasi i nisi ato, u ngjit vetëm mbi mal për t’u lutur.”** Them: Nëse Isai është Allahu apo pjesë e Tij, atëherë si lutet?! Sepse lutjen e bën rob i që ka nevojë për mëshirën e Allahut, siç thotë Allahu në suren Fatir, ajeti 15:

يا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ

**“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s’ka nevojë për asgjë dhe është i Shumëlavdëruar.”**

Ndërsa në suren Merjem ka thënë:



إِنَّ كُلَّ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ إِلَّا آتِي الرَّحْمَنِ عَبْدًا

**“S’ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit.”** [Merjem: 93].

Në kapitullin 15, versetet 21-28 është historia e gruas kananease, histori e cila përmban disa çështje:

E para: mohohet që Isai të ishte i mëshirshëm dhe i dashur! Gjithnjë nëse tregimi është i vërtetë.

E dyta: fanatizëm i qortuar, pasi ai shëronte bijtë e popullit të tij dhe nuk i shëronte të tjerët, megjithëse nuk i kushtonte gjë!

E treta: mendjemadhësi nacionaliste, krekosje me prejardhjen, nënvlerësimi i të tjerëve dhe konsiderimi i tyre si qenj.

E katërta: gruaja ishte idhujtare e paditur, megjithatë e debatoi dhe e mundi në debat.

Në kapitullin 19, versetet 16-17, përmendet se një djalosh shkoi tek Isai dhe i tha: **“Mësues i mirë!”** dhe ai tha: **“Pse më quan të mirë? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi: Perëndia!”**. Në këtë pjesë, Isai pohon se është rob adhures.

Në kapitullin 21, versetet 45-46, kur donin ta kapnin Isain, patën frikë nga turma, sepse ata e konsideronin profet. Edhe në këtë rast kemi argument se turma që e besonin Isain në kohën e tij, nuk besonin se ai ishte i adhurar, apo bir i Allahut, apo pjesë e trinitetit, mirëpo besonin se ishte vetëm profet. Ky është prej argumenteve më të fuqishëm kundër atyre që thonë se Isai është i adhurar; sikur ta kuptonin.

Në kapitullin 23, verseti 8, thuhet: **“Por ju mos lejoni që t’ju quajnë rabbi, sepse vetëm një është Mësuesi juaj: Krishti.”** Këtu kemi argument se Isai është rob, ndërsa Zoti është Një dhe Ai është Allahu. Këtë verset e kanë përkthyer dhe devijuar në gjuhën arabe<sup>194</sup> me qëllim, duke lenë për të kuptuar se Isai është mësuesi (Zoti), ndërsa përkthimi në gjuhën angleze nuk e ka këtë devijim.

<sup>194</sup> Kështu e kanë bërë edhe në gjuhën shqipe, andaj verseti duhet të jetë: **“Por ju mos lejoni që t’ju quajnë rabbi, sepse vetëm një është Mësuesi juaj.”** (shp).

Po ashtu, në versetin 9, thuhet: **“Dhe përmbi tokë mos thirrni askënd atë tuaj, sepse vetëm një është Ati juaj, ai që është në qiej.”** Nga kjo kupton se termat “at” dhe “bir” kanë domethënien e lidhjes mes Zotit dhe robit, e kjo gjë pohohet në Ungjill për të gjithë njerëzit dhe nuk është e veçantë për Isain.

Në kapitullin 24, verseti 36, thuhet: **“Tani sa për atë ditë dhe për atë orë, askush s'e di, as engjëjt e qiejve, por vetëm Ati im.”** Ky është argument i prerë se atë orë e di vetëm Allahu, po ashtu është argument se dituria e Isait është e mangët sikur e njerëzve të tjerë. Vetëm Allahu e ka përfshirë çdo gjë me dituri.

Në kapitullin 26, verseti 39, thuhet se Isai ra me fytyrë për tokë dhe lutej duke thënë: **“Ati im, në qoftë se është e mundur, largoje prej meje këtë kupë; megjithatë, jo si dua unë, por si do ti.”** Nëse kjo vërtetohet, atëherë ai që i ka thënë këto fjalë, ka qenë injorant rreth fuqisë së Allahut, mirëpo ka qenë pohues se është rob i Allahut dhe se Ai bën ç'të dojë me të.

Në kapitullin 27, versetet 7-8, thuhet: **“Dhe, mbasi bënin këshill, me këtë denar blenë arën e poçarit për varreza të të huajve. Prandaj këtë arë e quajtën deri ditën e sotme: “Ara e gjakut”.** Nga kjo kuptojmë se Ungjilli nuk është shkruar në kohën e Isait, mirëpo është shkruar shumë kohë pas tij me tregime që i mbanin mend njerëzit.

Në versetin 46 thuhet: **“Jezusi briti me zë të lartë duke thënë: “Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?”** Ky është prej argumenteve më të mëdha se ai që i ka thënë këto fjalë nuk është prej besimtarëve të Allahut, jo më të jetë prej peygamberëve të Tij, sepse Allahu nuk e thyen premtimin e Tij, ndërsa peygamberët e Allahut nuk ankohen për premtimet e Tij.

## **PËRGËZIMI NË UNGJILL ME PEJGAMBERINË E MUHAMEDIT SAL-LALLAHU ALEJHI UE SEL-LEM**

Në Ungjillin e Gjonit, kapitulli 14, versetet 15-16 thuhet: **“Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia. Dhe unë do t'i lutem Atit dhe ai do t'ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju.”** Dijetarët muslimanë kanë thënë: “Ngushëlluesi tjetër është Muhamedi, i Dërguari i

Allahut, ndërsa qëndrimi i tij përgjithmonë do të thotë se do të mbesë feja (dispozitat dhe normat e saja) bashkë me Kuranin që i është zbritur.”

Në kapitullin 15, versetet 26-27 thuhet: **“Por kur të vijë Ngushëlluesi, që do t’ju dërgoj prej Atit, Fryma e së vërtetës, që del nga Ati im, ai do të dëshmojë për mua. Edhe ju, gjithashtu, do të dëshmoni, sepse ishit me mua që nga fillimi.”**

Në kapitullin 16, versetet 5-8 thuhet: **“Por tani unë po shkoj tek ai që më ka dërguar, dhe askush nga ju s’po më pyet: “Ku po shkon?”. Madje, për shkak se ju thashë këto gjëra, trishtimi e ka mbushur zemrën tuaj. Megjithatë unë ju them të vërtetën: është mirë për ju që unë të shkoj, sepse, po nuk shkova, nuk do të vijë te ju Ngushëlluesi; por, po shkova, unë do t’jua dërgoj. Dhe kur të ketë ardhur, ai do ta bindë botën për mëkat, për drejtësi dhe për gjykim.”**

Ndërsa në versetet 12-14 thuhet: **“Kam edhe shumë gjëra të tjera për t’ju thënë, por ato ende ju nuk mund t’i mbani. Por, kur të vijë ai, Fryma e së vërtetës, ai do t’ju prijë në çdo të vërtetë, sepse ai nuk do të flasë nga vetja, por do të thotë gjitha ato gjëra që ka dëgjuar dhe do t’ju kumtojë gjërat që do vijnë. Ai do të më përlëvdojë, sepse do të marrë prej meje dhe do t’jua kumtojë.”**

Pastaj tek verseti 16 thuhet: **“Pas pak nuk do të më shihni më; e përsëri një kohë e shkurtër e do të më shihni, sepse unë po shkoj tek Ati.”**

Dijetarët muslimanë kanë thënë: “Këto cilësi të përmendura nga Isai (Jezusi) lidhur me atë që do të vijë pas tij, janë mbledhur vetëm tek Muhamedi, i Dërguari i Allahut. Personi në fjalë, me të cilin përgëzonte Isai në Ungjill, quhej “Jarklita”. Këtë fjalë e hoqën përkthyesit e mëvonshëm dhe herë e zëvendësuan me fjalën “Fryma e së vërtetës”, herë me fjalën “Ngushëlluesi” dhe herë me fjalën “Shpirti i shenjtë”. Të gjitha këto aludojnë fjalën greke “Jarklita”, e cila do të thotë “shumë i lëvduar”, e kjo përputhet me domethënien e emrit Muhamed.

## **VAZHDIMI I ARGUMENTEVE TË UNGJILLIT SE ISAI ALEJHIS-SELAM KA QENË ROB ADHURUES**

Në kapitullin 17, verseti 3 thuhet: **“Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.”**

Në Ungjillin sipas Markut, kapitulli 12, versetet 28-30 thuhet: **“Atëherë një nga skribët që e kishte dëgjuar diskutimin e tyre, duke kuptuar se ai u ishte përgjigjur mirë, iu afrua dhe e pyeti: "Cili është i pari i të gjithë urdhërimeve?". Dhe Jezusi u përgjigj: "Urdhërimi i parë i të gjithëve është: "Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot", dhe: "Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!". Ky është i pari urdhërim.”**

Në versetin 32 thuhet: **“Atëherë skribi i tha: "Mirë, Mësues. The, sipas së vërtetës, se ka vetëm një Perëndi dhe s'ka asnjë tjetër përveç Tij.”** Ndërsa në versetin 34 thuhet: **“Dhe Jezusi, duke parë se ai ishte përgjigjur me mend, i tha: “Ti nuk je larg nga mbretëria e Perëndisë.”**

Them se: Isai alejhis-selam ka dëshmuar se Allahu është një i Adhuruar dhe ska të adhuruar me të drejtë përveç Tij, po ashtu kush e veçon Atë me adhurim, atëherë ai është pranë mbretërisë së Allahut. Pra, kjo do të thotë se kush i bën shirk (ortak apo të barabartë), apo e bën pjesë të trinitetit, atëherë ky njeri është larg mbretërisë së Allahut dhe armik i Tij.

Në kapitullin 13, verseti 32 thuhet: **“Sa për atë ditë dhe atë orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiell, as Biri, por vetëm Ati.”**

Them: kjo është përmendur edhe ne Ungjillin e Mateut dhe është pikërisht ajo çfarë thuhet në Kuran, se kohën e Kiametit e di vetëm Allahu. Kështu u pohua se Isai është rob adhures dhe është e pamundur që të jetë i adhuruar, e po ashtu bie poshtë përralla e trinitetit.

Në kapitullin 20, verseti 16-18 të Ungjillit të Gjonit, thuhet: **“Jezusi i tha: “Mari!”. Dhe ajo atëherë u kthye dhe i tha: “Rabboni!”, që do të thotë: Mësues. Jezusi i tha: “Mos më prek, sepse ende nuk u ngjita te Ati im; por shko te vëllezërit e mi dhe u thuaj atyre se unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj. Atëherë Maria Magdalena shkoi t'jua njoftojë dishepujve se kishte parë Zotin dhe se ai i kishte thënë këto gjëra.”**

Them: Isai (Jezusi) ka dëshmuar se Allahu është i adhuruari i tij dhe i tyre, po ashtu se nuk ka dallim mes tij dhe atyre në faktin se e adhurojnë Allahun. Kush pretendon se Isai është i adhuruar, vetëm se e ka përgënjeshtuar Isain dhe po ashtu të gjithë peygamberët dhe të dërguarit.

**..vijon në numrin e ardhshëm inshaAllah...**

**Përktheu: Besmir Cacani**

## POROSI PËR GRUAN MUSLIMANE

### SHEJH SALIH EL FEUZAN

Lavdi Allahut i Cili krijoi mashkullin dhe femrën duke i dalluar dhe bërë të ndryshëm,

وَلَيْسَ الذَّكَرُ كَالْأُنثَىٰ

**“E mashkulli nuk është si femra.”**<sup>195</sup> Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, të Vetëm e të pashok dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, të cilit Allahu i është drejtuar duke thënë:

وَلَسَوْفَ يُعْطِيكَ رَبُّكَ فَتَرْضَىٰ

**“E, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur.”**<sup>196</sup>

Salavatet dhe selamet qofshin mbi të, familjen e tij, shokët e tij, mbi ata që udhëzohen me udhëzimin e tij, kapen për Sunet dhe punojnë sipas porosisë së tij.

O njerëz! Frikësohuni Allahut dhe dijeni se Allahu subhanehu ue teala ju ka ngarkuar me përgjegjësi ndaj grave, duke ju bërë kujdestar për to. Allahu i Lartësuar thotë:

الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ أَمْوَالِهِمْ

**“Meshkujt janë kujdestarë për gratë, meqë Allahu u ka dhënë disa cilësi mbi ato dhe, meqë ata shpenzojnë për mbajtjen e tyre.”**<sup>197</sup>

Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem ju ka ngarkuar me përgjegjësi ndaj grave dhe ka thënë në “Hytben e Lamtumirës”: **“Ju porosis që të silleni mirë me gratë!”**

Ai gjithashtu ka paralajmëruar nga sprova e tyre duke thënë: **“Ruhuni nga gratë, sepse sprova e Benu Israilëve ishin gratë!”**

<sup>195</sup> Aal Imran: 36.

<sup>196</sup> Ed-Duha: 5.

<sup>197</sup> En-Nisa': 34.

Po ashtu ka thënë: **“Pas meje nuk kam lënë fitne më të dëmshme për burrat sesa gratë.”**

Kjo, sepse gratë janë të mangëta nga mendja dhe feja, siç është përmendur në hadithin e saktë, andaj ajo ka nevojë për kujdes. Patjetër gruaja duhet të ketë kujdestar për të, në kujdesjen për fenë e saj, për moralin dhe sjelljen e saj, përpara kujdesit me shpenzim për to, për veshmbathjen e tyre etj. Ju keni përgjegjësi për gratë tuaja, vajzat, motrat dhe gratë e afërta (që janë mahrem). Ato janë kërcënuar shumë ashpër nëse nuk e ruajnë femërinë e tyre, moralin dhe nderin. Allahu i Lartësuar thotë:

وَقُلْ لِلْمُؤْمِنَاتِ يَعْضُضْنَ مِنْ أَبْصَارِهِنَّ وَيَحْفَظْنَ فُرُوجَهُنَّ وَلَا يُبْدِينَ زِينَتَهُنَّ... إِلَّا لِبُعُولَتِهِنَّ

**“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre (d.m.th. pjesët e trupit)... përveçse bashkëshortëve të tyre...”<sup>198</sup>**

Po ashtu ka thënë:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ قُلْ لَأَزُوجِكُمْ وَبَنَاتِكُمْ وَنِسَاءَ الْمُؤْمِنِينَ يُدْنِينَ عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلَابِيبِهِنَّ ذَلِكَ أَدْنَىٰ أَنْ يُعْرَفْنَ  
فَلَا يُؤْذِينَ

**“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët.”<sup>199</sup>**

Gratë janë përgjegjësi e madhe për burrat. Nëse gruaja i lihet vetvetes, atëherë ajo do të devijojë nga rruga e saktë, do të mashtrohet nga gjërat mashtruese, nga thirrësit e devijimit, nga shembulltyrat e këqija, nga thirrësit e perëndimit, duke e devijuar nga rruga në të cilën e ka lënë Allahu, andaj, frikësohuni Allahut në lidhje me gratë tuaja dhe kujdesuni për to!

Vëllezër! Është për të ardhur keq dhe për t’u pikëlluar nga humbja e shumë grave në këto ditë, të cilat bëjnë ç’të duan, të cilat kanë morale të

<sup>198</sup> En-Nur: 31.

<sup>199</sup> El Ahzab: 59.

qortueshme, cilësi të këqija, nuk turpërohen dhe nuk i frikësohen Allahut subhanehu ue tealaa. Ato nuk kanë burra që kujdesen për to, madje janë të braktisura dhe të humbura, përveç atyre që i ka mëshiruar Allahu.

O grua! Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka lajmëruar se shumica e banorëve të Zjarrit janë gratë, pse? Sepse ato e mohojnë të mirën, e mohojnë burrin, kështu që janë shumica e banorëve të Zjarrit.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Dy kategori që janë banorë të Zjarrit nuk i kam parë akoma: burrat që kanë kamzhikë sikur bishti i lopëve, me të cilat godasin burrat, godasin njerëzit”,** e këta janë prijësit e padrejtë, policët e padrejtë që godasin njerëzit me të padrejtë; kjo është kategoria e parë. Kategoria e dytë: **“Gra të veshura mirëpo (realisht) janë të ç’veshura, të distancuara (nga rruga e drejtë), që joshin (të tjerët për në rrugë të gabuar), i kanë kokat sikur gungat e devesë; këto nuk hyjnë në Xhenet dhe nuk e ndejnë aromën e tij, edhe pse aroma e tij ndjehet nga kjo dhe kjo distancë.”** Në disa transmetime thuhet: **“Nga distanca e pesëqind viteve; ato nuk hyjnë në Xhenet dhe nuk e ndejnë aromën e tij.”** Ky është një kërcënim i ashpër ndaj grave dhe ndaj kujdestarëve të tyre, të cilët Allahu i ka ngarkuar me përgjegjësinë e tyre.

**“Gra të veshura mirëpo (realisht) janë të ç’veshura.”** Kjo do të thotë se e mbulojnë një pjesë të trupit, mirëpo i zbulojnë pjesët e tjera dhe pjesët provokuese. Kjo është ajo që ndodh sot mes jush në sallat e dasmave, në pushime dhe në tubimet e grave; shkojnë të veshura mirëpo (realisht) janë të ç’veshura, me disa copa rrobe të hedhura mbi trup, ndërsa pjesa tjetër është e ç’veshur. Ato i shfaqin shpinat e tyre, qafat, kollapet, parakrahët dhe kërciret. E gjithë kjo nën shikim e grave të tjera.

Për këtë, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Gra të veshura mirëpo (realisht) janë të ç’veshura.”** Kanë disa rroba mbi disa pjesë të trupit, ndërsa pjesët provokuese janë të ç’veshura, Allahu na mbroftë!

Kjo ndodh nëpër dasma, madje ëshë shtuar dhe është bërë i larmishëm nëpër dasma; s’ka mbikqyrje dhe as llogarikërkim.

**“Gra të veshura mirëpo (realisht) janë të ç’veshura, të distancuara”** nga rruga e vërtetë dhe është thënë [nga dijetarët] se përdridhen gjatë ecjes për provokim. **“Që joshin”** të tjerët, kjo do të thotë se i joshin të tjerat që i shikojnë



dhe bëhen shembull i keq për to, duke u ngarkuar me gjynahet e tyre dhe të tjerave.

**“Të distancuara** (nga rruga e drejtë), **që joshin** (të tjerët për në rrugë të gabuar),” nëse këto bëhen bashkë në një dasëm, atëherë do t’i marrin si shembulltyre gratë dhe vajzat e tjera që i shikojnë, duke i distancuar edhe të tjerat prej të vërtetës, prej mbulesës dhe turpit.

**“I kanë kokat sikur gungat e devesë”** ngaqë i zmadhojnë kokat duke i bërë grumbull, saqë duket sikur të ketë dy koka; një kokë të lindur dhe një fallco për shkak të gjërave të shëmtuara që i bën grumbull. Kudo që ta shikosh atë grua, do ta shikosh se e ka kokën e madhe dhe të zmadhuar. Drejtë ka patur Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem kur ka thënë: **“I kanë kokat sikur gungat e devesë; këto nuk hyjnë në Xhenet”**, kërcënim i ashpër, Allahu na dhëntë mirëqenie.

Gratë dhe kujdestarët e tyre duhet të pendohen tek Allahu subhanehu ue teala para se të ndërrojnë jetë dhe para se të ikë mundësia.

Mos u shkujdesni për çështjet e grave! Ajo që ka për kujdestar burrin e saj, që ka për kujdestar babanë e saj, që ka për kujdestar të birin, që ka për kujdestar vëllanë, që ka për kujdestarë burrat e afërt; këta duhet ta ndreqin gruan. Nëse e lejnë gruan epsheve të saja, ajo humbet. Gruaja është e mangët në mendje dhe në fe; nuk ka mend dhe nuk ka fe (është e mangët), andaj ka nevojë për dikë që kujdeset për të, sikur mendjelehti që nëse lihet vetëm, atëherë e shkatërron veten, e humb pasurinë dhe fenë e tij.

Robër të Allahut! Frikësohuni Allahut lidhur me gratë tuaja, vajzat, bashkëshortet dhe gratë e muslimanëve. Dijeni se Allahu subhanehu ue teala ka përmendur se ka burra besimtarë, hipokritë (munafikë) dhe idhujtarë (mushrikë), po ashtu ka përmendur se ka gra besimtare, idhujtare dhe hipokrite. Allahu i Lartësuar ka thënë:

الْمُنَافِقُونَ وَالْمُنَافِقَاتُ بَعْضُهُمْ مِنْ بَعْضٍ يَأْمُرُونَ بِالْمُنْكَرِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمَعْرُوفِ وَيَقْبِضُونَ أَيْدِيَهُمْ  
 نَسُوا اللَّهَ فَنَسِيَهُمْ إِنَّ الْمُنَافِقِينَ هُمُ الْفَاسِقُونَ \* وَعَدَّ اللَّهُ الْمُنَافِقِينَ وَالْمُنَافِقَاتِ وَالْكُفَّارَ نَارَ جَهَنَّمَ  
 خَالِدِينَ فِيهَا هِيَ حَسْبُهُمْ وَلَعْنَهُمُ اللَّهُ وَلَهُمْ عَذَابٌ مُّقِيمٌ

**“Hipokritët dhe hipokritet janë të ngjashëm me njëri - tjetrin: kërkojnë që të bëhen vepra të këqija e pengojnë të mirat dhe janë dorështrënguar. Ata e kanë harruar Allahun, por edhe Ai i ka harruar ata. Me të vërtetë, hipokritët janë keqbërës. Allahu u ka premtuar hipokritëve, hipokriteve dhe mosbesimtarëve zjarrin e Xhehenemit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë; ai do t’iu mjaftojë atyre! Allahu i ka mallkuar dhe ata do të kenë dënim të vazhdueshëm.”<sup>200</sup> Derisa thotë Allahu subhanehu ue teal:**

وَالْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ يَأْمُرُونَ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَيُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ وَيُطِيعُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ أُولَئِكَ سَيَرْحَمُهُمُ اللَّهُ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ\* وَعَدَّ اللَّهُ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَمَسَاكِنَ طَيِّبَةً فِي جَنَّاتٍ عَدْنٍ وَرِضْوَانٌ مِنْ اللَّهِ أَكْبَرُ ذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ

**“Besimtarët dhe besimtarete janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t’i mëshirojë Allahu. Se, Allahu me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe pallate të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Por kënaqësia prej Allahut është shpërblimi më i madh. Kjo është fitorja madhështore.”<sup>201</sup>**

Frikësohuni Allahut o robër të Tij! Shikoni ju dhe ato se tek cili nga këto dy grupe bëni pjesë. Frikësohuni Allahut për vetet tuaja!

Kurani ju lexohet ditë-natë. Sunetin e dëgjoni ditë-natë, për ju dhe gratë tuaja, andaj ku është puna sipas Kuranit dhe Sunetit?! A mos është secili prej jush i lënë që të bëjë çfarë të dojë?! A mos jeni të gjithë të lënë sikur kafshët, madje më të humbur?! Andaj, frikësohuni Allahut o robër të Tij!

<sup>200</sup> Et-Teubeh: 67-68.

<sup>201</sup> Et-Teubeh: 71-72.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ عَلَيْهَا مَلَائِكَةٌ غِلَاظٌ  
شِدَادٌ لَا يَعْصُونَ اللَّهَ مَا أَمَرَهُمْ وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ

**“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin melekë të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.”<sup>202</sup>**

Kini kujdes gratë tuaja! Tregohuni të vëmendshëm ndaj grave tuaja, sidomos nëpër dasma dhe tubime!

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Mos i pengoni robëreshat e Allahut që të shkojnë në xhami, mirëpo shtëpitë e tyre janë më mirë për to, e mos të dalin parfumosura.”** D.m.th. të pa zbukuruara, të pa parfumosura dhe jo të ç’veshura.

Nëna e besimtarëve, Aishja radijAllahu anhe ka thënë: “Po ti shikonte Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se çfarë po bëjnë gratë, atëherë do t’i ndalonte që të shkonin në xhami sikur i ndaluan Benu Israilët gratë e tyre.”

Frikësohuni Allahut o robër të Tij! Armiqtë e dinë, po ashtu edhe gratë e prishura dhe hipokrite e dinë se ky vend i përmbahet mbulesës së përgjithëshme dhe, mbulesa e përgjithëshme (abajja) është mbulesë mbi rrobat, sikur xhilibabi (që mbulon kokën dhe trupin).

يُذْنِبْنَ عَلَيْهِنَّ مِنْ جَلَابِيبِهِنَّ

**“Të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit.”<sup>203</sup>**

Xhilibabi është mbulesa e madhe që e mbulon gruan nga koka tek këmbët, që e hedh mbi rrobat e saja; pra mbulesë mbi mbulesë. Mbulesa e përgjithëshme (abajja) është e ngjashme me të. Ata e dinë se gruaja në këto vende nuk e lë mbulesën e përgjithëshme (abajen), andaj e ndryshuan atë dhe e bënë rrobë provokuese me stoli, zbukurime, e ngushtuan, e holluan saqë po të ishte pa të, do të ishte më mirë.

<sup>202</sup> Et-Tahrim: 6.

<sup>203</sup> El Ahzab: 59.

Frikësohuni Allahut o robër të Tij! Ju i shikoni gratë dhe vajzat tuaja. Ju i dëgjoni se çfarë bëhet nëpër dasma prej grave; askush nuk kundërshton, askush nuk xhelozon dhe askush nuk i pengon gratë e tij nga shkuarja në ato vende të këqija.

Frikësohuni Allahut për gratë tuaja! Jini të vëmendshëm ndaj tyre dhe mos i lini pa kujdes! Dalin gratë natën deri vonë dhe e kalojnë në të qeshura, lodrime dhe gjëra që i di vetëm Allahu, ndërsa kujdestari i saj nuk di gjë. Mbase ajo shkon dhe vjen me ndonjë taksist të huaj, ndërsa burri apo kujdestari i saj është në krevat dhe s' di gjë ku ka ikur, apo nuk e di se kur vjen. Po të kishte dele apo bagëti, a do t'i linte të dilnin? Të shëtisin natën pa ditur ku shkojnë? Jo, pasha Allahun! Si mund t'i lë vajzat, motrat, gruan dhe gratë e afërta që të dalin natën e errët?! Duke mos ditur se ku shkojnë, apo me kë shkojnë apo me kë shoqërohen?!

Frikësohuni Allahut o robër të Tij! Përpara se t'ju vijë ndonjë gjë prej hidhërimit të Allahut e s' mund ta përballoni. Dënimet tani janë djathas-majtas, i kanë mbushur vendet; vrasje, shpërngulje popullore, shkatërrim, pëmbytje, shembje, rrëzime dhe shfytyrime.

Frikësohuni Allahut, përpara se t'ju përfshijë ndonjë dënim i Tij, e më pas ta lutni Atë dhe mos t'ju përgjigjet.

Allahu më begatofte mua dhe ju me Kuranin madhështor, më begatofte mua dhe ju me ajetet dhe përkujtimet e urta që ka ai, i them këto fjalë, i kërkoj falje Allahut dhe pendohem tek Ai, andaj edhe ju kërkon falje Allahut, vërtet Ai është Falës dhe i Gjithëmëshirshëm.

**Përktheu: Besmir Cacani**

## **HISTORIA E ADEMIT, BABAIT TË NJERËZIMIT**

**SHEJH ABDURRAHMAN ES-SA'DIJ**

## Hyrje e autorit

### Dobitë e historive

Allahu na ka treguar në Librin e Tij histori të bukura me lajme rreth pejgamberëve të Tij, duke i cilësuar ato si historitë më të bukura.

Ky përshkrim i Allahut të Madh tregon se ato janë më të vërtetat, më të plotat dhe më të dobishmet për njerëzit.

❖ **Prej dobive më të rëndësishme të këtyre historive është se:** me to plotësohet besimi në pejgamberët sal-lAllahu alejhim ue sel-lem. Edhe pse ne i besojmë të gjithë pejgamberët në përgjithësi, besimi i detajuar arrihet me historitë e tyre, me përshkrimin që i ka bërë Allahu se janë plotësisht të sinqertë, se kanë cilësi të plota dhe janë më të lartat; ka përmendur vlerat e tyre, mirësitë dhe bamirësitë ndaj gjithë njerëzve, madje bamirësia e tyre ka mbërritur tek të gjitha gjallesat; me kujdesin dhe kryerjen e detyrimeve ndaj tyre.

Me këtë besim të detajuar të pejgamberëve, njeriu arrin besimin e plotë dhe është prej mjeteve të shtimit të tij.

❖ **Prej dobive është se:** historitë e pejgamberëve përmbajnë pohim të besimit në Allahun, në Teuhidin e Tij, në përkushtimin e veprave për Të, në besimin e Ditës së Gjykimit, në sqarimin e bukurisë së Teuhidit dhe obligueshmërisë së tij, në sqarimin e shëmtisë së shirkut dhe se ai është shkaku i shkatërrimit në Dynja dhe Ahiret.

❖ **Në historitë e pejgamberëve gjithashtu:** ka mësim për besimtarët të cilët i pasojnë në të gjitha gradat e fesë:

- Në gradën e Teuhidit dhe kryerjes së adhurimeve.
- Në gradën e thirrjes dhe qendrueshmërisë në gjitha fatkeqësitë shqetësuese, duke i trajtuar ato me qetësi dhe patundje të plotë.
- Po ashtu në gradën e sinqeriteti dhe përkushtimit ndaj Allahut në të gjitha lëvizjet dhe pushimet, me shpresë për arritur shpërblimin nga Allahu i

Lartësuar. Ata nuk kërkojnë shpërblim apo lëvdata nga krijesat, përveç gjërave që janë të dobishme për njerëzit.

❖ **Në këto histori mësohet:** pajtimi i pejgamberëve në të njëjtën fe, në të njëjtat parime, në thirrjen për tek çdo moral të bukur, në thirrjen për të punuar me vepra të mira, për të ndrequr dhe në qortimin që kanë bërë nga çdo gjë që i kundërshton këto gjëra.

❖ **Po ashtu:** ato përmbajnë dobi në dispozitat e fikhut, në normat e fetare dhe sekretet që kanë obligimet, të cilat janë madhështore dhe nxënësi i dijes nuk mund të bëjë pa to.

❖ **Në to ka:** këshillë dhe përkujtim, nxitje dhe frikësim, ndihmë pas vështirësisë, lehtësim i punëve pasi ishin të ngushtuara, përfundime të bukura që shikohen në këtë botë, po ashtu lëvdata dhe dashuri në zemrat e njerëzve, të cilat janë “ushqim” për njerëzit e devotshëm, janë gëzim për adhuruesit, qetësim për të mërziurit dhe këshillë për besimtarët.

Nuk është qëllimi i këtyre historive të jenë vetëm si kallëzime, mirëpo qëllimi kryesor është që të jenë përkujtime dhe mësim.

Përpara se të nisim tregimin e tyre, dije se Allahu i ka përsëritur shumë herë në Librin e Tij shumë prej historive të pejgamberëve me forma që i përshtaten rastave përkatëse. Ndoshta në një vend përmenden dobi dhe shtesa që nuk përmenden në tjetrin, apo përdoren shprehje të tjera nga historia tjetër, mirëpo domethëniet janë të njëjta apo të përafërta. Meqë ky komentim është i shkurtë, do t'i përmend këto histori dhe do t'i mbledh në një vend të vetëm. Po ashtu do përpiqem të sjell domethëniet e shprehjeve të Kuranit nga konteksti i tyre, nga fillimi në fund.

Pastaj, për çdo histori, do të përmend dobitë parimore, degëzore, morale, etike dhe tematikat e ndryshme, duke shpresuar nga Allahu që të më japë sukses në këtë gjë, që të jem korrekt në të shprehur, i sinqertë në vetvete, në përputhje me kënaqësinë e Allahut dhe ta bëjë përgjithësisht të dobishme, vërtet Ai është Bujar.

## **HISTORIA E BABAIT TË NJERËZIMIT, ADEMIT ALEJHIS-SELAM**

Allahu është i Pari dhe s'ka asgjë përpara Tij, po ashtu Ai bën çfarë dëshiron. Nuk ka kohë prej kohëve pa vepra apo fjalë që dalin prej vullnetit dhe dëshirës së Allahut, në varësi të urtësisë së Tij, i Cili është i Urti në çdo gjë që e ka caktuar dhe vendosur, siç është edhe i Urti në çdo gjë që ia ka ligjëruar robërve të Tij.

Kur Allahu me urtësinë e Tij të plotë, me diturinë e Tij gjithëpërfshirëse dhe me mëshirën e Tij të gjerë e krijoi Ademin, babain e njerëzimit – të cilët Allahu i vlerësoi mbi shumë krijesa që i ka krijuar –, i lajmëroi melekët dhe i tha:

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً

**“Vërtet unë do të krijoj një məkëmbës në Tokë.”**<sup>204</sup> I cili do të vijë pas krijesave që kanë qenë përpara tij dhe që vetëm Allahu ka njohuri rreth tyre.

قَالُوا أَتَجْعَلُ فِيهَا مَنْ يُفْسِدُ فِيهَا وَيَسْفِكُ الدِّمَاءَ

**“A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të?!”**<sup>205</sup> Kjo fjalë e melekëve është madhërim për Zotin e tyre, ku ndoshta do të krijojë krijesa të ngjashme me sjelljet e krijesave të para, apo se Allahu i Lartësuar i ka lajmëruar për krijimin e Ademit dhe për atë çfarë do të bëjnë pasardhësit e tij kriminelë.

Allahu i tha melekëve:

إِنِّي أَعْلَمُ مَا لَا تَعْلَمُونَ

**“Unë di atë që ju nuk e dini.”**<sup>206</sup> Pasi dituria e Tij përfshin çdo gjë, edhe dobitë e panumërta që rrjedhin nga kjo krijesë, kështu që Allahu i Lartësuar i bëri Vetë me dije melekët për diturinë e Tij të plotë, dhe se Allahut duhet t'i

<sup>204</sup> El Bekareh: 30.

<sup>205</sup> El Bekareh: 30.

<sup>206</sup> El Bekareh: 30.

pohohet dituria e gjerë dhe urtësia, ku pjesë e urtësisë është se nuk krijon diçka pa qëllim, as pa urtësi.

Më pas, Allahu i sqaron melekët në formë më të detajuar: Allahu e krijoi Ademin me Dorën e Tij, si nderim për të ndaj gjitha krijesave të tjera. Ai mori një grusht prej gjithë tokës; prej asaj të lehtë, të ashpër, të mirë dhe të keqe, që pasardhësit e tij të jenë sipas këtyre natyrave. Fillimisht ai ishte dhë, më pas i hodhi ujë dhe u bë baltë. Pas një kohe ku uji qëndroi mbi baltë, ajo ndryshoi dhe u bë e zezë. Më pas, Allahu e thau pasi që i kishte dhënë formë dhe u bë si dhëu i njomë që bën zhurmë. Gjatë këtyre etapave ai ka qenë trup pa shpirt. Kur krijimi i trupit të tij u krye dhe u plotësua, Allahu i fryu shpirtin dhe ai trup që ishte i ngurtë u kthye i gjallë me kocka, mish, nerv, enë gjaku dhe shpirt. Kjo është esenca e njeriut të cilin Allahu e ka përgatitur për çdo dije dhe mirësi.

Pas kësaj, Allahu e plotësoi mirësinë e Tij ndaj Ademit duke ia mësuar emrat e të gjitha gjërave dhe, dituria e plotë tregon plotësimin dhe moralin e plotë.

Allahu dëshiroi që melekët ta shikonin plotësinë e kësaj krijese, andaj i paraqiti gjërat dhe i tha:

أَنْبِئُونِي بِأَسْمَاءِ هَؤُلَاءِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ

**“Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!”**<sup>207</sup> Nëse është e vërtetë fjala juaj e parë, e cila nënkupton se është më parësore që mos të krijohet (kjo krijesë); kjo sipas asaj që iu duk atyre në atë rast.

Melekët e patën të pamundur të njihnin emrat e gjërave dhe thanë:

قَالُوا سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

**“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti.”**<sup>208</sup> Allahu tha:

<sup>207</sup> El Bekareh: 31.

<sup>208</sup> El Bekareh: 32.



قَالَ يَا آدَمُ أَنْبِئْهُمْ بِأَسْمَائِهِمْ

**“O Adem, - tha Ai - tregoji atyre emrat e gjërave!”<sup>209</sup>**

Melekët e panë plotësinë e kësaj krijese<sup>210</sup> dhe diturinë e tij që nuk e kishin menduar, kështu që u bënë me dije në mënyrë të detajuar dhe e panë vetë urtësinë e plotë të Allahut, kështu që e nderuan Ademin në maksimum, andaj Allahu dëshiroi që këtë vlerësim dhe nderim të melekëve ndaj Ademit, ta shfaqnin hapur dhe në brendësi.

Allahu i tha melekëve:

اسْجُدُوا لِآدَمَ

**“Përluni në sexhde para Ademit.”<sup>211</sup>** E kjo si respekt, nderim dhe vlerësim për Ademin, e po ashtu si adhurim ndaj Zotit tuaj, si bindje, dashuri dhe përluje ndaj Tij.

Të gjithë e bënë këtë gjë me të shpejtë dhe ranë në sexhde, e në mesin e tyre ishte edhe Iblisi. Edhe atij iu drejtua urdhëri për të rënë në sexhde. Ai nuk ishte prej melekëve, ai ishte prej xhindëve të krijuar nga zjarri flakërues. Iblisi fshihte mosbesimin ndaj Allahut dhe cmirën ndaj këtij njeriu që Allahu e kishte vlerësuar me këtë vlerësim.

Mendjemadhësia dhe mosbesimi e shtynë që mos të binte në sexhde për Ademin; e kjo si mosbesim ndaj Allahut dhe mendjemadhësi ndaj Tij.

Iblisi nuk u mjaftua me mosbindje, mirëpo shfaqti edhe kundërshtim ndaj Zotit dhe akuzë ndaj urtësisë së Tij. Ai tha:

أَنَا خَيْرٌ مِّنْهُ خَلَقْتَنِي مِن نَّارٍ وَخَلَقْتَهُ مِن طِينٍ

**“Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta.”<sup>212</sup>**

<sup>209</sup> El Bekareh: 33.

<sup>210</sup> D.m.th. Ademit (shp)

<sup>211</sup> El Bekareh: 34.

<sup>212</sup> El Earaf: 12.

Allahu i tha atij:

قَالَ يَا إِبْلِيسُ مَا مَنَعَكَ أَنْ تَسْجُدَ لِمَا خَلَقْتُ بِإِيْدِي أَسْتَكْبَرْتَ أَمْ كُنْتَ مِنَ الْعَالِي

**“O Iblis, ç’të pengoi ty që të mos përuleshe në sexhde para atij që e kam krijuar Vetë me duart e Mia? A mos u bëre mendjemadh apo mendon se je nga të lartët?”<sup>213</sup>**

Mosbesimi, mendjemadhësia, kundërshtimi dhe shmangia me fuqi ishin shkaqet që të dëbohej dhe mallkohej Shejtani.

Allahu i tha atij:

قَالَ فَاهْبِطْ مِنْهَا فَمَا يَكُونُ لَكَ أَنْ تَتَكَبَّرَ فِيهَا فَاخْرُجْ إِنَّكَ مِنَ الصَّاغِرِينَ

**“Atëherë, zbrit prej andej (Xhenetit)! Ti nuk ke të drejtë që të krenohesh në të! Largohu, me të vërtetë, ti je prej të poshtëruarve.”<sup>214</sup>**

Shejtani i poshtër nuk iu nënshtrua Zotit të tij dhe nuk u pendua tek Ai, mirëpo i doli kundër me armiqësi. Ai planifikoi një plan të plotë për armiqësimin e Ademit dhe pasardhësve të tij, po ashtu, kur e mori vesh se do të ishte përgjithmonë prej të trishtuarve, ai vendosi që pasardhësit e Ademit t’i thërriste me fjalët e tij, me veprat dhe ushtrinë e tij që të bëhen pjesë e partisë së tij, për të cilët është caktuar [si shpërblim] Xhehenemi. Ai ka thënë:

قَالَ رَبِّ فَأَنْظِرْنِي إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ

**“Ai tha: “O Zoti im, më jep afat deri në ditën kur do të ringjallen ata!”<sup>215</sup>** Që të angazhohet vetëm me armiqësimin e Ademit dhe pasardhësve të tij.

Duke qenë se prej urtësisë së Allahut ishte që njeriu të formohej me natyra të ndryshme, me morale të mira apo të këqija, atëherë patjetër që këto morale do të dalloheshin dhe pastroheshin përmes caktimit të shkaqeve të tyre,

<sup>213</sup> Sad: 75.

<sup>214</sup> El Earaf: 13.

<sup>215</sup> Sad: 79.

siç janë sprovat dhe testimet, ku më i madhi i tyre është lejimi i këtij armiku<sup>216</sup> që t'i bëjë thirrje njerëzve për tek çdo e keqe. Allahu iu përgjigj atij dhe i tha:

قَالَ فَإِنَّكَ مِنَ الْمُنْظَرِينَ (80) إِلَى يَوْمِ الْوَقْتِ الْمَعْلُومِ

**“Në të vërtetë, ty do të të jepet afat deri në një ditë të caktuar (kur i fryhet Surit për herë të parë).”<sup>217</sup>**

Ai iu përgjigj Zotit të tij duke e shpallur mosbindjen dhe armiqësinë e tij ndaj Ademit dhe pasardhësve të tij duke thënë:

قَالَ فَبِمَا أَغْوَيْتَنِي لَأَقْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ (16) ثُمَّ لَأَنْتَنَّهُمْ مِّنْ بَيْنِ أَيْدِيهِمْ وَمِنْ خَلْفِهِمْ  
وَعَنْ أَيْمَانِهِمْ وَعَنْ شَمَائِلِهِمْ وَلَا تَجِدُ أَكْثَرَهُمْ شَاكِرِينَ

**“Ai tha: “Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë e do t’u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës!”<sup>218</sup>**

Iblisi e tha këtë fjalë me hamendje, sepse e dinte mirë me çfarë natyre ishte krijuar njeriu:

وَلَقَدْ صَدَقَ عَلَيْهِمْ إِبْلِيسُ ظَنَّهُ فَاتَّبَعُوهُ إِلَّا فَرِيقًا مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ

**“Me të vërtetë, hamendja e Iblisit për ata u vërtetua; ata shkuan pas tij, përveç një grupi besimtarësh të vërtetë.”<sup>219</sup>**

Allahu ia mundësoi Iblisit atë çfarë dëshironte në lidhje me Ademin dhe pasardhësit e tij. Allahu i tha Iblisit:

<sup>216</sup> Pra i Shejtanit. (shp)

<sup>217</sup> Sad: 80-81.

<sup>218</sup> El Earaf: 16-17.

<sup>219</sup> Sebe’: 20.

قَالَ اذْهَبْ فَمَنْ تَبِعَكَ مِنْهُمْ فَإِنَّ جَهَنَّمَ جَزَاءُكُمْ جَزَاءً مَوْفُورًا (63) وَاسْتَفْزِرْ مِنْ اسْتَطَعْتَ  
 مِنْهُمْ بِصَوْتِكَ وَأَجْلِبْ عَلَيْهِم بِخَيْلِكَ وَرَجِلِكَ وَشَارِكْهُمْ فِي الْأَمْوَالِ وَالْأَوْلَادِ وَعِدَّهُمْ وَمَا يَعِدُهُمُ  
 الشَّيْطَانُ إِلَّا غُرُورًا

“(Allahu) tha: “Ik! Kushdo prej tyre që të pason ty, do të ketë Xhehenemin si shpërblim – një shpërblim i plotë. Bëj për vete, me zërin tënd, kë të mundesh nga ata! Lësho kundër tyre të gjithë kalorësinë e këmbësorinë tënde! Bëj pjesë në pasurinë e fëmijët e tyre dhe jepu premtime! -Premtimet e Shejtanit janë vetëm mashtrime.”<sup>220</sup>

D.m.th. po munde, bëji të devijuar në edukimin e fëmijëve të tyre, që t'i edukojnë keq, bëji të devijuar në shpenzimin e pasurive të tyre, në shpenzime dhe fitime të dëmshme. Po ashtu, shoqëroji ata nëse ushqehen, nëse pinë apo kryejnë marrëdhënie (me gratë e tyre) dhe nuk e përmendin emrin e Allahut në pasuri dhe fëmijë.

وَعِدَّهُمْ

“Jepu premtime” d.m.th. urdhëroji që të mohojnë ringjalljen dhe shpërblimin, e të mos bëjnë ndonjë të mirë, po ashtu frikësoji nga miqtë e tu, frikësoji nga shpenzimi i dobishëm me punë të fëlliqura dhe me koprraci. Kjo ka urtësi dhe të fshehta nga Allahu.

Nuk është në mundësinë tënde – o armik i hapur – që t'i devijosh njerëzit, mirëpo ata që janë të poshtër, do ta shfaqin poshtërsinë dhe të keqen e tyre, ndërsa Allahu nuk i kushton fare rëndësi atij.

Sa i përket pasardhësve të veçantë prej peygamberëve dhe pasuesve të tyre; besnikët, të dëlirët dhe kategoritë e evlijave dhe besimtarëve, Allahu i Lartësuar nuk i ka dhënë pushtet këtij armiku ndaj tyre, madje i ka vendosur barriera të pathyeshme, që janë mbrojtje për ta. Allahu po ashtu i ka dhënë “armë” që nuk mund t'i përballojnë armiku i tyre, e ato janë besimi tek Allahu dhe mbështetja e fortë tek Ai.

<sup>220</sup> El Isra': 63-64.

إِنَّهُ لَيْسَ لَهُ سُلْطَانٌ عَلَى الَّذِينَ آمَنُوا وَعَلَى رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ

**“Në të vërtetë, Shejtani nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre.”<sup>221</sup>**

Megjithëkëtë, Allahu i ka ndihmuar ata me shumë gjëra në përballjen e këtij armiku të hapur:

❖ I ka zbritur librat e Tij që përmbajnë dijet e dobishme, këshillat prekëse, nxitjen për të bërë veprat e mira dhe frikësimin nga bërja e veprave të keqja.

❖ I ka dërguar peygamberë që përgëzojnë ata që e besojnë dhe i binden Allahut se do të shpërblehen shumë shpejt, po ashtu të paralajmërojnë ata që mohojnë, që përgënjeshtrojnë dhe kthejnë krahët, se do të marrin dënime të ndryshme. Po ashtu, për ata që pasojnë udhëzimin e tij, ka garantuar udhëzimin me të cilin ka zbritur librat e tij dhe ka dërguar peygamberët; nuk do të devijojnë në këtë botë, po ashtu nuk do të trishtohen në botën tjetër, as nuk do të frikësohen dhe as nuk do të pikëllohen.

❖ Gjithashtu i ka orientuar në librat e Tij, po ashtu përmes gjuhëve të peygamberëve, tek gjërat me të cilat mund të mbrohen nga ky armik i hapur. Ai i ka sqaruar se për çfarë bën thirrje ky Shejtan dhe cilat janë metodat e tij me të cilat i fut njerëzit në kurth.

❖ Njëkohësisht i ka sqaruar dhe orientuar për tek rruga që mund të shpëtojnë nga e keqja e tij, nga provokimi i tij dhe i ka ndihmuar me ndihmë jashta mundësive të tyre; sepse kur u munduan dhe kërkuan ndihmën e Allahut, Ai ia bëri të lehtë rrugën për tek ajo që kishin për qëllim.

Pas kësaj, Allahu i Lartësuar e përmbushi mirësinë e Tij mbi Ademin, kështu që nga ai krijoi gruan e tij Havanë; e krijoi nga lloji dhe forma e tij, në mënyrë që të gjejë rehati tek ajo dhe të realizohen qëllimet e shumta, si martesë, bashkimi dhe lindja e pasardhësve nga këta të fundit.

Allahu i tha Ademit dhe gruas së tij se vërtet Shejtani është armik i juaji, andaj ruhuni shumë, e mos t’ju nxjerrë nga Xheneti që Allahu ju bëri banorë të

---

<sup>221</sup> En-Nahl: 99.

tij, që ju lejoi të hani nga gjitha frutat dhe të kënaqeni me të gjitha kënaqësitë e tij, përveç një peme të caktuar në të. Ai ia ndaloi atë pemë atyre dhe i tha:

وَلَا تَقْرَبَا هَذِهِ الشَّجَرَةَ فَتَكُونَا مِنَ الظَّالِمِينَ

**“Por mos iu afroni kësaj peme, se bëheni keqbërës!”<sup>222</sup>**

Allahu i tha Ademit për kënaqësitë që i bëri të ndjejë në Xhenet:

إِنَّ لَكَ أَلَّا تَجُوعَ فِيهَا وَلَا تَعْرَى (118) وَأَنَّكَ لَا تَظْمَأُ فِيهَا وَلَا تَصْحَى

**“Këtu nuk do të mbetesh kurrë as i uritur e as i zhveshur, dhe nuk do të kesh as etje, as vapë.”<sup>223</sup>**

Ata qëndruan në Xhenet për aq sa dëshiroi Allahu në gjendjen që ka përmendur, ndërsa armiku i tyre i mbikqyrte, i bënte pritë dhe priste mundësinë. Kur e shikoi gëzimin e Ademit në Xhenet dhe dëshirën e tij të madhe që ai të zgjaste, Iblisi iu paraqit në formë të mprehtë, me paraqitjen e shokut këshillues dhe i tha: “O Adem! A të tregoj për një pemë që nëse ushqehesh prej saj, do të qëndrosh përgjithmonë në Xhenet dhe nuk do të mbarojë pushteti yt?”

Ai vazhdoi ta ngacmonte, t’i bënte zbukurime, ta mashtronte, t’i bënte premtime, t’i jepte shpresa dhe t’i jepte këshilla nga ana e jashtme, mirëpo në realitet ato ishin mashtrimi më i madh, derisa arriti t’i mashtrojë dhe ata hëngrën nga pema që Allahu ia kishte ndaluar. Kur ata u ushqyen nga pema, pjesët e turpshme iu zbuluan pasi që kishin qenë të mbuluara më herët. Ata nisën të ngjisnin për trup gjethet e Xhenet, d.m.th. që t’i bëhen sikur rrobat të cilat i janë në duar, duke u shfaqur menjëherë dënimi për gjynahun që bënë:

فَدَلَاهُمَا بِغُرُورٍ فَلَمَّا ذَاقَا الشَّجَرَةَ بَدَتْ لَهُمَا سَوْآتُهُمَا وَطَفِقَا يَخْصِفَانِ عَلَيْهِمَا مِنْ وَرَقِ الْجَنَّةِ  
وَنَادَاهُمَا رَبُّهُمَا أَلَمْ أَنْهَكُمَا عَنْ تِلْكَ الشَّجَرَةِ وَأَقُلْ لَكُمَا إِنَّ الشَّيْطَانَ لَكُمْ عَدُوٌّ مُبِينٌ

<sup>222</sup> El Earaf: 19.

<sup>223</sup> TaHa: 118-119.

**“Zoti i tyre i thirri: “A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?”<sup>224</sup>**

Allahu frymëzoi në zemrat e tyre që të pendohen plotësisht dhe të kthehen tek Ai me sinqeritet:

فَتَلَقَىٰ آدَمُ مِنْ رَبِّهِ كَلِمَاتٍ فَتَابَ عَلَيْهِ إِنَّهُ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ

**“Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimin.”<sup>225</sup> Ata dy thanë:**

قَالَا رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ

**“Ata thanë: “O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.”<sup>226</sup>**

Allahu ia pranoi pendimin e tyre dhe ia fshiu gjynahun që bënë, mirëpo sa i përket çështjes prej së cilës i paralajmëroi Allahu – d.m.th. daljen nga Xheneti nëse ushqehen prej pemës – ishte e pashmangshme dhe ashtu u bë. Ata dolën nga Xheneti për në Tokë ku mirësia e saj ishte e rrethuar me të keqe, ndërsa gëzimi i saj me mërzi.

Allahu i lajmëroi se patjetër do t’i sprovonte, ata bashkë me pasardhësit e tyre. Kush do të besonte dhe do të bënte vepra të mira, atëherë përfundimi i tyre do të ishte më i mirë se gjendja e tyre e parë, ndërsa kush do të përgënjeshtronte dhe kthente krahët, atëherë përfundimi i tij do të ishte trishtimi i përhershëm dhe dënimi pa mbarim.

Allahu i ka paralajmëruar pasardhësit e Ademit nga Shejtani dhe ka thënë:

<sup>224</sup> El Earaf: 22.

<sup>225</sup> El Bekare: 37.

<sup>226</sup> El Earaf: 23.

يَا بَنِي آدَمَ لَا يَفْتِنَنَّكُمُ الشَّيْطَانُ كَمَا أَخْرَجَ أَبَوَيْكُم مِّنَ الْجَنَّةِ يَنزِعُ عَنْهُمَا لِبَاسَهُمَا لِيُرِيَهُمَا  
سَوَاتِهِمَا إِنَّهُ يَرَاكُمْ هُوَ وَقَبِيلُهُ مِنْ حَيْثُ لَا تَرَوْنَهُمْ إِنَّا جَعَلْنَا الشَّيَاطِينَ أَوْلِيَاءَ لِلَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ

**“O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrojë kurrsesi Shejtani, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga Xheneti, duke ua zhveshur rrobat për t’u dukur vendet e turpshme! Ai dhe ushtria e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata.”<sup>227</sup>**

Rrobën që Allahu ia kishte dhënë Ademit dhe Havasë dhe që ia hoqi Shejtani, Allahu ia zëvendësoi me rroba të tjera që të mbulojnë trupat, e të zbukurohen në paraqitjen e tyre gjatë jetës, po ashtu ia zëvendësoi me një rrobë më të lartë se kjo, që është rroba e devotshmërisë, rrobë e cila e vesh zemrën dhe shpirtin me besim, përkushtim, kthim tek Allahu me pendim, stolisje me çdo moral të bukur dhe largim nga çdo moral i ulët.

Më pas, Allahu nxori nga Ademi dhe gruaja e tij shumë burra dhe gra, duke i shpërndarë në tokë dhe duke i bërë məkëmbës në të, në mënyrë që të shikojë se si do të punojnë.

---

<sup>227</sup> El Earaf: 27.



## DOBI PARIMORE, DEGËZORE, MORALE DHE ETIKE TË PËRFITUARA NGA KJO HISTORI

❖ **Prej dobive është se:** këtë histori madhështore e ka përmendur Allahu në shumë vende në Librin e Tij, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa asnjë lloj dyshimi. Ajo është prej historive më madhështore për të cilën pejgamberët janë unanimit, me të cilën janë zbritur librat qiellorë dhe që e kanë besuar të gjithë pasuesit e pejgamberëve, nga i pari tek i fundit, derisa na doli kohëve të fundit një grupacion i poshtër dhe i pafe që mohuan çdo gjë me të cilën kanë ardhur pejgamberët, po ashtu mohuan egzistencën e Krijuesit. Ata pohuan vetëm dituritë natyrore që i arritën me njohuritë e tyre të mangëta. Duke u bazuar mbi këtë ideologji që është ideologjia më e largët nga e vërteta – si nga ana fetare ashtu dhe ajo logjike –, ata e mohuan Ademin dhe Havanë, po ashtu mohuan atë çfarë ka përmendur Allahu dhe Pejgamberi i Tij rreth tyre.

Ata pretendojnë se njeriu ka qenë kafshë, ka qenë majmun apo i ngjashëm me të, derisa evuloi në këtë gjendje që është sot.

Këta të fundit janë mashtruar nga teoritë e gabuara të bazuara mbi hamendjet e prishura që në pikënisje, duke lënë të gjitha dituritë e sakta për shkak të tyre, sidomos ato të ardhura nga pejgamberët.

Për ta është vërtetuar fjala e Allahut të Lartësuar:

فَلَمَّا جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَرِحُوا بِمَا عِنْدَهُمْ مِنَ الْعِلْمِ وَحَاقَ بِهِمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ

**“Kur të dërguarit e tyre iu sollën prova të qarta, ata u mburrën me diturinë që zotëronin vetë; por shumë shpejt i goditi ajo, me të cilën talleshin.”<sup>228</sup>**

Çështja e këtyre është e qartë për të gjithë muslimanët dhe për të gjithë ata që pohojnë egzistencën e Krijuesit; ata e dinë se janë grupacioni më i devijuar, mirëpo disa ndikime dhe pasoja të ndërtuara mbi këtë mendim të kësaj ideologjie femohuese kaluan tek disa muslimanë. Kjo, pasi një grup

<sup>228</sup> Gafir: 83.

bashkëkohor e shpjeguan sexhden që melekët ia bënë Ademit se do të thotë: nënshtrimi i kësaj bote për njerëzit, se lëndët e tokës, mineralet e saja e të ngjashmet me to, ia nënshtrori Allahu njeriut; kjo është domethënia e sexhdes së melekëve [sipas tyre].

Ai që beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, nuk dyshon se ky mendim është marrë nga ai mendim i mangët, se po devijon (kuptimin e) Librit të Allahut, se nuk ka dallim mes tij dhe mes devijimit të Batinive dhe Kurmutive, e nëse i bëhet ky lloj interpretimi kësaj historie, atëherë do të devijohen edhe historitë e tjera të ngjashme në Kuran. Kurani, nga sqarues për çdo gjë, nga udhëzim dhe mëshirë, do të kthehej në simbolikë, ku çdo armik i Islamit do ta bënte këtë veprim të fundit, duke e prishur Kuranin, duke e kthyer udhëzimin e tij në humbje dhe mëshirën në dënim. I lartmadhëruar qofsh o Allah, vërtetë kjo është shpifje e madhe!

Për ta hedhur poshtë këtë mendim të fëlliqur, besimtarit i mjafton në këtë rast që të lexojë atë çfarë na ka treguar Allahu lidhur me historinë e Ademit dhe sexhdes së melekëve, kështu që në këtë mënyrë, besimtari do ta kuptojë se ky mendim bien ndesh plotësisht me atë çfarë ka patur për qëllim Allahu dhe i Dërguari i Tij; edhe nëse shokët e tij mundohen ta mashtrojnë dhe ta joshin me fjalë, apo nëse ia përkatësojnë atë mendim dikujt që ka mendim të mirë për të.

Besimtari nuk e lë besimin e tij, as Librin e Zotit të tij për tilla reklama mashtruese, apo reklama me anëtarë të mashtruar.

❖ **Prej dobive është:** vlera e diturisë dhe se kur iu bë e qartë melekëve se çfarë vlere kishte Ademi për shkak të diturisë së tij, ata e njohën plotësinë e tij dhe se e ishte meritë për nderim dhe vlerësim.

❖ **Prej dobive është se:** kujt i jep Allahu mirësinë e diturisë, atëherë ai duhet të jetë mirënjohës për mirësinë që Allahu ia ka dhënë dhe të thotë siç kanë thanë melekët dhe pejgamberët:

قَالُوا سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

**“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti.”<sup>229</sup>**

Njeriu duhet të ruhet nga të folurit pa dituri, sepse dituria është mirësia më e madhe dhe falenderimi i saj, është duke i qenë mirënjohës Allahut dhe lëvduar Atë, e kjo duke i mësuar të tjetër, duke mësuar të paditurit, duke u ndalur tek gjërat që njeriu i di dhe duke heshtur për ato që nuk i di.

❖ **Prej dobive është se:** Allahu e ka bërë këtë histori mësim për ne dhe se cmira, mendjemadhësia dhe lakmia janë prej moraleve më të rrezikshme për njeriun. Mendjemadhësia e Iblisit dhe cmira që pati për Ademin, e bënë që të arrinte në këtë gjendje. Lakmia e Ademit dhe bashkëshortes së tij, i çuan që të hanin prej pemës. Po mos t’i mëshironte Allahu, ata do të përfundonin në shkatërrim, mirëpo mëshira e Allahut e plotëson të mangëtën, e rregullon atë çfarë është thyer, e shpëton atë që ka rënë në shkatërrim dhe e ngre atë që ka rënë poshtë.

❖ **Prej dobive është se:** nëse njeriu bie në gjynah, atëherë ai duhet të shpejtojë të pendohet, ta pranojë gabimin dhe të thotë me zemër dhe me pendim të sinqertë atë çfarë kanë thënë Ademi dhe Havaja. Allahu na e ka treguar historinë e tyre që ne t’i ndjekim ata, të fitojmë lumturinë dhe të shpëtojmë nga shkatërrimi. Po ashtu, Allahu na ka lajmëruar për fjalët e Shejtanit, për përbetimin e tij dhe vendimin e tij të prerë për të na devijuar me çfarë do metode, vetëm që ne të përgatitemi kundër këtij armiku, i cili ka fshaqur këtë armiqësi të theksuar dhe me rrënjë të thella.

Allahu do nga ne që: t’i bëjmë rezistencë Shejtanit me çdo gjë që kemi mundësi, qoftë duke u larguar nga rrugët dhe gjurmët e tij, apo duke u ruajtur nga shkaqet që mund të bëjnë të biesh në grackën e tij, apo duke ngritur mburojë me lutje të sakta, me dhikret e zemrës apo duke kërkuar mbrojtje tek Allahu në forma të ndryshme. Po ashtu, prej armëve që e shkatërrojnë Shejtanin është besimi i sinqertë, mbështetja e fuqishme tek Allahu, bërja e veprave të mira pamvarësisht se ai nuk i do, po ashtu rezistenca ndaj ngacmimeve të tija, apo mendimeve të këqija që ia hedh njeriut në zemër në çdo kohë, duke i

---

<sup>229</sup> El Bekareh: 32.

rezistuar me të kundërtat e tyre dhe me gjëra që i hedhin poshtë ato; si dituria e dobishme dhe faktet e vërteta.

❖ **Prej dobive është se:** historia përmban argument për Ehli Sunetin të cilët pohojnë për Allahun të gjithë emrat dhe cilësitë e Tij që ia ka pohuar Vetes. Nuk ka dallim mes cilësive të Qenies së Tij dhe cilësive të veprave.

❖ **Prej dobive është:** pohimi se Allahu ka dy duar, siç përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë në historinë e Ademit:

لَمَّا خَلَقْتُ بِيَدَيَّ

**[“Zoti tha: “O Iblis, ç’të pengoi ty që të mos përuleshe në sexhde para atij] që e kam krijuar Vetë me duart e Mia?”<sup>230</sup> Allahu ka dy duar të vërteta. Ashtu siç nuk i ngjan asnjë qenie Qenies së Tij, po ashtu edhe cilësitë nuk i ngjajnë cilësive të Tija.**

**Përktheu: Besmir Cacani**

---

<sup>230</sup> Sad: 75.

## BAMIRËSIA – IHSANI

### SHEJH RABI' EL MEDKHALI<sup>231</sup>

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdi Allahut, salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, familjen e tij, shokët e tij dhe mbi ata që ndjekin udhëzimin e tij. Më pas:

Islami synon që jetës së muslimanëve t'i japë një formë të bukur, ku të sundojë jetesa Islame dhe të mbulohet me bamirësi të përgjithëshme në të gjitha dimensionet dhe horizontet e tij.

Gjithashtu, ai synon që bamirësia të përfshijë çdo punë, çdo veprim dhe fjalë, në të gjitha gradat individuale apo kolektive, në rang shteti dhe umeti, në lidhjen që çdo individ ka me Krijuesin e tij, me familjen e tij dhe me shoqërinë në të cilën jeton, po ashtu në lidhjen e umetit me individin, të shtetit me individin dhe grupeve të njerëzve në lidhjen që kanë me Allahun.

Kur muslimani kryen një detyrë prej detyrave ndaj Allahut, në çfarëdo fushe qoftë, e veçanërisht në atë të adhurimit, atëherë le ta kryej duke përfytyruar se Allahu po e shikon; sikur është duke e parë dhe shikuar Allahun. Nëse nuk arrin në këtë gradë, atëherë le ta ndjejë se Allahu e shikon atë. Kjo ndjenjë apo tjetra, do ta shtyjnë që ta bëjë punën me saktësi, bamirësi dhe përpikmëri. I gjithë umeti Islam duhet të këtë këtë ndjenjë, “adhuroje Allahun sikur je duke e shikuar, edhe pse ti nuk e shikon, Ai të shikon ty”.

Sa i përket lidhjes së njeriut me familjen dhe shoqërinë e tij, atëherë marrëdhënia e tij lidhur me ta duhet të ngrihet dhe të përqendrohet mbi bazë të bamirësisë.

وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا وَبِذِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسَاكِينِ وَالْجَارِ ذِي  
الْقُرْبَىٰ وَالْجَارِ الْجُنُبِ وَالصَّاحِبِ بِالْجَنبِ وَابْنِ السَّبِيلِ وَمَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ

**“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfërit, fqinjët e afërt dhe**

---

<sup>231</sup> Asokohe mësues në Institutin e Mesëm të Universitetit Islamik në Medinen Pejgamberike, vitin 1392 h.

**të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin (që ka mbetur ngushtë) dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj.”<sup>232</sup>**

Po t'i praktikonte umeti Islam këto mësimë në jetën e tij, po të punonte çdo individ i umetit Islam që të zbatonte këtë parim – parimin e bamirësisë – dhe ta bënte familjen e tij pikënisjen e kësaj bamirësie – pas bamirësisë në adhurimin e Allahut – dhe ta bënte me domethënien e plotë të bamirësisë në fjalë, vepra, pasuri dhe përpjekje, atëherë do të bëhej shembull në lumturi, përparim dhe sovranitet.

Sa i takon lidhjes së individëve dhe shoqërive me njëra-tjetrën, lidhjes së qeveritarëve me të qeverisurit, Allahu urdhëron për drejtësi dhe bamirësi në të gjitha dimensionet:

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ

**“Vërtet Allahu urdhëron për drejtësi dhe bamirësi.”<sup>233</sup>**

Vërtet bamirësia në këndvështrimin Islam, ka një pozitë të lartë, me anë të cilës Allahu i merr umetit Islam premtimet e forta se do të kryejnë – me bamirësi – obligimet mbi të cilat ndërtohet Islami dhe lumturia e umetit:

وَإِذْ أَخَذْنَا مِيثَاقَ بَنِي إِسْرَائِيلَ لَا تَعْبُدُونَ إِلَّا اللَّهَ وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا وَذِي الْقُرْبَىٰ وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسَاكِينِ وَقُولُوا لِلنَّاسِ حُسْنًا وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ

**“Kujtoni kur Ne morëm besën tuaj, o bijtë e Israilit, se do të adhuroni vetëm Allahun, do të silleni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët dhe të varfrit, do t’u thoni fjalë të mira njerëzve, do të falni namazin e do të jepni zeqatin.”<sup>234</sup>** Ky është detyrim për bamirësi brënda kornizës familjare dhe ambientit shoqëror me bamirësi në vepra dhe fjalë.

Islami dëshiron që moralin e umetit Islam ta bëjë kopje të moralit që kanë banorët e Xhenetit:

لَا لَغْوٌ فِيهَا وَلَا تَأْتِيمٌ

<sup>232</sup> En-Nisa: 36.

<sup>233</sup> En-Nahl: 90.

<sup>234</sup> El Bekare: 83.

**“Nuk do të ketë biseda të kota e as gjynahe.”<sup>235</sup>**

وَقُلْ لِعِبَادِي يَقُولُوا الَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِنَّ الشَّيْطَانَ يَنْزِعُ بَيْنَهُمْ إِنَّ الشَّيْطَانَ كَانَ لِلْإِنْسَانِ عَدُوًّا مُبِينًا

**“Thuaju, robërve të Mi, që të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, djalli mbjell ngatërresa ndërmjet tyre. Vërtet, djalli është armik i hapët i njeriut.”<sup>236</sup>** Mbase një vepër e vogël e keqe shkakton pasoja të këqija dhe të hidhura. Dalja me fjalë dhe vepra nga bamirësia për tek të shëmtuarat dhe të turpshmet, e shfaq njeriun para hidhërimit dhe zëmërimit të papërbalueshëm të Allahut. **“Vërtet Allahu e urren atë (që është si natyrë) i shëmtuar (në fjalë dhe vepra), po ashtu atë që bëhet i shëmtuar.”<sup>237</sup>**

I shëmtuar (*fahish*), siç thotë Kurtubiu: “Është ai që flet me fjalë të shëmtuara lidhur me fenë, apo ai që e lëshon gjuhën me gjëra që nuk duhet, pra është poshtërsia në fjalë dhe vepra. Ndërsa i dyti është ai që i praktikon dhe i bën gjërat e lartpërmendura.”

Nuk janë rruga drejt Xhenetit dëshirat boshe dhe të pavërteta, as pretendimet e kota dhe as përkatësimi tek një fe, mirëpo rruga e vetme drejt Xhenetit është Ihlasi në Islam<sup>238</sup> dhe pasimi i Pejgamberit dhe fesë së tij të pastër me mirësi (Ihsan).

وَقَالُوا لَنْ يَدْخُلَ الْجَنَّةَ إِلَّا مَنْ كَانَ هُودًا أَوْ نَصَارَى تِلْكَ أَمَانِيُّهُمْ قُلْ هَاتُوا بُرْهَانَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ بَلَى مَنْ أَسْلَمَ وَجْهَهُ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ فَلَهُ أَجْرُهُ عِنْدَ رَبِّهِ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

**“Ata thonë: “Askush nuk do të hyjë në Xhenet, përveç hebreujve ose të krishterëve”. Këto janë dëshirat e tyre boshe! Thuaju (o Muhamed): “Nëse është e vërtetë ajo që thoni, atëherë sillni provën tuaj!” Vërtet, ata që i përgjigjen Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.”<sup>239</sup>**

Nëse dëshiron që të dojë Allahu, atëherë bëje bamirësinë mjet për ta arritur këtë qëllim.

<sup>235</sup> Et-Tur: 23.

<sup>236</sup> El Isra’: 53.

<sup>237</sup> Trasmeton Ahmedi.

<sup>238</sup> T’ia kushtosh adhurimin vetëm Allahut pa i bërë Atij shirk. (shp)

<sup>239</sup> El Bekare: 111-112.

وَأَحْسِنُوا إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ

**“Bëhuni bamirës, sepse vërtet Allahu i do bamirësit.”**<sup>240</sup> Nëse dëshiron të qëndrosh përgjithmonë në Xhenetet e kënaqësisë, të shikosh Zotin Madhështor, atëherë bëhu bamirës.

لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا الْحُسْنَىٰ وَزِيَادَةٌ

**“Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër!”**<sup>241</sup> Shpërblimi i mirë është Xheneti, ndërsa gjëja më tepër është shikimi i Fytyrës së Zotit Bujar.

Islami dëshiron që bamirësia të përfshijë çdo gjallesë. Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Ndërsa një burrë ishte rrugës dhe e mori etja, ai gjeti një pus ku zbriti që të pinte. Më pas, ai doli dhe gjeti një qen që kishte vështirësi në frymarrje, andaj hante baltën nga etja. Burri tha: “Këtë qen e ka marrë etja siç më kishte marrë mua.” Kështu ai zbriti në pus, e mbushi këpucën e tij me ujë, i dha qenit për të pirë, kështu që Allahu ia pranoi veprën dhe e fali.”** Thanë: “O i Dërguari i Allahut! A kemi shpërblim tek kafshët?!” Ai tha: **“Në çdo gjallesë ka shpërblim.”** E shikon sesi i mëson Islami besimtarët, si i edukon, si i shtyn nga e mira, nga ndjenja e mëshirës që të jenë bamirës, e të përfshihen të gjitha gjallesat, edhe nëse ato janë në gradat më të ulëta të gradave të kafshëve.

Në anën tjetër, ne e shikojmë sesi e ndalon padrejtësinë: **“Robërit e Mi! Vërtet Unë ia kam ndaluar vetes padrejtësinë, andaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit”, “muslimani është vëlla i muslimanit; nuk i bën padrejtësi dhe nuk e tradhëton”.** Edhe po të jetë mosbesimtar, mirëpo është nën besën e muslimanëve, Islami e ndalon gjakun dhe pasurinë e tij: **“Kush e vret një person nën besë (të muslimanëve), nuk e ndjen aromën e Xhenetit dhe me të vërtet që aroma e tij ndjehet në distancë dyzet vite.”**<sup>242</sup>

Nga Ibën Umeri se ka thënë: **“Kush e vret një zog pa të drejtë, Allahu do ta pyes për të në Ditën e Gjykimit.”**<sup>243</sup>

<sup>240</sup> El Bekare: 195.

<sup>241</sup> Junus: 26.

<sup>242</sup> Transmeton Ahmedi, Buhariu dhe Muslimi.

<sup>243</sup> Sahih et-tergib uet-terhib 1092 i shejh Albanit.



Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Një grua është dënuar për një mace që e ka mbyllur derisa ngordhi; as nga insektet e tokës nuk e pat lënë që të ushqehet.”**<sup>244</sup>

Islami nuk e lejon padrejtësinë, duke filluar nga njerëzit dhe duke përfunduar tek shpezët dhe kafshët që nuk u jepet rëndësi. Ky është civilizimi i lartë nën të cilin gjejmë mbrojtje edhe ata të cilët e luftojnë atë. Nëse një zog vritet me pa të drejtë, vrasësi i tij konsiderohet përgjegjës në Ditën e Gjykimit. Për një mace që është mbyllur derisa ka ngordhur, personi që e ka mbyllur dënohet me zjarr. Bamirësia e njeriut shtrihet tek çdo gjallësë, tek çdo gjë që ka jetë, e ku është pra civilizimi materialist i cili ngrihet mbi kufër dhe mosbesim, mbi etjen për fitim dhe lakmi, i cili shkatërron popuj duke ia përvetësuar pasuritë dhe uzurpuar të mirat, pasi që e ka ç’veshur më herët nga elementet bazë të jetës së tij fetare, morale dhe shoqërore. Pas kësaj, (civilizimi materialist) i injoron të gjitha krimet e shëmtuara dhe barbarizmat e bëra, e pastaj e akuzon Islamin për prapambetje, për regres, për padrejtësi dhe barbarizëm. “E gjuan gurin dhe fsheh dorën”.<sup>245</sup>

**Përktheu: Besmir Cacani**

---

<sup>244</sup> Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

<sup>245</sup> Burimi: Revista e Fakultetit Islamik të Medines, nr. 15, fq. 116-133. Muaji el Muharrem 1392 h.